



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 311.....Prot

Tiranë, më 30.12.2025

VENDIM

Nr. 168, datë 29.12.2025

**“PËR
MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
PËR VITIN 2025”**

Në zbatim të nenit 30, të pikës 1/i të nenit 38, të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të e RSH"; Udhëzimit nr.5, datë 19.02.2018 "Për përcaktimin e elementeve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", i ndryshuar me Udhëzimin nr.24, datë 21.10.2019; Senati Akademik me vendim qarkullues,

VENDOSI

1. Miratimin e Raportit Vjetor të veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore, si dhe ekonomiko-financiare për vitin 2025 të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
2. Ky Vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit për miratimin përfundimtar.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
PROF.DR. AGRON KASA



Dr. Aisel OSEKU

Prof.Dr. Dhurata BOZO

Prof.Asc. Enekeleda LLESHI

Prof.Asc. Fisnik BROVINA

Prof.Dr. Kujtim KAPEDANI

Prof.Dr. Robert ÇINA

Laura AVDO

Prof.Dr. Arben KAÇURRI

Prof.Asc. Elton SPAHIU

Prof.Dr. Ferdinand MARA

Prof.Asc. Klotilda VRENJO

Prof.Asc. Oltiana PETRI

Prof.Dr. Robert ÇITOZI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

**RAPORT VJETOR
PËR
VEPRIMTARINË
VITI AKADEMIK
2024 – 2025**

Tiranë, Dhjetor 2025

Përmbajtja

I. HYRJE.....	5
II. PËRMBLEDHJE.....	7
III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ORGANEVE DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE NË UST	
3.1 Organizimi i UST-së.....	9
3.2 Funksionimi i organeve kolegjiale/drejtuese.....	10
3.3 Njësitë administrative ndihmës akademike (rektorat/dekanat) dhe komisionet ad-hoc.....	12
3.4 Aktiviteti i njësive kryesore.....	13
3.4.1 Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes.....	14
3.4.2 Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit.....	18
3.4.3 Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit.....	24
3.4.4 Instituti i Kërkimit Shkencor në Sport.....	27
3.4.5 Sekretaritet mësimor në njësitë kryesore	28
IV. INFORMACION MBI REALIZIMIN E QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE TË MËSIMDHËNIES, TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE VEPRIMTARIVE KRIJUESE DHE INOACIONIT.....	28
V. VEPRIMTARIA MËSIMORE E NJËSIVE KRYESORE TË UST PËR VITIN AKADEMIK 2024 – 2025 DHE STUDENTËT	31
5.1. Informacion për Programet e Studimit që ofron Universiteti i Sporteve të Tiranës	33
5.2. Pasqyrimi i treguesve sasiorë e cilësorë të arritur nga studentët gjatë vitit akademik 2024 – 2025	37
VI. SIGURIMI I CILËSISË.....	43
VII. PERSONELI AKADEMIK	
7.1. Personeli akademik	60
VIII. KËRKIMI SHKENCOR	
8.1 Politikat e Kërkimit Shkencor në UST	62
8.2 Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes.....	64
8.3 Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	71
8.4 Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit	81
8.5 Instituti i Kërkimit Shkencor në Sport	85
8.6 Bashkëpunime kombëtare dhe ndërkombëtare në nivel universiteti.	88
8.7 Projektet dhe Shkëmbimet në kuadër të Programit Erasmus+	90

IX. INFRASTRUKTURA DHE LOGJISTIKA NË FUNKSION TË AKTIVITETIT AKADEMIK

9.1	Infrastruktura, logjistika dhe shërbimet	96
-----	--	----

X.STUDENTËT

10.1.	Mbështetja ndaj studentëve.....	97
-------	---------------------------------	----

XI.	ANALIZA FINANCIARE 2025.....	98
-----	------------------------------	----

REFERENCA

I. HYRJE

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, Rregullores së Universitetit të Sporteve të Tiranës, Planit të Zhvillimit Strategjik të UST-së, si dhe Udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018 të Ministrisë së Arsimit “Për përcaktimin e elementeve përbërës të raportimit vjetor...”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 24, datë 21.10.2019, Universiteti i Sporteve të Tiranës, paraqet Raportin Vjetor të Veprimtarisë Mësimore dhe Kërkimore-Shkencore për vitin akademik 2024-2025, si dhe atë financiar për vitin kalendarik 2025 në nivel universiteti, në kuadër të forcimit të transparencës dhe informimit mbi veprimtarinë institucionale.

Misioni i Universitetit të Sporteve të Tiranës, konsiston në ofrimin e një arsimi gjithëpërfshirës për studentët, në zhvillimin e tyre profesional, kërkimin shkencor dhe realizimin e veprimtarive të tjera në fushën e shkencave sportive, aktivitetit fizik për shëndet dhe rehabilitimit. UST garanton ofrimin e programeve të studimit në të tre ciklet, në përputhje me standardet më të larta akademike dhe profesionale, duke synuar përgatitjen e specialistëve të aftë për të ofruar dhe praktikuar cilësi të lartë, për të kontribuar në cilësinë sportive, shëndetin publik si dhe për të avancuar kërkimin shkencor në këto fusha.

Në përmbushje të misionit institucional dhe në respektim të kuadrit ligjor në fuqi, ky raport synon të evidentojë aspektet kryesore të veprimtarisë akademike të UST-së, duke i kushtuar vëmendje të veçantë problematikave të identifikuara dhe masave të ndërmarra për adresimin e tyre, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë.

Ky raport është ndërtuar mbi bazën e analizës së raporteve vjetore të njësive themelore (fakulteteve + institutit) të UST-së, si dhe të strukturave të tjera institucionale. Konkretisht, dokumenti mbështetet në:

- Raportin Vjetor të Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, shoqëruar me shkresën nr. 2797/1 Prot., datë 09.12.2025 “Raporti Vjetor i Veprimtarisë Mësimore dhe Kërkimore Shkencore”;
- Raportin Vjetor të Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, shoqëruar me shkresën nr. 2977/3 Prot., datë 12.12.2025 “Raporti vjetor i procesit mësimor, kërkimor – shkencor”;
- Raportin Vjetor të Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, shoqëruar me shkresën nr. 2939/1 Prot., datë 15.12.2025 “Raport vjetor mbi veprimtarinë mësimore, kërkimore shkencore”;
- Raportin Vjetor të Institutit të Kërkimit Shkencor në Sport, shoqëruar me shkresën nr. 2961 Prot., datë 15.12.2025 “Raport vjetor i veprimtarisë akademike dhe shkencore”;
- Raporte informuese dhe analitike të organeve kolegjiale të UST-së;
- Raporte informuese dhe analitike të komisioneve në nivel universiteti (Komisioni i Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore, Këshilli i Etikës, Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë);

- Raporte informuese dhe analitike të njësive përbërëse të Rektoratit të UST-së, lidhur me çështjet ligjore, kurrikulën, pranimet, sigurimin e cilësisë, projektet dhe programet e kërkimit shkencor, etj.;
- Të dhëna statistikore të mbledhura nga raportet vjetore të njësive kryesore, që përfshijnë regjistrimet në programet e studimit, rezultatet akademike të studentëve, normat e kalueshmërisë, transferimet, diplomimet, etj.

II. PËRMBLEDHJE

Raporti vjetor është një pasqyrë e aktivitetit akademik dhe financiar, viti kalendarik 2025, të zhvilluar nga Universiteti i Sporteve të Tiranës. Raporti vjetor paraqet informacione, gjetje, konstatime dhe vlerësime për të gjitha aspektet e veprimtarisë që universiteti dhe fakultetet e tij zhvillojnë.

Raporti pasqyron në formë të përmbledhur informacione, analiza dhe gjetje për:

- funksionimin dhe performancën e strukturave përgjegjëse (organe kolegjiale, komisione të përhershme) në lidhje me aspekte të ndryshme të veprimtarisë akademike dhe financiare të UST-së dhe të njësive kryesore;
- procesin e mësimdhënies dhe të nxënies, njohuritë dhe kompetencat në nivel njësie kryesore;
- kërkimin shkencor, projektet dhe programet kombëtare dhe ndërkombëtare të UST-së, ku personeli akademik, studentët e UST-së, si dhe personeli joakademik marrin pjesë si palë aktive.

Raporti adreson aspekte të politikave të kërkimit shkencor, të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien, produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga departamentet, si dhe të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor; programet e studimit që ofron UST, duke paraqitur programet e studimit që janë aktive, riorganizimin e tyre në kuadër të përditësimit, hapjen e programeve të reja si dhe ofrimin e edukimit në vazhdim për profesionistët e sportit dhe aktivitetit fizik për shëndet; angazhimin e personelit akademik dhe ngarkesën mësimore; gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet gjatë vitit akademik 2024-2025; numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit, numrin e studentëve që ndjekin programet e studimit që ofron UST, mbështetjen për studentët (bursa apo përjashtim/reduktimi i tarifave të shkollimit), pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi kombëtare, ndërkombëtare si dhe mbështetjen për mobilitetin e tyre në kuadër të projekteve Erasmus, cilësinë e studentëve dhe vlerësimin e tyre për secilin cikël dhe program studimi; mobilitetin e personelit akademik të financuar nga UST-ja apo të realizuar në kuadër të projekteve/programeve; infrastrukturën, ku përfshihen mjediset didaktike dhe kërkimore, politikat në shpërndarjen e fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë, numrin e teksteve dhe infrastrukturën informatike në funksion të mësimin, përmirësimit dhe plotësimit, sipas standardeve shtetërore të cilësisë, plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukture, në përputhje me Kodin e Cilësisë.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga njësitë kryesore të UST-së, nga sektorët përkatës të Rektoratit, nga sekretariatet teknike të organeve kolegjiale, si dhe në bazë të raporteve dhe analizave të kryera nga UST për institucione të tjera, rezulton se:

Universiteti i Sporteve të Tiranës, organizohet dhe menaxhohet në zbatim të Statutit dhe Rregullores së tij. Organet kolegjiale dhe drejtuese të UST-së funksionojnë bazuar në rregullore specifike e procedura, të miratuara sipas Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të UST -së, si dhe në strategjinë e zhvillimit të institucionit.

Nga burimet në dispozicion të UST-së, konstatohet se është treguar përgjegjshmëri në përmbushjen e detyrave përkatëse nga strukturat përgjegjëse. Universiteti është në gjendje të tërheqë një gamë të gjerë burimesh dhe mbështetjeje nga sektori i sportit dhe aktivitetit fizik për shëndet. Kjo ofron një shtrirje burimesh të vazhdueshme dhe të pasura, si për stafin, ashtu edhe për studentët.

Kurrikula që ofron Universiteti i Sporteve të Tiranës, është e lidhur ngushtësisht me kërkesat e profesionit dhe mbështetet nga një rrjet i fuqishëm profesionistësh të sportit, aktivitetit fizik për shëndet dhe rehabilitimit. Programet e studimit janë qartësisht të përcaktuara, kjo në përmbushje të misionit që UST ka “...ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës i studentëve, i kualifikimit të tyre, kërkimit shkencor dhe veprimtarive të tjera në fushën e shkencave sportive, aktivitetit fizik për shëndet, turizmit sportive dhe rehabilitimit. UST ofron programe në tre ciklet e studimit, në përputhje me standardet më të larta akademike dhe profesionale, në përgatitjen e profesionistëve në fushat e theksuara më lart, me qëllim që të ofrojnë dhe praktikojnë cilësi optimale ndaj sportistëve dhe të gjitha kategorive të popullatës, si dhe të çojnë përpara kërkimin shkencor në këto fusha”.

Planet mësimore janë objekt rishikimi periodik nga njësitë kryesore/bazë të UST-së. Për vitin akademik 2024-2025 janë rishikuar dhe përmirësuar disa prej planeve mësimore në të tri njësitë kryesore, si në programet e ciklit të parë ashtu edhe të dytë, përmirësime të cilat nuk e kanë tejkaluar masën 20%.

Gjithashtu, UST ka finalizuar me sukses prej 4 vitesh, hapjen e programeve të studimit të doktoratave (2 programe doktorate, një në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes dhe një në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit). Gjithashtu gjatë vitit 2025, kanë vazhduar procedurat e pranimit në programet e ciklit të tretë “Doktoratë” të ofruara nga dy njësitë kryesore F.V.F.R. dhe F.SH.L., bazuar në aktet rregullative. Prej 4 vitesh vazhdon hapja e procedurave të pranimit në programet e doktoratave në njësitë kryesore në përputhje me kriteret, kapacitetet akademike dhe kuotat e miratuara.

Mësimdhënia, mësimnxënia dhe vlerësimi në UST, kryhet në përputhje me Statutin, Rregulloren e Universitetit dhe rregulloret e njërive kryesore të tij. Në vitin akademik 2024-2025 procesi mësimor në UST u zhvillua në përputhje me planet mësimore dhe syllabuset e lëndëve si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Sigurimi i Cilësisë në UST është një proces i vazhdueshëm në kuadër të përmirësimit të kurrikulave, metodave të mësimdhënies, mësimnxënies, vlerësimit, promovimit dhe kualifikimit të mëtijshëm të personelit akademik, administrativ dhe mbështetës.

Gjatë vitit akademik 2024-2025, UST ka aplikuar pranë ASCAL për riakreditimin e të gjitha programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë si dhe për akreditimin për herë të parë të të dy programeve të Ciklit të Tretë “Doktoratë” që UST-ja ofron.

Studentët janë të organizuar në këshilla studentorë. Këta këshilla funksionojnë në bazë të akteve rregullative të miratuara prej tyre. Ata planifikojnë aktivitete në fushën e sportit dhe aktivitetit fizik (ditët studentore) apo kulturore sociale sipas një plani vjetor. Veprimtaria e Këshillave Studentorë mbështetet nga njësitë kryesore dhe universitetit me logjistikë infrastrukturore apo materiale.

Në njësitë kryesore të UST-së funksionojnë Zyrat e Karrierës në mbështetje të studentëve në lidhje me tregun e punës, duke siguruar kontaktet e duhura me punëdhënësit potencialë; në zhvillimin e aktiviteteve të përvitshme për të afruar studentët në prag të diplomimit me punëdhënësit e mundshëm

(panaire pune etj); në ofrimin e këshillimit dhe udhëzimeve në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierës profesionale të studentëve. Zyra e karrierës (ZK) bashkëpunon ngushtë me njësitë bazë për mundësitë e akomodimit të studentëve në institucione/kompani/organizata në funksion të praktikave profesionale të studentëve; informon studentët e ardhshëm nëpërmjet aktiviteteve periodike që organizon fakulteti/universiteti për këtë qëllim. ZK mbështet, inkurajon dhe asiston jetën kulturore, artistike dhe sportive të studentëve.

Në kuadër të vlerësimit të performancës së alumni-t, UST mbledh dhe analizon të dhënat zyrtare për punësimin e tyre, nga urdhrat përkatës për profesionet e rregulluara, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe nga zyrat e karrierës në nivel Fakulteti.

Promovimi i studentëve të Rrjetit të Ekselencës së Studentëve të UST-së është një nga mbështetjet që UST jep për studentët.

Raporti i detajuar sipas aspekteve të ndryshme akademike që trajtohen, është përshtatur dhe përmbledhur në bashkëpunim me drejtoritë e tjera pranë Rektoratit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, ndërkohë që përmbledhja dhe përshtatja e analizës financiare është përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit pranë Rektoratit të UST-së.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ORGANEVE DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE NË UST

3.1 Organizimi i UST-së

Tabela 1

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE AKADEMIKE PËR PERIUDHËN DHJETOR 2024 – DHJETOR 2025	
ORGANIZIMI AKADEMIK	
Organe drejtuese:	
Senati Akademik	
Rektorati	
Dekanati	
Këshilli i Etikës	
Komisionet e Përhershme	
a) Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik;	
b) Komisioni i Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore;	
c) Komisioni i Mbarëvatjes dhe Vemprimitarisë së Marrëdhënieve me Studentët;	
d) Komisioni i Sigurimit të Cilësisë dhe Kurrikulave;	
Autoritetet akademike drejtuese:	
a) Rektori	
b) Drejtuesi i njësisë kryesore	
c) Drejtuesi i njësisë bazë	
ORGANIZIMI ADMINISTRATIV	
a) Bordi i Administrimit	
b) Administratori i Institucionit	
STRUKTURA INSTITUCIONALE	
Njësitë kryesore dhe bazë:	

Fakulteti Shkencave të Lëvizjes
<i>Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit</i>
<i>Departamenti i Sporteve Kolektive</i>
<i>Departamenti i Sporteve Individuale</i>
Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit
<i>Departamenti i Aktivitetit Fizik, Rekreacionit dhe Turizmit</i>
<i>Departamenti i Menaxhimit të Sportit dhe Turizmit</i>
<i>Departamenti i Lëvizjes dhe Shëndetit</i>
Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit
<i>Departamenti i Shkencave Biomjeksore dhe Humane</i>
<i>Departamenti i Kineziologjisë</i>
<i>Departamenti i Rehabilitimit</i>
Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit
<i>Departamenti i Performancës Sportive</i>
<i>Departamenti i Aktivitetit Fizik dhe Shëndetit</i>
<i>Departamenti i Projekteve dhe Teknologjisë</i>
Njësi të tjera
<i>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i>
<i>Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Arkiv-Protokollit</i>
<i>Drejtoria Juridike dhe e Zhvillimit të Kurrikulave</i>
<i>Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët</i>
<i>Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore</i>
<i>Dega e Bibliotekës Shkencore e Digjitale</i>
<i>Drejtoria e Financës dhe Buxhetit</i>
<i>Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse</i>

3.2. Funksionimi i organeve kolegjiale/drejtuese

Në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Statutit dhe të Rregullores të UST, çdo njësi/strukturë, personel akademik, ndihmës akademik dhe joakademik është përgjegjëse për mbarrëvajtjen e procedurave, aktiviteteve dhe veprimtarive që zhvillon universiteti për realizimin e objektivave për zhvillimin e procesit mësimor dhe shkencor, si dhe aktiviteteve të tjera.

Në Universitetin e Sporteve të Tiranës janë të ngritura Komisioni i Përhershëm i Promovimit të Personelit Akademik (KPPPA), për dhënien e titujve akademik “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor” dhe Komisionet e Përhershme për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në njësitë kryesore të UST-së.

Referuar aktivitetit të zhvilluar gjatë vitit akademik, organet kolegjiale dhe autoritetet drejtuese kanë kryer veprimtaritë kryesore si vijon:

Senati Akademik kryen veprimtarinë e tij në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Statutit dhe të Rregullores të UST-së, si dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Konkretisht Senati

Akademik ka ushtruar kompetencat e tij në mbarëvajtjen e veprimtarisë akademike gjatë vitit 2024-2025, nëpërmjet vendimeve të marra në mbledhjet përkatëse. Senati akademik për ushtrimin e detyrave të tij funksionale, ka marrë 166 vendime.

Konkretisht, tematika e këtyre vendimeve është si më poshtë:

1. Vendime të karakterit akademik (mësimor e shkencor) (miratim i kriterëve të pranimit në programet e studimit, miratim i kuotave të pranimit për programet e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, rishpërndarje e kuotave të pranimit në programet e specializimeve afatgjata, miratim i programeve të reja të studimit, miratim për ndryshimin e planeve mësimore në masën nën 20%; miratimi i personelit akademik me kohë të pjesshme në UST, miratimi i kandidatëve të kategorisë profesor).
2. Vendime të karakterit financiar (shpërndarje Granti), miratim i tarifave të shkollimit të të tre cikleve të studimit, miratim të tarifës së aplikimit për programet Doktoratë, miratim të tarifës së shërbimit për fitimin e titujve akademikë; miratim të kostos së plotë të studimeve, miratim i trajtimit financiar të Këshillit të Etikës.
3. Vendime të karakterit rregullativ (akte rregullative): miratim për një ndryshim në Rregulloren e UST-së, miratim në parim i marrëveshjeve të bashkëpunimit të UST-së e IAL-së vendase apo të huaja, si dhe me organizata të tjera.
4. Vendime të karakterit administrativ si: miratimi i përbërjes së Këshillit të Etikës të UST-së; miratim për ndryshim në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; miratim i Raportit Vjetor të UST-së.

Bordi i Administrimit kryen veprimtarinë e tij në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Statutit dhe të Rregullores të UST-së, si dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore. Konkretisht Bordi i Administrimit, ka ushtruar kompetencat e veta për mbarëvajtjen e veprimtarisë financiare dhe administrative të UST-së, nëpërmjet mbledhjeve të zhvilluara. Për vitin 2024-2025 Bordi i Administrimit ka marrë 65 vendime.

Konkretisht, tematika e këtyre vendimeve është si më poshtë:

1. Vendime të karakterit financiar (shpërndarje Granti, rishpërndarje Granti, miratim të tarifave të shkollimit të të tre cikleve, miratim të tarifës së aplikimit për Ciklin e III, Doktoratë, miratim të tarifës së shërbimit për fitimin e titujve akademikë, miratim i trajtimit financiar të Këshillit të Etikës);
2. Vendime për trajtimin financiar (bursa apo përjashtim nga tarifat e shkollimit të studentëve);
3. Vendime lidhur me miratimin e planeve të auditimit, të ndryshimeve të tyre, të plotësimit të vakancave, etj.;
4. Vendime të karakterit administrativ si: miratimi Raportit Vjetor të UST-së, miratimi kriterëve dhe dokumentacionit për Administratorët e njësive kryesore, etj.

Rektori/Dekani/Drejtuesi i departamentit (autoritete drejtuese) kanë qenë të angazhuar për mbarëvajtjen e procesit mësimor, monitorimin e regjistrimit të studentëve, menaxhimin e personelit akademik me kohë të plotë apo të pjesshme, raportimet periodike, si dhe për zgjidhjen e çështjeve të evidentuara gjatë zhvillimit të procesit mësimor, sezoneve të provimeve, praktikave profesionale dhe diplomimit. Si autoritete drejtuese, ato kanë zhvilluar takime me titullarë të institucioneve qëndrore shtetërore për zgjidhjen e problematikave të hasura në institucion, si dhe kanë përcjellë projekt-

propozime konkrete për të gjitha draft-aktet rregullative e nxjerra nga ministria përgjegjëse për arsimin, në kuadër të mirëfunksionimit të institucionit tonë.

Gjithashtu janë realizuar një sërë takimesh në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me të tretë, takime lobimi për universitetin, si dhe takime informuese me studentët, stafin akademik, median apo të interesuar të tjerë, në kuadër të rritjes së transparencës dhe informimit (disa prej aktiviteteve janë paraqitur edhe në faqen zyrtare të internetit të UST-së dhe në ato të fakulteteve).

Rektorati/dekanatet (organe kolegjiale), në ushtrim të kompetencave të tyre, kanë shqyrtuar dhe marrë vendime lidhur me strukturën e vitit akademik, komisionet për monitorimin e pranimeve/regjistrimeve të reja, transferimin e studimeve, komisionet për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, etj. Po ashtu, janë propozuar dhe miratuar grupe pune të proceseve të organizuara në nivel universiteti, në komisione apo grupe të posaçme.

Këshilli i Etikës (organ kolegjial), në ushtrim të kompetencave të tij, shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale sipas parashikimeve të Kodit të Etikës të UST dhe në përputhje me Rregulloren e funksionimit të tij. Për vitin 2024-2025 Këshilli i Etikës ka marrë 20 (njëzet) propozime të shqyrtuara më pas nga Senati Akademik.

Konkretisht, tematika e këtyre vendimeve është si më poshtë:

- Vendime lidhur me veprimtarinë e Këshillit të Etikës; miratim të artikujve/projekteve kërkimore;
- Vendime të karakterit administrativ si: propozim për masë disiplinore.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (organ kolegjial), në ushtrim të kompetencave të saj, ka angazhuar anëtarët e saj në nivel fakulteti në komisionet (ad-hoc) përkatëse për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, monitorimin e procesit të regjistrimeve dhe pranimeve, të kalueshmërisë në vit të studentëve aktivë, etj. Gjatë vitit akademik 2024-2025 NjSBC ka realizuar analizën e Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS) të zhvilluar online nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL).

Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik ka ushtruar kompetencat e tij nëpërmjet vendimeve përkatëse të marra në mbledhjet e tij. Tipologjia e vendimeve të Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik është konkrete dhe konsiston në promovimin e personelit akademik të UST-së dhe jo vetëm.

3.3. Njësitë administrative ndihmës akademike (rektorat/dekanat) dhe komisionet ad- hoc

Rektorati/dekanatet (si njësi administrative), në ushtrim të kompetencave të tyre, kanë zbatuar (vendimet e organeve kolegjiale apo drejtuese) dhe kanë nxjerrë akte rregullative lidhur me procesin e pranimeve dhe regjistrimeve në programet e studimit që ofron UST-ja apo të transferimeve të studimeve, dhënien e përgjigjes dhe të zgjidhjes për kërkesat/ankesat individuale apo në grup drejtuar UST-së apo fakulteteve etj.

Gjithashtu, lidhur me organizimin e proceseve nga rektorati/dekanati, nëpërmjet komisioneve ad-hoc të ngritura për aspekte të veçanta të veprimtarisë akademike, evidentojmë se:

- Procesi i përlogaritjes së pikëve të maturantëve dhe rankimit të tyre, në kuadër të pranimeve në programet e studimit në UST, i kryer nga komisioni i monitorimit dhe grupi teknik (në nivel Fakulteti, përkatësisht në Fakultetin e Rehabilitimit), i ngritur për këtë qëllim, është realizuar me sukses.
- Procesi i pranimeve në programet e studimit tek Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes dhe Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit në fushën e edukimit fizik dhe shëndetit, që nga nxjerrja e akteve rregullative, proceset e aplikimit dhe të konkurrimit të studentëve, si dhe përzgjedhjes së programit kryhet dhe monitorohet tërësisht nga Rektorati i UST-së dhe dekanatet e fakulteteve përkatëse.

3.4. Aktiviteti i njësive kryesore

Fakultetet e Universitetit të Sporteve të Tiranë, janë organizuar në njësi bazë (departamente) sipas profilit të fushave të programeve të studimit që ofrojnë apo profilit të veprimtarisë lëndore, duke krijuar në këtë mënyrë mundësinë që departamentet të bashkërendojnë aktivitetet e tyre, në funksion të realizimit të procesit akademik e shkencor.

Po ashtu, departamentet dhe personeli akademik përkatës japin një kontribut të rëndësishëm në angazhimet për institucionin. Një pjesë e konsiderueshme e personelit akademik me kohë të plotë kanë qenë pjesë e komisioneve ad-hoc për proceset e pranimeve të studentëve në tre ciklet e studimit.

Në paragrafët e mëposhtëm jepet në mënyrë të përmblëdhur aktiviteti i secilit nga fakultetet e UST-së (informacioni i detajuar gjendet në raportet vjetore për vitin akademik 2024-2025 të secilit fakultet). Përkatësisht në Universitetin e Sporteve të Tiranës janë 3 Fakultete dhe njësia e Kërkimit Shkencor në Sport.

- Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes
 - Departamenti i Sporteve Kolektive
 - Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit
 - Departamenti i Sporteve Individuale
- Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit
 - Departamenti i Aktivitetit Fizik, Rekreacionit dhe Turizmit
 - Departamenti i Menaxhimit të Sportit dhe Turizmit
 - Departamenti i Lëvizjes dhe Shëndetit
- Fakulteti i Rehabilitimit
 - Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Humane
 - Departamenti i Kineziologjisë
 - Departamenti i Rehabilitimit
- Instituti i Kërkimit Shkencor në Sport
 - Departamenti i Performancës Sportive (DPS)
 - Departamenti i Aktivitetit Fizik dhe Shëndetit (DAFSH)
 - Departamenti i Projekteve dhe Teknologjisë

3.4.1. Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes

Realizimi i të gjitha programeve të studimit që FSHL-ja ofroi në vitin akademik 2024 - 2025, është mundësuar në bashkëpunim edhe me njësitë e tjera kryesore në përbërje të UST-së.

FSHL në vitin akademik 2024-2025 ka ofruar gjithësej 5 Programe Studimi aktive, konkretisht:

1. **Programe Studimi të ciklit të parë:**

- Një program studimi të ciklit të parë, “Bachelor “, në “Shkencat e Lëvizjes”.

2. **Programe studimi të ciklit të dytë:**

- Një program studimi të ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Shëndetësor"
- Një program studimi “Formimi i Vazhduar në Fushën e Psiko-Pedagogjisë”.

Programe studimi i ciklit të dytë, Master Profesional në “Trajner i Përgatitjes Fizike“, i cili nuk ka qenë aktiv në vitin akademik 2024-2025, pasi nuk ka patur studentë të regjistruar.

3. **Programe Studimi të ciklit të tretë:**

- Një Program Studimi, “Doktoraturë”, në Shkenca Sportive.

Programet e studimit që ofrohen në FSHL kanë si qëllim që të përgatisin specialistët e ardhshëm në fushat e shkencave të lëvizjes, mësues të edukimit fizik dhe shëndetit, specialistë të shkencave sportive

FSHL gjatë vitit akademik 2024-2025, mbylli me sukses mësimdhënien e programit të dytë të studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Shëndetësor”.

Ky program i ri Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Shëndetësor”, i cili është në vazhdimësinë e tij, pajis studentët me kompetencat e duhura për të vazhduar kërkimin në fushën e edukimit fizik dhe shëndetit. Ky program studimi plotëson kërkesat e studentëve për kualifikim të mëtejshëm për ciklin pasardhës të studimeve.

Programi i Studimit të Ciklit të Parë “BACHELOR”	Studentë të regjistruar	Përsëritës 2024-2025	Totali	Studentë të Diplomuar
Viti - I	193 st.	+ 51 st.	244 st.	161 st. Diplomuar
Viti - II	166 st.	+ 23 st.	189 st.	
Viti – III	168 st.	+ 45 st.	213 st.	
TOTALI	527	119	646	

Programi i studimit të Ciklit të Dytë MSH-MEFSSH	Studentë të regjistruar	Përsëritës 2024-2025	Totali	Studentë të Diplomuar
Viti I - MSH-MEFSSH	215 st.	+44 st.	259 st.	175 st. Diplomuar
Viti II -MSH-MEFSSH	178 st.	+32 st.	210 st.	

TOTALI	393 st.	76 st.	469 st	
---------------	----------------	---------------	---------------	--

Programi i studimit të Ciklit të Tretë “Doktoratë”	Studentë të Regjistruar
Viti akademik 2024-2025	3
Viti akademik 2023-2024	5
Viti akademik 2022-2023	11
Viti akademik 2021-2022	11
Total	30 <u>11 në proces përfundimi</u>

Program i Formimit të Vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike	Studentë të regjistruar	Studentë të diplomuar
Viti I	17	<u>15</u> studentë

Programi i studimit	Studentë të çregjistruar me kërkesën e tyre	Studentë të transferuar në FSHL
Bachelor	15	2
Master i Shkencave në “Mësuesi”	3	-

Fakulteti i Shkencave të Levizjes për vitin akademik 2024-2025, ka realizuar ngarkesën mësimore nga personelin akademik. Angazhimi i personelit akademik është realizuar në përputhje me kërkesat e programit mësimor dhe nevojat e njësive bazë, për të ofruar një mësimdhënie cilësore dhe mbulimin e të gjitha moduleve. Ky proces është kryer me qëllim sigurimin e një organizimi të efektshëm dhe të qëndrueshëm të mësimdhënies, duke respektuar normat dhe udhëzimet e përcaktuara nga autoritetet përkatëse. Veprimtaria e Departamenteve është përqendruar në përmbushjen e objektivave akademike, në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe në zhvillimin kërkimor-shkencor të stafit dhe studentëve.

Procesi i shpërndarjes së ngarkesës mësimore për vitin akademik 2024-2025 dhe mënyra se si janë organizuar marrëveshjet dhe angazhimet e stafit akademik, si dhe bashkëpunimi me njësitë tjera kryesore Universitetit të Sporteve të Tiranës.

Realizimi i Ngarkesës Mësimore për Stafin Akademik i përmbledhur (2024-2025)

Nr.	Institucioni i Arsimit të Lartë Publik	Numri i Stafit të brendshëm, miratuar në MASR sipas kreut VI, neni 59 të Ligjit nr.80/2015 i ndryshuar, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë"	Ngarkesa vjetore totale (në orë) e realizuar nga stafi i brendshëm në vitin akademik 2024-2025 (sipas kriterëve të Udhëzimit të MASR nr. 29, datë 10.09.2018, i ndryshuar)	Norma vjetore (në orë) për stafin e brendshëm (sipas Udhëzimit të MASR nr. 29, datë 10.09.2018, i ndryshuar)
	Totali (A+B+C)	46	13110.2	5940
A	Autoritetet drejtuese të IAL Publike	5	1878.8	430
1	Rektor / Drejtor Qendre Ndëruniversitare (QN)			

2	Zëvendësrektor / Zëvendësdejtör i QN			
3	Dekan	1	344	70
4	Zëvendësdekan	1	367	90
5	Përgjegjës Departamenti	3	1167.8	270
B	Stafi akademik me kohë të plotë	34	10698.2	4670
1	Profesor	4	772.6	280
2	Profesor i asociuar	12	3079.6	1120
3	Lektor	9	2960.8	1320
4	Asistent Lektor	9	3885.2	1950
5	Kërkues			
Nr.	Institucioni i Arsimit të Lartë Publik	Numri i stafit të jashtëm, miratuar në MASR sipas kreut VI, neni 59 të Ligjit nr.80/2015 i ndryshuar "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë"	Ngarkesa vjetore totale (në orë) e realizuar nga stafi akademik i ftuar, si dhe pedagogë të jashtëm, staf (sipas kritereve të Udhëzimit të MASR nr. 29, datë 10.09.2018, i ndryshuar)	Norma vjetore (në orë) për stafin akademik të ftuar, si dhe pedagogë të jashtëm, staf (sipas udhëzimit MASR nr.29 datë 10.09.2018 i ndryshuar)
C	Stafi akademik me kohë të pjesshme	7	533.2	840
1	Profesor			
2	Profesor i asociuar	1	60	120
4	Lektor	3	202	360
5	Asistent Lektor	3	271.2	360

**NGARKESA MËSIMORE VJETORE 2024-2025 E
STAFIT AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË NË FSHL**

Tabela DEPARTAMENTI I EDUKIMIT DHE SHËNDETIT						
Emer Mbiemer	Grada/ Titulli	Programi Studimit	Lenda/ Moduli	Orë Realizuar sipa Normes Vjetore	Orë të pagueshme mbi normë (deri 200 orë)	Ore te paguare mbi 200 ore
D. SALLAKU	Prof.Asc. Dekan	BCH/MSH	Did/VI/Met/Prak	344	200	74
R. SELENICA	Prof.Asc.Drejt.Dep	BCH/MSH	Teo/Fit/Ster/Perf.	388	200	98
O. KOSTA	Dr.	BCH/MSH	Biok/Biol/Ekol/P	367	200	77
K. VRENJO	Prof.Asc.	BCH/MSH	Fizio/Tes/Prakt	412	200	72
B. MISJA	Prof.DR.	BCH/MSH	His/Kon.Mot/Pra	262	122	
F. GJATA	Prof.Dr	BCH/MSH	Soc/Ker.Sh/Prak.	256	116	
J. JARANI	Prof.Asc	BCH/MSH	Sj.Mot/Ker.SH/	452.2	200	100
N. QUKA	Prof.Asc.	BCH/MSH	Loj.L/Ed.L/Ak.F/	438.4	200	98.4
M. SHEHU	Dr.	BCH/MSH	Ped/Kurr/Mend/	421	200	56
K.USHTELENCA	Dr.	BCH/MSH	Test/EF/Fit/Perf	460.4	200	95.4
B. ALIAJ	Dr.	BCH/MSH	Psi/Arsim	465	200	100
J. BALLA	Dr.	BCH/MSH	Bio/Esh/Prak	315	150	
M. CENAJ	Dr.	BCH	Anglisht	411	200	46
B. MEMA	MSC	BCH/MSH	Did/Test/Org/Pra	302.2	107.2	
T. PRIFTI	MSC	BCH	Reh/Fizio/Terapi	367.4	172.4	

Tabela DEPARTAMENTI SPORTEVE KOLEKTIVE						
Emer Mbiemer	Grada/ Titulli	Programi Studimit	Lenda/ Moduli	Ore, Realizuar sipas Normes	Orë paguar mbi normë deri 200 orë	Ore paguar mbi 200 ore
A. SHEHU	Prof.Asc.Drejt. Dep	BCH/ MSH	Met.LS .Vboll	360.8	200	70.8
A. MARTIRI	Prof.Asc.	BCH/ MSH	Met.LS. Vboll	339.8	199.8	0
A. SPAHI	Dr.	BCH/ MSH	Met.LS.BBoll	420	200	55
E. MUKA	Dr.	BCH	Vboll	431.6	200	36.6
L. KOCI	Msc.	BCH	Met.LS.BBoll	439	200	44
A. BICI	Msc.	BCH /MSH	Fboll	477.6	200	82.6
A. GALO	Msc.	BCH	Fboll	365	170	0
E. DAMO	Msc.	BCH	Vboll	390	195	0
A. CUNGU	Msc.	BCH	Fboll	326	131	0

Tabela DEPARTAMENTI I SPORTEVE INDIVIDUALE						
Emer Mbiemer	Grada/ Titulli	Programi Studimit	Lenda/ Moduli	Ore, Realizuar sipas Normes	Orë paguar mbi normë deri 200 orë	Ore paguar mbi 200 ore
E. IKONOMI	Prof.Asc.Drejtues.Dep	BCH/MSH	GJ/Danc/Aer	338.56	200	48.56
A. META	Prof.Dr	BCH/MSH	GJ/Danc/Aer	259.4	119.4	
N. DAKO	Prof.Asc.	BCH/MSH	GJ/Danc/Aer	452.36	200	100
E. BANO	Dr.	BCH/MSH	GJ/Danc/Ski	455.92	200	90.92
F. KOVACI	Prof.Asc.	BCH/MSH	Atl/Tur/Ski	389.6	200	49.6
A. CAUSHI	Dr.	BCH/MSH	Not/Atl/	412.8	200	47.8
L. DERHEMI	Msc.	BCH	Atl/Not/Tur	426.8	200	31.8
K. KAPEDANI	Prof.Asc.	BCH/MSH	Mun/Ski/Not	334	194	-
S. BUSHATI	Prof.Asc.	BCH/MSH	Box/Tur/Not	437.6	200	97.6
A. BULKU	Msc.	BCH	Mund/Tur/Ski	342.2	147.2	

Angazhimi i personelit akademik me Kohë të Pjesshme është realizuar në zbatim të Rregullores së UST-së, me konkurs të shpallur si gjithmonë në website-in zyrtar të UST-së. Vlerësimi i kandidatëve është bërë nga komisionet e propozuara nga njësitë bazë dhe me miratim nga Dekani i FSHL-ës.

Tabela NGARKESA MËSIMORE VJETORE 2024-2025 E PERSONELIT AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME						
Nr.	EMËR MBIEMËR	Bachelor MSH-MEFSSH	Norma Vjetore	Njësia Bazë	Orë Planifikuar	Orë Realizuar
1.	Prof.Asc. Dr. Nazmi Xhomar	Bach-Vleresim Nxenit	120	DESH	60 orë	60
2.	Dr. Albana Daka	Bach-Edukim Ushqyerit	120	DESH	45 orë	44
3.	Dr. Edmira Cakrani	Bach-Statist. e Aplikuar	120	DESH	115 orë	94
4.	Dr. Gazmend Zeneli	Bach-Teo. Met.Kerkimi	120	DESH	70 orë	64
5.	Mirela Muca	Bach-Statistik Aplikuar	120	DESH	105 orë	84

6.	Msc. Rigers Dervishi	Bach-Dance	120	DSI	120	113.6
7.	Msc. Xheni Kozi	Bach-Gjinnastike	120	DSI	67.2	59.6

Procesi mësimor është karakterizuar nga një aktivizim profesional i punonjësve mësimorë dhe ndihmës- mësimorë. Vërehet një përgatitje profesionale dhe sistematike që shprehet konkretisht në aspektet teorike dhe praktike në lëndët përkatëse, duke shfaqur dëshirë e pasion për profesionin nga pedagogët e këtij fakulteti.

Theksojmë se pedagogët e FSHL-së kanë arritur një përvojë të mirë profesionale e shkencore në zhvillimin e mëimit, si në aspektin teorik dhe atë praktik. Për arritjet dhe realizimet në këtë vit akademik, falenderimet shkojnë për të gjithë stafin akademik dhe atë ndihmës akademik të përfshirë në këtë proces.

3.4.2. Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, FVFR

Dekanati i FVFR-së në bashkëpunim të plotë me 3 (tre) njësitë bazë të tij, ka synuar realizimin e të gjitha objektivave që burojnë nga zbatimi me korrektësi i Planeve Mësimore dhe Programeve lëndore në të treja ciklet e studimit duke zbatuar standartet akademike. Përgjegjshmëria profesionale në plotësimin e detyrave të stafit akademik dhe atij ndihmës akademik, ka mundësuar përmbushjen e objektivave të Fakultetit dhe realizimit me sukses të 5 (pesë) programeve të studimit.

Si çdo vit tjetër akademik, u morën të gjitha masat e duhura organizative për zhvillimin me sukses të Konkursit të Pranimit të studentëve të rinj në programin e ciklit të parë të studimeve në Bachelor, i cili u karakterizua nga profesionalizmi i Komisionit dhe bashkëpunimi efikas me strukturat e tjera të UST. Duhet theksuar se këtë vit nuk u evidentua asnjë kontestim i rezultateve të shënuara.

FVFR në bashkëpunim me strukturat organizative të UST, me përgjegjësi profesionale arriti që procesin mësimor të vitit akademik 2024 – 2025 ta përmbyllë me sukses, duke realizuar të gjitha programet mësimore që ofron brenda vitit akademik.

Nga analizat vjetore të departamenteve evidentohet qartë se është punuar në të gjithë komponentët e strukturave të procesit mësimor si dhe në përputhje me objektivat e punës kërkimore shkencore edhe në kushtet jonormale të punës. Vlerësimi punës së pedagogëve të FVFR konsiderohet përgjithësisht i realizuar dhe korrekt sipas procedurave të planifikuara, kërkesave dhe udhëzimeve të departamenteve, Fakultetit dhe Rektoratit.

PROGRAMET E STUDIMIT 2024-2025						
FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT						
Nr.	Programi i studimit	Kredite	Leja për hapjen	Statusi	Vendimi i akreditimit	Vlefshmëria e akreditimit
1	Bachelor në “Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit”	180	VKM Nr. 515, datë 30.06.2010	Aktiv	Vendim Nr. 30, datë 14.05.2020	13.05.2026

2	Program i ciklit të tretë në “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”	180	Urdhër Nr 98, datë 25.02.2023	Aktiv	N/A	Realizuar vlerësimi i ekspertëve të jashtëm, në pritje të vendimit të bordit të ASCAL
3	Master i Shkencave në “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti” ¹	120	Urdhër Nr. 48, datë 05.02.2015	Aktiv	Vendim Nr. 19, datë 19.02.2021	Realizuar vlerësimi i ekspertëve të jashtëm, në pritje të vendimit të bordit të ASCAL
4	Master Profesional në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” ¹	60	Urdhër Nr. 395, datë 05.09.2017	Aktiv	Vendim Nr.25, datë 13.07.2018	Realizuar vlerësimi i ekspertëve të jashtëm, në pritje të vendimit të bordit të ASCAL
5	Master Profesional në “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni – Trajner Fitnesi”	60	Urdhër Nr. 51, datë 05.02.2015	Aktiv	Vendim Nr. 18, datë 09.02.2021	30.09.2026

TË DHËNA STATISTIKORE PËR STUDENTËT PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025									
Fakulteti / Emërtimi i Programit të Studimit	Studentë të regjistruar				Studentë kalues	Studentë të diplomuar	Studentë të çregjistruar	Studentë të transferuar	Studentë të shkëlqyer
	Total	Viti I	Viti II	Viti III					
FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT									
Bachelor në “Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit	649	249	221	179	456	132	25	2	-
Master Shkencor në “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”	43	22	21	-	34	15	2	-	7
Master Profesional në “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni – Trajner Fitnesi”	12	12	-	-	10	10	1	-	-
Master Profesional në “Menaxhim në Sport e Turizëm”	27	27	-	-	14	14	5	-	1
Program i ciklit të tretë në “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”	33	3	8	22	-	-	-	-	-

Vlen të theksohet realizimi me sukses i programeve outdoor “Sporte Dimërore”, “Sporte Ujore”, “Kamping Veror - Malor” brenda vitit akademik.

Realizimi me sukses i të gjitha programeve të studimit u mundësua nga kapacitetet akademike të Fakultetit në total 28 lektorë, nga të cilët 26 pedagogë efektivë dhe 2 pedagogë të punësuar me kohë të pjesshme.

Nga analizat vjetore te departamenteve evidentohet qartë se është punuar në të gjithë komponentët e

strukturave të procesit mësimor si dhe në përputhje me objektivat e punës kërkimore shkencore, në jo pak raste edhe në kushte jonormale të punës. Vlerësimi punës së pedagogëve të FVFR-së konsiderohet përgjithësisht i realizuar dhe korrekt sipas procedurave të planifikuara, kërkesave dhe udhëzimeve të departamenteve, Fakultetit dhe Rektoratit.

Drejtuesit e Departamenteve dhe organet vendimmarrëse të Fakultetit janë angazhuar në zbatimin e kuadrit rregullator të programeve të studimit, duke i plotësuar ato me informacionin që lidhet me objektivat e këtyre programeve, vlerësimin e shfrytëzimin e infrastrukturës të vënë në dispozicion për zhvillimin normal të procesit mësimor në të gjitha ciklet.

Realizimi i Ngarkesës Mësimore për Stafin Akademik i përmbledhur (2024-2025)

Nr.	InstitucionI i Arsimit të Lartë	Numri i Stafit të brëndshëm	Ngarkesa vjetore totale (në orë) e realizuar	Norma vjetore (në orë)
	Totali (A+B+C)	28	9750.2	4390
A	Autoritetet drejtuese të IAL Publike	5	1719	430
1	Rektor	-	-	-
2	Zëvendësrektor	-	-	-
3	Dekan	1	288	70
4	Zëvendësdekan	1	418	90
5	Përgjegjës Departamenti	3	1013	270
B	Stafi akademik me kohë të plotë	21	7945.2	3720
1	Profesor	-	-	-
2	Profesor i asociuar	3	1237	420
3	Lektor	7	2314.4	1155
4	Asistent Lektor	11	4393.8	2145
5	Kërkues	-	-	-
Nr.	Institucioni i Arsimit të Lartë	Numri i Stafit të jashtëm,	Ngarkesa vjetore totale (në orë) e realizuar nga stafi	Norma vjetore (në orë)
C	Stafi akademik me kohë të pjesshme	2	86	240

Nga pedagogët kanë rishikuar programet e lëndëve / moduleve përkatëse, në mënyrë që të dhënat e tabelave sipas planeve mësimore të gjejnë pasqyrim të plotë në organizimin e elementëve përbërës të secilit syllabus; janë realizuar punime shkencore në përputhje me planifikimet; janë orientuar dhe udhëhequr studentët për realizimin e mikrotezave si dhe janë realizuar një sërë aktivitesh shkencore dhe rekreative/sportive me studentët.

Realizimi i Ngarkesës Mësimore për Stafin Akademik (2024-2025) dhe planifikimi për vitin pasardhës sipas Departamenteve:

Dep.	Emri dhe Mbiemri	Titulli / Grada	Norma Vjetore (Orë) (2024-2025)	Orë të Planifikuara (2024-2025)	Orë të Realizuara (2024-2025)	Orë të Planifikuara (2025-2026)
LSH	Surven Metolli	PhD.	90	324	318	424
	Anesti Qeleshi	Prof.Asc.Dr.	140	382	325	276
	Aida Bendo	Prof.Asc.Dr.	140	496	489	494
	Valbona Pumo	Dr.	165	244.2	229.8	282.8
	Erton Zekaj	Dr.	165	353	295	437.4
	Ornela Marko	Msc.	195	355	352	351
	Afrim Bilali	Msc.	195	313.8	302.4	318.6
	Kristian Andrea	Msc.	195	402.2	379	406.2
	Junida Pogoni	Msc.	195	308	298.4	338.4
	TOTALI	-	-	3178.2	2988.6	3328.4

Dep.	Emri dhe Mbiemri	Titulli / Grada	Norma Vjetore (Orë) (2024-2025)	Orë të Planifikuara (2024-2025)	Orë të Realizuara (2024-2025)	Orë të Planifikuara (2025-2026)
MST	Entela Kushta	Dr.	90	400	394	408
	Anduela Lile	Doc.	90	459	418	459
	Rovena Elmazi	Dr.	165	235	208	205
	Rando Kukeli	Dr.	165	450.6	447.4	446.6
	Andis Bogdani	Dr.	165	416	391	429
	Lumtor Shkreli	Msc.	195	365	337	325
	Orges Liçaj	Msc.	195	483.8	415	407.6
	Indrit Reka	Msc.	195	370	368	280

Dep.	Emri dhe Mbiemri	Titulli / Grada	Norma Vjetore (Orë) (2024-2025)	Orë të Planifikuara (2024-2025)	Orë të Realizuara (2024-2025)	Orë të Planifikuara (2025-2026)
AFRT	Ferdinand Mara	Prof.Dr	90	321.8	301	321.8
	Elton Spahiu	Prof.Asc.Dr	70	294	288	315.2
	Robert Citozi	Prof.Asc.Dr	140	457.4	423	485
	Aledia Kondaj	Dr	165	468	407.2	444.8
	Oriana Hanxhari	Dr	132	339	336	344
	Jorida Cobaj	Msc	165	508.4	473.2	452.4
	Henri Dibra	Msc	165	478	463.6	461.2
	Klajdi Xhebexhiu	Msc	195	556	529.6	541.6
	Andi Baze	Msc	195	491.6	475.6	526.4
	TOTALI	-	-	3914.2	3697.2	3892.4

Ka vijuar viti i dytë i studimeve doktorale, si dhe janë dorëzuar e referuar shtojcat përkatëse sipas rregullores së programit të studimit. Pas hapjes së thirrjes për Ciklin e Tretë të Studimeve “Doktoratë”, më datë 16.08.2023 departamentit i janë përcjelle dosjet e kandidatëve, me Nr. 1957/1 Prot deri Nr. 1957/6 Prot, datë 19.08.2023.

Përgjatë këtij viti akademik, Departamenti u mor me mbarrëvajtjen e referimeve për programin e Ciklit të Tretë të studimeve “Doktoratë”. Doktorantët e dy viteve të para kanë bërë referimet e Shtojcës 8 “Review Literature” dhe Shtojcës 9 “Metodologjia e Kërkimit dhe Shtojcës 10.

Referimet e doktorantëve:

Nr.	Doktoranti	Referimi I "Review Literature" Data e Referimit	Referimi II "Metodologjia e Kërkimit" Date e Referimit
1	Anxhela Ahmataj	21.11.2024	26.09.2025
2	Blend Hoxholli	24.01.2025	26.09.2025
3	Dorian Meta	21.11.2024	26.09.2025
4	Franz Zurani	24.01.2025	17.10.2025
5	Lorena Haxhihyseni	24.01.2025	26.09.2025
6	Narvina Sinani	24.01.2025	26.09.2025
7	Perli Rusi	21.11.2024	26.09.2025
8	Redon Zotaj	24.01.2025	

Nr.	Doktoranti	Referimi III "Arritjet edhe Rezultate e Kërkimit" Data e referimit
1	Altin Erindi	30.09.2024
2	Anduela Lile	30.09.2024
3	Denis Nuriu	21.11.2024
4	Jorida Çobaj	30.09.2024
5	Klajdi Xhepexhiu	30.09.2024
6	Kristian Andrea	30.09.2024
7	Lumtor Shkreli	30.09.2024
8	Orges Liçaj	21.11.2024

Informimi mbi çështjet administrative (tarifat, regjistrimet në sistem, etj) ka qenë kryesisht në kohë dhe i qartë përmes komunikimit me e-mail, si dhe njoftimeve publike në website zyrtar (ust.edu.al) dhe në faqen zyrtare të Facebook të FVFR-së.

Në vitin akademik 2024-2025 janë zhvilluar në përputhje me objektivat programet e mëposhtme (jashtë auditorit) të cilat mbeten programet më identifikuese dhe elementet më të fuqishme të marketingut të FVFR-së si njësi kryesore:

- **Bachelor në “Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit”:**
 - ✓ Praktika profesionale
 - ✓ Sporte Dimërore (Voskopojë)
 - ✓ Sporte Ujore (Jalë)
 - ✓ Kamping Veror - Malor (Theth)
- **Master Profesional “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”:**
 - ✓ Aktivitete në Natyrë – Stazh Dimër (Qafë-Shtamë)
 - ✓ Aktivitete në Natyrë – Stazh Verë (Jalë)
 - ✓ Praktika profesionale
- **Master Profesional “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni -Trajner Fitnesi”:**

- ✓ Metodika e Sporteve Ujore – Stazh Verë (Jalë)
- ✓ Praktika Profesionale
- **Master Shkencor “Akviteti Fizik dhe Shëndeti”:**
 - ✓ Eksplorim Turistik (në qytete të ndryshme)

Krahas mësimdhënies, i gjithë stafi akademik ka përmbyshur detyrimin ligjor për kërkimin shkencor, që pasqyrohet në evidencën përkatëse.

Gjithashtu, stafi akademik është angazhuar edhe në proceset e ndryshme administrative që kanë ndodhur në nivel Njësie Bazë/Njësie Kryesore/Universiteti.

Këtu përmendim kontributin e stafit në:

- Rishikimin e shpërndarjes së orëve mësimore (konvertimi/ECTS me orë mësimore) në përputhje me rregulloret e reja të miratuara.
- Rishikimin e planit mësimor të ciklit të parë të studimeve.

Të gjitha këto procese kanë përfunduar me sukses dhe kanë sjellë rezultate konkrete si: rregullorja e rishikuar e Universitetit, Fakultetit, departamenteve, programeve të studimit etj. Kemi një plan mësimor të rishikuar konform udhëzimeve ligjore për shpërndarjen e krediteve dhe orëve mësimore sipas numrit të krediteve për lëndë apo module.

FVFR u angazhua edhe për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2025 për çdo program studimi.

Stafi akademik është angazhuar edhe në proceset që kanë ndodhur në nivel Njësie Bazë/Njësie Kryesore/Universiteti. Këtu përmendim kontributin e stafit në:

- Zbatimin e Rregullores së Fakultetit, rregulloreve të departamenteve, rregulloreve të programeve të studimit e rregulloreve të praktikave profesionale.
- Rishikimi i programeve lëndore (programet e lëndëve/moduleve).
- Realizimi i punës shkencore (sipas planifikimeve).
- Realizimin e programit ERSAMUS +.
- Rekrutimin e studentëve të rinj (plotësimi i kuotave).
- Vazhdimi me sukses i studimeve doktorale.
- Përfaqësimi në Bordin e Administrimit (Prof.Asc.Dr. Aida Bendo).
- Në Senatin Akademik të UST-së.
- Komisioni i Projekteve (Prof.Asc.Dr. Ferdinand Mara).
- Komisioni i Mbarëvajtjes së punës me studentët (PhD. Surven Metolli).
- Komisioni i Kurrikulës (Doc. Anduela Lile / Eni Tanushi – Studente në FVFR)
- Përfshirja aktive e stafit në njësitë e UST.
- NJSBC (Doc. Anduela Lile, Dr. Entela Kushta).
- Përfshirja e stafit të FVFR-së në bashkëorganizimin e konferencave ndërkombëtare Shkencore.
- Pjesëmarrja aktive dhe masive e studentëve të FVFR-së në çdo aktivitet brenda dhe jashtë UST-së (ndryshe nga dy njësitë e tjera).

3.4.3. Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit

Dekanati i FSHR-së në bashkëpunim të plotë më 3 (tre) njësitë bazë të tij, ka synuar realizimin e të gjitha objektivave që burojnë nga zbatimi me korrektësi i Planeve Mësimore dhe Programeve lëndore në të treja ciklet e studimit duke zbatuar standartet akademike. Përgjegjshmëria profesionale në plotësimin e detyrave të stafit akademik dhe atij ndihmës akademik, ka mundësuar përmbushjen e objektivave të Fakultetit dhe realizimit me sukses të 2 (dy) programeve të studimit: Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit” dhe programi i ciklit të sytë Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”.

Si çdo vit tjetër akademik, u morën të gjitha masat e duhura organizative për ngritjen e Komisioneve të Pranimi të studentëve të rinj në programin e ciklit të parë të studimeve në Bachelor, i cili u karakterizua nga profesionalizmi i Komisionit dhe bashkëpunimi efikas me strukturat e tjera të UST. Duhet theksuar se këtë vit nuk u evidentua asnjë kontestim i renditjeve të listuara në faqen zyrtare.

FSHR në bashkëpunim me strukturat organizative të UST, me përgjegjësi profesionale arriti që procesin mësimor të vitit akademik 2024 – 2025 ta përmbyllë me sukses, duke realizuar të gjitha programet mësimore që ofron brenda vitit akademik.

FSHR Emërtimi i Programit të Studimit	Studentë të regjistruar 2024-2025 <i>/studentë përsëritës</i>				Studentë kalues	Studentë të diplomuar	Studentë të çregjistruar	Studentë të transferuar	Studentë të shkëlqyer
	Total	Viti I	Viti II	Viti III					
1. Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit”	162	53 (33 <i>st.përs</i>)	52 (17 <i>st.përs</i>)	57 (17 <i>st.përs</i>)	92	37	5	-	1
2. Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”	33				23	23	-	-	0 (3 me <i>mesatare</i> <i>mbi 8</i>)

Për vitin akademik 2024-2025, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit ka realizuar një planifikim të detajuar dhe të mirëstrukturuar të ngarkesës mësimore për personelin akademik. Ky proces është kryer me qëllim sigurimin e një organizimi të efektshëm dhe të qëndrueshëm të mësimdhënies, duke respektuar normat dhe udhëzimet e përcaktuara nga autoritetet përkatëse. Angazhimi i personelit akademik është realizuar në përputhje me kërkesat e programit mësimor dhe nevojat e njësive bazë, për të ofruar një mësimdhënie cilësore dhe mbulimin e të gjitha moduleve.

Në këtë kontekst, ky raport pasqyron procesin e shpërndarjes së ngarkesës mësimore për vitin akademik 2024-2025 dhe mënyrën se si janë organizuar marrëveshjet dhe angazhimet e stafit akademik, si dhe bashkëpunimi me njësitë tjera kryesore të UST-së, për të realizuar procesin mësimor në mënyrë efektive.

Realizimi i Ngarkesës Mësimore për Stafin Akademik (2024 – 2025)

Nr.	Institucioni i Arsimit të Lartë	Numri i Stafit të brëndshëm	Ngarkesa vjetore totale (në orë) e realizuar	Norma vjetore (në orë)
	Totali (A+B+C)	35	7181.6	4810
A	Autoritetet drejtuese të IAL Publike	5	1307	430
1	Rektor			
2	Zëvendësrektor			
3	Dekan	1	83	70
4	Zëvendësdekan	1	412	90
5	Përgjegjës Departamenti	3	812	270
B	Stafi akademik me kohë të plotë	16	4724.6	2700
1	Profesor	2	572	200
2	Profesor i asociuar	2	438.8	280
3	Lektor	4	1264.6	660
4	Asistent Lektor	8	2449.2	1560
5	Kërkues			
C	Stafi akademik me kohë të pjesshme	14	1150	1680

Tabela Nr. 1 – Departamenti i Shkencave Biomjekesore dhe Humane

Nr.	Emër Mbiemër	Titulli Akademik	Me kohë të Plotë / Pjesshme)	Ngarkesa vjetore orë mësimore	Ngarkesa orë mësimore e realizuar
1	Oltiana Petri	Prof. Asc.	Me kohë të Plotë	222	236
2	Genti Pano	Prof. Asc	Me kohë të Plotë	236.8	276.8
3	Fregen Dedja	Msc	Me kohë të Plotë	348.8	348.8
4	Alban Malaj	Dr	Me kohë të Plotë	220	218
5	Jonida Peppo	Msc	Me kohë të Plotë	235	224
6	Salvador Kurti	Msc	Me kohë të Plotë	407.8	402.8
7	Artur Kollçku	Dr	Me kohë të Pjesshme	30	30
8	Narvina Sinani	Msc	Me kohë të Pjesshme	30	30
9	Alkerta Ibranji	Msc	Me kohë të Pjesshme	20	20

Tabela Nr. 2 – Departamenti i Kineziologjisë

Nr	Emër Mbiemër	Titulli Akademik	Me kohë të Plotë / Pjesshme)	Ngarkesa vjetore orë mësimore	Ngarkesa orë mësimore e realizuar
1	Genta Nallbani	Prof.Asc.	Me kohë të Plotë	395	344
2	Lindita Agolli	Prof.Dr.	Me kohë të Plotë	233	278
3	Dhimitraq Prfti	Prof. Dr.	Me kohë të Plotë	309	294
4	Altin Erindi	Doc	Me kohë të Plotë	257	245
5	Andromeda Lalaj	Msc	Me kohë të Plotë	265	265
6	Ana Sulaj	Msc	Me kohë të Plotë	345	335
7	Arben Bozaxhiu	Msc	Me kohë të Plotë	453.6	445.6
8	Silvi Bozo	Prof.Asc.	Me kohë të Pjesshme	10	10

Tabela Nr. 3 – Departamenti i Rehabilitimit

Nr.	Emër Mbiemër	Titulli Akademik	Me kohë të Plotë / Pjesshme)	Ngarkesa vjetore orë mësimore	Ngarkesa orë mësimore e realizuar
1	Klejda Tani	Dr	Me kohë të Plotë	194	232
2	Robert Çina	Prof.Dr	Me kohë të Plotë	88	83
3	Vjollca Shpata	Prof.Dr	Me kohë të Plotë	162	162
4	Jonida Drizaj	Msc	Me kohë të Plotë	255.6	252
5	Elizabeta Dodaj	Msc	Me kohë të Plotë	323	319
6	Suela Xhufi	Msc	Me kohë të Plotë	318	356
7	Orest Shytaj	Msc	Me kohë të Plotë	312.4	302.6
8	Sara Bashollari	Msc	Me kohë të Pjesshme	105	105
9	Endri Thanasaj	Msc	Me kohë të Pjesshme	105	105
10	Amarilda Xhaferi	Msc	Me kohë të Pjesshme	105	105
11	Brikela Zaimi	Msc	Me kohë të Pjesshme	66	66
12	Ilvi Begolli	Msc	Me kohë të Pjesshme	119	111
13	Endrit Mone	Msc	Me kohë të Pjesshme	115	115
14	Merushë Curri	Msc	Me kohë të Pjesshme	105	105
15	Anxhela Ahmataj	Msc	Me kohë të Pjesshme	115	115
16	Perli Rusi	Msc	Me kohë të Pjesshme	115	115
17	Brunilda Kekezi	Msc	Me kohë të Pjesshme	105	105

Tabela Nr. 4 – Ngarkesa vjetore total e realizuar në FSHR (2024–2025)

Stafi Akademik	Orë të realizuara	Koment
Stafi akademik me kohë të plotë	6031.6 orë	Realizon pjesën kryesore të ngarkesës mësimore dhe siguron funksionimin e rregullt të procesit mësimor.
Stafi akademik me kohë të pjesshme	1150 orë	Siguron kontribut shtesë për plotësimin e nevojave të departamenteve për orë mësimore.
Total i orëve	7181.6 orë	-

Për vitin akademik 2024-2025, njësitë bazë në FSHR, kanë shpërndarë ngarkesën mësimore vjetore për secilin anëtar të personelit akademik me kohë të plotë, sipas normës vjetore përkatëse.

Nga të gjitha departamentet, është vijuar normalisht me procesin e përgatitjes së marrëveshjeve sipas Udhëzimit Nr.29, datë 10.09.2018, duke siguruar që çdo anëtar i stafit të ketë angazhimin e përshtatshëm për këtë vit akademik.

Në të njëjtën kohë, orët për modulet specifike që nuk mund të realizohen nga pedagogët efektivë të FSHR-së, janë përcjellë në mënyrë zyrtare si orë mësimore të lira në njësitë e tjera kryesore të UST-së: Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit dhe Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit.

Për të mbuluar plotësisht procesin mësimor për këtë vit akademik, është bërë e nevojshme angazhimi i lektorëve dhe asistentëve me kohë të pjesshme në Departamentin e Shkencave Biomjekësore dhe Humane, Departamentin e Kineziologjisë dhe Departamentin e Rehabilitimit. Po ashtu, janë përcaktuar modulet specifike për të cilat ka lindur nevoja për të plotësuar angazhimet me staf akademik me kohë të pjesshme.

Si konkluzion, përgjatë vitit akademik 2024-2025 në FSHR procesi mësimor në përgjithësi ka patur një ecuri normale dhe pa problematika.

3.4.4. Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit

Një nga treguesit e performancës së IKSHS është aftësia për të transferuar njohuritë e prodhuara përmes kërkimit shkencor drejtpërdrejt në auditorët e studentëve. Edhe pse stafi i IKSHS ka një profil primar kërkimor, kontributi i tyre në procesin mësimor ka qenë thelbësor për mbulimin e nevojave akademike të tre fakulteteve të UST.

Analiza e ngarkesës mësimore tregon se stafi akademik jo vetëm që ka përmbushur normën e përcaktuar prej 30% të punës në auditor, por edhe e ka tejkaluar atë, duke marrë përsipër orë suplementare për të garantuar mbarëvajtjen e programeve të studimit Bachelor dhe Master. Ky angazhim dëshmon për një ndjenjë përgjegjësie institucionale.

Për të kuptuar më mirë shpërndarjen e ngarkesës dhe kontributin individual, është e nevojshme të analizohen të dhënat për secilin anëtar të stafit akademik. Kjo analizë eidenton mbingarkesën e stafit dhe nevojën për njohjen e kontributit suplementar.

Pasqyra Analitike e Realizimit të Ngarkesës Mësimore për Stafin Akademik (2024 – 2025)

Emri dhe Mbiemri	Titulli / Grada	Departamenti & Pozicioni	Norma Vjetore (Orë)	Orë të Realizuara (Fakt)	Orë Suplementare (Max 100)	Kontribut Vullnetar (Pa pagesë)	Programet e Mbuluara
Dh. Bozo	Prof. Dr.	Drejtuese DAFSH	27	72	45	0	Master / Doktoraturë
J. Latifaj	Prof.Dr.	DAFSH	42	0	0	0	Doktoraturë
E. Neziri	Dr.	DAFSH	50	166	100	16	Bachelor / Master
D. Nuriu	Msc.	DAFSH	59	157	98	0	Bachelor
B. Hoxha	Msc.	DAFSH	59	88	29	0	Bachelor
A. Bajaziti	Msc.	DAFSH	59	168	100	9	Bachelor / Master
Dh. Skenderi	Msc.	DAFSH	42	153	100	11	Master/Doktorature
A. Kasa	Msc.	Rektor / DPT	15	140	0	125	Master / Doktoraturë
E. Mehmeti	Prof. Assoc.	Drejtuese DPT	27	93	66	0	Bachelor / Master
H. Orhani	Msc	DPT	59	119	60	0	Bachelor/Master
A. Llaftiu	Msc.	DPT	59	85	26	0	Bachelor / Master
A. Mucalliu	Msc	DPT	59	180	100	21	Bachelor
F. Vitobello	Msc	DPT	59	120.6	61.6	0	Bachelor
E. Lleshi	Prof. Assoc.	Drejtuese DPS	27	143.6	100	16.6	Bach./ Mas./ Dokto.
J. Hoxha	PhD	DPT	49	88	39	0	Bachelor/Mas
F. Brovina	Prof/Asoc.Dr.	Drejtor IKSHS-DPS	21	170	100	49	Master/Doktorature
A. Kaçurri	Prof/Asoc.Dr.	Zv/rektor-DPS	21	44	23	0	Master/Doktorature
M. Plasa	Msc.	DPS	59	221.6	100	62.6	Bachelor
M. Bushati	Msc.	DPS	59	172.8	100	13.8	Bachelor
A. Nurja	Msc.	DPS	59	167.2	100	8.2	Bachelor/Ma
M. Dodaj	Msc.	DPS	59	193.4	100	34.4	Bachelor/ Master
A. Kasmi	Msc.	DPS	59	238.2	100	79.2	Bachelor
TOTALI	22 vete Staf Akademik	N/A	N/A	2980.4	1547.6	445.8	N/A

3.4.5. Sekretaritë mësimore në njësitë kryesore

Sekretaria mësimore është njësi në funksion të procesit mësimor dhe studentëve. Personeli i sekretarisë mësimore është përgjegjës për të gjitha procedurat që ka kryer fakulteti gjatë vitit akademik në lidhje me regjistrimet, transferimet dhe procesin mësimor.

Konkretisht, me fillimin e vitit të ri akademik, sekretaria:

- hap regjistrat e notave ku pasqyrohen studentët sipas grupeve, planeve mësimore për vitet e para, të dyta e në vazhdim, të cilët vazhdojnë studimet në fakultet;
- regjistrat elektronikë ku pasqyrohen studentët sipas grupeve, planeve mësimore për të gjitha vitet, të cilët vazhdojnë studimet në fakultetin përkatës;
- hedh të dhënat dhe gjeneralitetet e secilit student në Regjistrin Themeltar dhe në formë elektronike, për të mundësuar:
- pajisjen e tij me numër matrikullimi;
- aktivizimin e studentit elektronikisht në Sistemin për menaxhimin e të dhënave të studentëve, Pitagora;
- nxjerr statistikat për studentët sipas viteve të studimit (femra/meshkuj; fshat/qytet; trojet, shpërndarja sipas grup moshave për studentët e diplomuar, për studentët që kanë kaluar në vitin pasardhës);
- përgatit regjistrat e pedagogëve me emrat e studentëve sipas programeve të studimit dhe grupeve përkatëse për çdo semestër;
- hedh notat e procesverbaleve të provimeve në regjistrin e notave dhe atë elektronik, si dhe harton procesverbalet në përputhje me kërkesat me shkrim të studentëve, duke u mbështetur në rregulloren e fakultetit.

Sekretaria mësimore përgatit listat përfundimtare të studentëve që frekuentojnë vitin pasardhës pas përfundimit të sezonit të vjeshtës dhe para fillimit të vitit akademik. Gjithashtu, ajo përgatit certifikatën e notave të studentëve të diplomuar dhe mbledh dokumentet e duhura nga studentët për të gjitha shërbimet e kërkuara nga ana e tyre sipas listës së shërbimeve që ofron UST-ja.

IV. INFORMACION MBI REALIZIMIN E QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE TË MËSIMDHËNIES, TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE VEPRIMTARIVE KRIJUESE DHE INOVACIONIT

Universiteti i Sporteve të Tiranës ka orientuar veprimtarinë e tij në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit 2020–2026. Ky dokument strategjik, i miratuar në dhjetor të vitit 2020, përshkruan drejtimit kryesore të zhvillimit institucional përgjatë një periudhe gjashtëvjeçare. Brenda tij janë parashikuar proceset e reformimit dhe mekanizmat e transformimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës në një qendër të ekselencës në fushën e zhvillimit dhe kërkimit shkencor në shkencat e sportit dhe të shëndetit, rekreacionit, edukimit fizik dhe shëndetësor, si dhe në menaxhimin e sporteve dhe turizmit aktiv e rekreacional. Zhvillimi strategjik parashikon tre procese të rëndësishme: transformimin e kulturës institucionale, riorganizimin strukturor si dhe përmirësimin e proceseve institucionale.

Ky plan strategjik shërben si bazë për zgjedhjet dhe prioritetet që institucioni ndërmerr në funksion të zhvillimit të tij të qëndrueshëm, duke u mbështetur në traditën dhe vlerat e akumuluar ndë vite, si dhe në përgjigje të dinamikave të mjedisit bashkëkohor. Plan i përcakton objektivat madhore të Universitetit të Sporteve të Tiranës, të cilat janë të kushtëzuara në masë të konsiderueshme nga faktorë të jashtëm. Hartimi i këtij plani strategjik synon realizimin e aspiratave institucionale, si në afatshkurtër ashtu edhe në afatgjatë.

Plan i Strategjik i Zhvillimit 2020–2026 artikulon qartë vizionin, misionin dhe fushat prioritare strategjike të institucionit. Dokumenti përmban gjithashtu prioritetet strategjike, objektivat përkatëse për secilin prioritet, aktivitetet që do të ndërmerren dhe rezultatet e pritshme për çdo objektiv të përcaktuar.

Misioni i UST-së është: *t'i shërbejë shoqërisë nëpërmjet arsimimit, kërkimit shkencor, inovacioneve; nxitjes së zhvillimit individual për transformimin e jetëve; garantimit të suksesit të studentëve në një mjedis global; ofrimit të shërbimeve akademike dhe zhvillimit të një komuniteti të larmishëm dhe gjithëpërfshirës.*

Gjatë vitit akademik 2024–2025, Universiteti i Sporteve të Tiranës, nëpërmjet organeve kolegjiale dhe strukturave të specializuara, ka ndërmarrë veprime të mirëkoordinuara dhe të gjithanshme në të gjitha fushat prioritare të zhvillimit institucional, në përputhje me objektivat përkatëse strategjike si më poshtë:

Prioriteti Strategjik: Zhvillimi Institucional

- Hartimi dhe miratimi i dokumenteve të politikave institucionale, në funksion të qartësimit të vizionit dhe qëllimeve afatgjata të institucionit.
- Përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit rregullator, me synimin për të siguruar një mjedis institucional të standardizuar dhe të përditësuar.
- Riorganizimi i vazhdueshëm i departamenteve ekzistuese, në përputhje me dinamikën akademike dhe kërkesat e zhvillimit të qëndrueshëm.
- Konsolidimi i rolit të studentëve si partnerë aktivë në procesin arsimor, duke vendosur studentin në qendër të të gjitha politikave dhe praktikave institucionale.
- Hartimi i një pakete të plotë me instrumente për marrjen e feedback-ut nga studentët lidhur me përvojën e tyre akademike në UST.

Prioriteti Strategjik: Përbushja e Standardeve të Përsosmërisë Akademike

- Rishikimi dhe përmirësimi i kurrikulave ekzistuese, në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushën e shkencave të sportit.
- Hapja e programeve të reja të studimit, për të përbushur nevojat e tregut të punës dhe për të diversifikuar ofertën akademike.
- Rikrijimi dhe fuqizimi i Komisioneve të Përhershme, për të garantuar qeverisjen efektive të proceseve akademike.
- Nxitja e përsosmërisë në proceset e mësimdhënies dhe të të nxënies, duke promovuar metoda bashkëkohore dhe inovative të edukimit.

Prioriteti Strategjik: Kërkimi Shkencor

- Integrimi i kërkimit me procesin e mësimdhënies, me theks të veçantë në zhvillimin e kërkimit shkencor laboratorik.
- Hartimi dhe zhvillimi i portofolit të kërkimit të institucionit, për të forcuar identitetin shkencor dhe ndikimin akademik të UST-së.

Prioriteti Strategjik: Zhvillimi i Partneriteteve

- Zgjerimi dhe fuqizimi i partneriteteve strategjike, në mbështetje të mësimdhënies, kërkimit dhe nxitjes së punësimit të studentëve.

Prioriteti Strategjik: Ndërkombëtarizimi

- Promovimi i mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik, nëpërmjet programeve të shkëmbimit ndërkombëtar.
- Përshtatja e kurrikulave të programeve ekzistuese me ato të institucioneve partnere ndërkombëtare, me synimin drejt realizimit të diplomave të përbashkëta dhe të dyfishta.

Prioriteti Strategjik: Sigurimi i Cilësisë

- Forcimi i funksionimit të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, për të garantuar standardizimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm institucional.
- Përbushja e plotë e të gjitha standardeve të cilësisë, nëpërmjet proceseve të brendshme të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë.
- Publikimi dhe zbatimi i politikave dhe rregulloreve për sigurimin e brendshëm të cilësisë, duke promovuar transparencën dhe llogaridhënien.
- Realizimi i procesit të vlerësimit të brendshëm dhe riakreditimit institucional, në përputhje me kërkesat e autoriteteve përkatëse.
- Vendosja e një dialogu konstruktiv me vlerësuesit e jashtëm, për të përfituar nga ekspertiza ndërkombëtare dhe për të nxitur përmirësimin e mëtejshëm të procesit akademik dhe institucional.

Misioni i Universitetit të Sporteve të Tiranës është konceptuar në përputhje me misionin e përgjithshëm të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, të paraqitur në nenin 1 të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me karakteristikat specifike që mbart dhe vlerën e shtuar që synon të sjellë Universiteti i Sporteve të Tiranës në fushën e arsimit të lartë si dhe me misionin e arsimit të lartë në shekullin e 21-të.

Në përmbushje të këtij misioni, Universiteti i Sporteve të Tiranës kreu këto veprimtari gjatë vitit akademik 2024 – 2025:

- a. Ofroi arsimim për të gjithë studentët që zgjodhën programet e studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë dhe të tretë në UST.

- b. Punoj për të pasuruar ofertën akademike me programe të reja studimi të ciklit të dytë dhe të tretë si dhe për të përmirësuar kurrikulat e programeve ekzistuese të studimit.
- c. Mësimdhënia u integrua më mirë me kërkimin duke përdorur qasjet:
- *mësimdhënia e udhëhequr nga kërkimi;*
 - *mësimdhënia e orientuar drejt kërkimit;*
 - *mësimdhënia e bazuar në mentorimin kërkimor;*
 - *mësimdhënia e bazuar në kërkim;*
 - *kërkimi është i ndikuar nga mësimdhënia.*

Gjatë vitit 2025 janë realizuar 4 Konferenca Ndërkombëtare me universitetet partnere nga Rajoni, Ballkani, dhe universitetet partnere e organizata të Bashkimit Europian. Njësitë kryesore dhe bazë të UST-së organizuan disa sesione e simpoziume shkencore zhvillimi. Pedagogët si asnjë vit tjetër, realizuan kërkime dhe botime individuale në revista kombëtare dhe ndërkombëtare të indeksuara, të cilat ndikojnë jo vetëm në plotësimin e kushteve për kualifikimet e tyre me tituj akademikë por edhe në një rankim më të mirë të institucionit.

- d. U zbatua qasja “studenti në qendër” të veprimtarisë mësimore dhe të veprimtarive të tjera të institucionit që ndikoi në aktivizimin më të madh të studentëve dhe në nxitjen e zhvillimit individual të tyre gjë që i shërben aktivitetit fizik për shëndet që është edhe pjesë themelore e misionit të UST-së.
- e. Lidhur me ofrimin e shërbimeve akademike, anëtarët e komunitetit të UST-së kanë kryer veprimtari që lidhen me shërbime ndaj institucionit, si pjesëmarrja në organet drejtuese, kryerja e punës mbështetëse administrative, shërbimi në grupe pune për çështje me të cilat është përballur komuniteti i institucionit, veprimtari të drejtimit të fakulteteve, kontributi për mbështetjen e veprimtarisë së studentëve; angazhimi si ekspertë në çështje jashtë institucionit, shërbim për agjencitë qeveritare; pjesëmarrja në përpjekjet bashkëpunuese me shkollat, agjencitë; shërbime për komunitetin, si proçese informuese në shkollat e mesme të vendit, mundësi që studentët të provojnë përvojat profesionale në kampus, në organizata të llojeve të ndryshme jashtë institucionit.

Nisur nga rezultatet e arritura dhe objektivat e përcaktuara, Universiteti i Sporteve të Tiranës gjatë vitit të ardhshëm akademik do të punojë për të përmbushur objektivat e Planit Strategjik të Zhvillimit 2020 – 2026, sipas planit konkret të veprimit.

V. VEPRIMTARIA MËSIMORE E NJËSIVE KRYESORE TË UST PËR VITIN AKADEMIK 2024 – 2025 DHE STUDENTËT

Veprimtaria mësimore në katër njësitë kryesore të Universitetit të Sporteve të Tiranës, për vitin akademik 2024–2025, është projektuar, organizuar dhe realizuar në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në

Republikën e Shqipërisë”, vendimeve të Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, vendimeve të Senatit Akademik, si dhe udhëzimeve të strukturave të tjera përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe kërkimor-shkencor në njësitë përkatëse. Ky raport vjetor përmbledh analizën e veprimtarisë mësimore për vitin akademik 2024–2025, duke reflektuar në mënyrë sintetike vlerësimet e hartuara nga të katër njësitë kryesore të UST-së. Hartimi i këtij materiali është kryer në përputhje me Udhëzimin e MAS nr. 5, datë 19.02.2018, “Për përcaktimin e elementeve përbërës të raportimit vjetor”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 24, datë 21.10.2019.

Dekanatet, në bashkëpunim të ngushtë me njësitë bazë, janë angazhuar në realizimin e të gjitha objektivave që rrjedhin nga zbatimi rigoroz i planeve mësimore dhe programeve lëndore në të tre ciklet e studimit, me synimin për të ruajtur standardet bashkëkohore akademike. Përgjegjshmëria profesionale në përmbushjen e detyrave të stafit akademik dhe atij ndihmës është orientuar drejt realizimit të objektivave të njësive kryesore, përmbushjes cilësore të programeve të studimit, si dhe zhvillimit të suksesshëm të programeve të ciklit të tretë në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit (FVFR) dhe Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes (FSHL).

Në funksion të përmirësimit të standardeve akademike, stafi akademik i të tre fakulteteve, si dhe pedagogët e Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit (IKSHS) të angazhuar në procesin e mësimdhënies, janë përfshirë në rishikimin dhe përditësimin e programeve lëndore në fillim të vitit akademik, duke përcaktuar dhe rekomanduar literaturën më të fundit për secilën lëndë. Ky proces është zhvilluar me pjesëmarrjen aktive të gjithë stafit akademik, në përputhje me ngarkesën mësimore dhe modulet përkatëse.

Gjatë këtij viti akademik, në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit (FSHR) është akredituar me tre vite programi i studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapetik në Sport”, miratuar me Urdhrin nr. 446, datë 14.08.2023, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit. Ky program i avancuar synon të formojë specialistë të aftë për trajtimin dhe rehabilitimin e sportistëve të dëmtuar apo të prekur nga dëmtime sportive.

Siç dëshmohet nga dokumentacioni i dorëzuar nga njësitë bazë dhe Plani Vjetor i IKSHS-së, realizimi i programit të parashikuar ka qenë në përputhje të plotë me fokusin kryesor të Institutit, qëndruar në kërkimin shkencor, si dhe në mësimdhënien vjetore të standardizuar, duke vlerësuar kontributin institucional dhe profesional të gjithë stafit akademik.

Materiali përmban:

- 1- Informacion të përmbledhur për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore-shkencore të FVFR, FSHL, FSHR dhe IKSSH në përmbushje të misionit të tyre, duke u përqendruar në arritjet, sfidat dhe rrugëzgjidhjet për to si dhe në synimet për të ardhmen.
- 2- Informacionin e kërkuar nga MAS, sipas strukturës së përfshirë në udhëzimin përkatës.

FSHL dhe FVFR, morën në kohë të gjitha masat e duhura si për ambientin, bazën materiale, por edhe për organizimin dhe zhvillimin me sukses dhe transparencë të konkursit të pranimit të studentëve të rinj në programin e ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Shkencat e lëvizjes” dhe në “Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit. Falë seriozitetit dhe profesionalizmit të treguar

nga komisionet e ngritura për zhvillimin e konkursit, nuk u evidentua asnjë kontestim i rezultateve të shënuara gjë e cila nxjerr në pah korrektesën dhe transparencën e stafeveve akademike dhe lidërshpit institucional të UST- së.

Si edhe në vitet e tjera përpara nisjes së vitit akademik, në kohën kur të gjitha kandidatët e interesuar për të vazhduar studimet në Universitet, më specifikisht në ditët gjatë të cilave ata/ato përzgjidhnin se në cilin Universitet/Fakultet do të preferonin të vazhdonin studimet e tyre, UST, kanë realizuar ndryshe nga çdo vit tjetër disa video promovuese dhe informative në rrjetet sociale facebook dhe Instagram, me synimin për të patur një numër sa më të madh studentësh kandidatë.

5.1 INFORMACION PËR PROGRAMET E STUDIMIT QË OFRON UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

Programet e UST-se synojnë të përgatisin specialistë për fusha vitale, si: edukimit fizik dhe shëndetit, të rekreacionit, të shkencave sportive, të rehabilitimit e të mirëqenies fizike si dhe të menaxhimit të sporteve e turizmit aktiv.

Gjatë vitit 2024 – 2025, Universiteti i Sporteve të Tiranës ka ofruar 11 programe studimi, tre programe bachelor dhe katër programe master profesional, dy programe master shkencave, si dhe dy studime doktorature.

Programi i studimit Bachelor në “Shkencat e Lëvizjes” në FSHL është program i ciklit të parë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 180 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 3-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 6-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë “Bachelor” në “Shkencat e Lëvizjes”. Misioni i programit “Bachelor” në “Shkencat e Lëvizjes” është të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme bazë në fushën e shkencave të lëvizjes dhe t’u zhvillojë atyre kompetencat e nevojshme për t’u përgatitur si specialistë të fushës në sektorin publik dhe privat. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon thellime në fusha të tilla, si ato të teknikave dhe metodikat e disiplinave të ndryshme sportive , të njohjes së teknikave të përdorimit të formave, mjeteve e metodave të të mësuarit të veprimeve lëvizore, në përputhje me përvojën dhe karakteristikat e grupmoshave e gjinive të ndryshme në shkollë, të njohjes dhe përdorimit me kompetencë profesionale të termave bazë të edukimit fizik e sportit, të njohjes së kurrikulës së lëndës së edukimit fizik, procesin mësimor dhe filozofinë bashkëkohore të zhvillimit të orës së mësimi, të legjislacionit të sportit dhe edukimit etj.

Programi i studimit Bachelor në “Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe Rekreacionit” është program i ciklit të parë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 180 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 3-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 6-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Bachelor në “Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe Rekreacionit”. Misioni i këtij programi studimi është përgatitja e specialistëve

me njohuri të përgjithshme në fushën e aktivitetit fizik dhe rekreacionit, duke mundësuar një karrierë të mëtejshme akademike ose profesionale në një nga specializimet e kësaj fushe studimi.

Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon thellime në fusha të tilla, si ato të teknikave dhe metodikave të disiplinave të ndryshme që lidhen me Rekreacionin, Aktivitetin Fizik, Shëndetin e Turizmin, ku krahas formimit specifik në fushën e aktivitetit fizik dhe rekreacionit ofrohet edhe formim të përgjithshëm metodologjik e kulturor të studentëve.

Programi i studimit Bachelor në “Shkencat e Rehabilitimit” është program i ciklit të parë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 180 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 3-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 6-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Bachelor në Shkencat e Rehabilitimit”. Misioni i programit “Bachelor në Shkencat e Rehabilitimit” është të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme bazë në fushën e rehabilitimit dhe t’u zhvillojë atyre kompetencat e nevojshme për t’u përgatitur si specialistë të fushës në sektorin publik dhe privat. Programi i ciklit të parë të studimit “Bachelor” në “Shkencat e Rehabilitimit” ka për qëllim të formojë rehabilitues fizikë dhe profesionistë me njohuri të thella për trupin e njeriut, për faktorët e ndryshëm që rrisin rrezikun për t’u prekur nga sëmundje të ndryshme, llojet më kryesore të dëmtimeve dhe procesin e programimit dhe ndërtimit të një programi ushtrimor rehabilitues sipas nevojave specifike dhe diagnozës së çdo individi. Rehabilituesi fizik në fund të studimeve fiton njohuri dhe aftësi për të kryer një numër të konsiderueshëm teknikash rehabilituese dhe terapish të ndryshme si: radioterapi elektroterapi, hidroterapi, masazhoterapi, kinezioterapi si dhe planifikim të programeve të rehabilitimit me anë të ushtrimeve. Gjithashtu rehabilituesi fizik në fund të studimeve “Bachelor” fiton kompetenca në zbatimin e planeve terapeutike që përcaktohen nga mjeku fizioterapist dhe mjekë të tjerë të specialiteteve të ndryshme.

Studentët pas diplomimit janë të aftë të trajtojnë pacientë me probleme të ndryshme shëndetësore, duke e përshtatur terapinë rehabilituese ushtrimore në varësi të diagnozës dhe të gjendjes së tyre individuale shëndetësore. Të diplomuarit në programin Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit" do t’u nënshtrohen kërkesave të profesionit me Kodin e Profesionistit, 2264 si specialistë të tjerë të shëndetësisë me nivelin e katërt të kompetencës në ILKP përcaktuar në VKM Nr. 514 dt. 20.09.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar". Të diplomuarit në Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit" në bashkëpunim me specialistë të tjerë të kujdesit shëndetësor, janë punonjës të kujdesit shëndetësor në strukturat shëndetësore, publike ose private, ku ata ushtrojnë profesionin e tyre si rehabilitues fizik.

Programi i studimit “Master i Shkencave Mësues të Edukimit Fizik dhe Shëndetit” në FSHL është program i ciklit të dytë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 120 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 2-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 7-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Master i Shkencave në “Edukim Fizik dhe Shëndet”. Misioni i programit “Master i Shkencave” në “Edukim Fizik dhe Shëndet” është të pajisë studentët me njohuritë e thelluara të nevojshme në fushën e shkencave sportive dhe shëndetit, duke i zhvilluar atyre kompetencat e nevojshme për t’u përgatitur si specialistë në këtë fushë por edhe

si studiues të fushës nëpërmjet aftësive të krijuara në kërkimin shkencor. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon thellime të mëtejshme në fusha të tilla, si mjekësia sportive dhe rehabilitimi sportiv. Gjithashtu t'i pajisë studentët me njohuri të cilat lidhen me ndikimin e aktivitetit fizik në patologji të ndryshme mjekësore sipas grupmoshave si dhe njohuri të thelluara në edukimin shëndetësor, higjienën dhe mënyrën e të ushqyerit, si dhe të njohin mekanizmat dhe mënyrat e studimit shkencor etj.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Aktivitet Fizik dhe Shëndet” është program i ciklit të dytë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 120 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 2-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 7-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet *“Diplomë Master i Shkencave në Aktivitet Fizik dhe Shëndet”*. Misioni i programit “Master i Shkencave në Aktivitet Fizik dhe Shëndet” është të pajisë studentët me njohuritë e thelluara të nevojshme në fushën e aktivitetit fizik dhe shëndetit dhe t'u zhvillojë atyre kompetencat e nevojshme për t'u përgatitur si specialistë në këtë fushë por edhe si studiues të fushës nëpërmjet aftësive të krijuara në kërkimin shkencor. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon thellime të mëtejshme në fusha të tilla, si Kërkimi Shkencor, Biomotorikë, Kineziologji, Fiziologji, Training (Training i Kondicionit, Core-Training etj), Aktiviteti Fizik në Lojrat Sportive/Individuale etj.

Programi i studimit “Master Profesional” në FSHL është program i ciklit të dytë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 120 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 2-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 7-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet *“Diplomë Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar”*. Misioni i programit “Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar” është të pajisë studentët me njohuritë e thelluara të nevojshme në fushën e edukimit fizik, sportit dhe shëndetit dhe t'u zhvillojë atyre kompetencat e nevojshme për t'u përgatitur si specialistë në këtë fushë nëpërmjet aftësive profesionale specifike të krijuara në përfundim të programit. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon përgatitje profesionale specifike në fusha të tilla, si planifikim dhe organizim i procesit mësimor si dhe i veprimtarive kurrikulare dhe ekstrakurrikulare me nivel të lartë të shprehive metodike për disiplina të ndryshme sportive, zbaton teknikat e kërkimit shkencor në drejtim të rritjes profesionale si dhe të menaxhojë me kompetencë dhe etikë profesionale orën e mësimit etj.

Programi i studimit “Master Profesional” në FSHL në “Trajner i përgatitjes fizike” është program i ciklit të dytë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 60 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 1-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 7-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet *“Diplomë Master Profesional në “Trajner i përgatitjes fizike”*.

Misioni i programit “Master Profesional në “Trajner i përgatitjes fizike” është të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme në fushën e përgatitjes fizike dhe t'u zhvillojë atyre kompetencat e nevojshme

për t'u përgatitur si specialistë në këtë fushë nepermjet aftesive profesionale specifike te krijuara ne perfundim te programit. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon përgatitje profesionale specifike në fusha të tilla, si përgatitja fizike e sportistëve dhe trajnereve , etj.

Programi i studimit “Master Profesional në Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni – Trajner Fitnesi” është program i ciklit të dytë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 60 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 1-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 7-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet “*Diplomë Master Profesional në Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni – Trajner Fitnesi*”. Misioni i programit “Master Profesional në Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni – Trajner Fitnesi” është të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme në fushën e Aktivitetit Fizik, Rekreacionit, Fitnesit dhe t'u zhvillojë atyre kompetencat e nevojshme për t'u përgatitur si specialistë në këtë fushë nepermjet aftesive profesionale specifike te krijuara ne perfundim te programit. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon përgatitje profesionale specifike në fusha të tilla, si Terapia e Lëvizjes, Training Personal, Menaxhim i Aktivitetit Fizik, Metodologjia e Sporteve Individuale Rekreative/Lojrave Sportive Rekreative etj.

Programi i studimit “Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm” është program i ciklit të dytë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 60 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 1-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 7-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet “*Diplomë Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm*”. Misioni i programit “Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm” është të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme në fushën e Menaxhimit të Sportit e Turizmit dhe t'u zhvillojë atyre kompetencat e nevojshme për t'u përgatitur si specialistë në këtë fushë nepermjet aftesive profesionale specifike te krijuara ne perfundim te programit. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon përgatitje profesionale specifike në fusha të tilla, si Politika Menaxhimi në Sport e Turizëm, Marketing, Menaxhim, Qeverisje e Sportit, Menaxhim/Organizim Aktivitetesh, etj.

Programi i studimit Master Profesional në “Rehabilitim Terapeutik në Sport” është program i ciklit të dytë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 60 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 1-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 7-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet “*Diplomë Master Profesional në Rehabilitim Terapeutik në Sport*”.

Nga analiza e veprimtarisë së fakulteteve në fushën e kurrikulave, rezulton se tipari i përgjithshëm i veprimtarisë së Fakulteteve ka qenë konsolidimi i programeve që ofrojnë duke u përqendruar në përmirësimin e kurrikulave dhe të programeve mësimore të lëndëve si dhe pasurimi i ofertës akademike me programme të reja studimi.

Ofrimi i programeve cilësore të studimit është një nga synimet kryesore të UST-se. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2023 – 2024, nën drejtimin e Senatit Akademik u ndërmorën një sërë procesesh te cilet realizuan një sërë përmirësimesh të programeve të studimit brenda. Qëllimi i këtyre përmirësimeve ishte sigurimi i përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë të programeve të studimit.

Duke u bazuar në: Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 35 pika 9; në VKM nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, pika 1, 2, , 2.1, shkronja a, b, c, ç, d, dh, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, 2.8, 2.9; Udhëzimin e MASR nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, kreu II, pika 2, 6, 7; Senati Akademik ndërmoi një sërë vendimesh të renditura më poshtë për të mundësuar realizimin e ndryshimeve të programeve, dhe përmirësimin e programeve mësimore të lëndëve:

Fakultetet dhe departamentet realizuan gjithë procesin në përputhje me vendimet e miratuara. Senati Akademik miratoi ndryshimet sipas legjislacionit në fuqi.

Përmirësimet e ndërmarra sollën një vlerë të shtuar të pasqyruar në:

- Optimizimin e strukturës së kurrikulës.
- vendosjen e balancës më të mirë sipas përqindjeve të kërkuara për lëndët sipas kategorive;
- përmirësimin e shpërndarjes së krediteve;
- optimizimin e ngarkesës mësimore të personelit akademik, krahasuar me ngarkesat e viteve të kaluara;
- përmirësimin e programeve mësimore të lëndëve.

Kësisoj gjatë këtij viti akademik UST arrin synimin që të zgjerohej oferta akademike dhe të krijohet mundësia e kualifikimit të stafit aktual në programin e ciklit të tretë, si dhe t’u shërbejë federatave sportive dhe tregut të punës me trainerë të pregatitjes fizike, por njëkohësisht kjo strategji e matrealizuar shoqërohet edhe me rritjen e numrit të studentëve të UST-së.

Konsolidimi i programeve ekzistuese dhe ofrimi i programeve të reja do të jetë në fokus edhe për vitin e ardhshëm akademik. Pasurimi i ofertës akademike me programe të reja do të orientohet drejt programeve unike dhe programeve të ciklit të dytë dhe programeve të përbashkëta me universitet e huaja partnere. Mendohet se në këtë mënyrë do të mundësohet rritja e numrit të studentëve, do të mundësohet ndryshimi i statusit të Universitetit në tregun akademik kombëtar e rajonal si dhe do të mundësohet një qasje me kosto më efektive.

5.2 PASQYRIMI I TREGUESVE SASIORË E CILËSORË TË ARRITUR NGA STUDENTËT GJATË VITIT AKADEMIK 2024 - 2025

A. Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes – FSHL

E gjithë veprimtaria mësimore dhe kërkimore – shkencore ka në fokus të saj rritjen e vazhdueshme të nivelit akademik të studentëve të FSHL-së e cila paqyrohet dhe në të dhënat statistikore të shprehura nëpërmjet kalueshmërisë dhe notës mesatare për çdo program studimi.

Treguesit e përcjellë nga analizat e departamenteve, tregojnë se rezultatet e arritura nga studentët janë në nivelin “mirë”.

Referuar të dhënave të Departamenteve, rezultojnë se mësimdhënia, sipas tipologjive të veprimtarive mësimore, është realizuar maksimalisht, si në treguesit sasior, ashtu dhe ato cilësor të kësaj fushe.

Mjedisi/mjediset mësimore, si dhe mjetet dhe pajisjet teknologjike të disponuara nëpër mjedise, kanë mundësuar zhvillimin normal të procesit të mësimdhënies.

Mësimdhënia është paraprirë nga një punë planifikuese e mirë, ku është synuar përditësimi i njohurive në syllabuset dhe programet lëndore të çdo program studimi. Për t'u nënvizuar në këtë drejtim është bashkëpunimi në nivel të departamentit, si dhe përfshirja aktive e trupës përkatëse të personelit akademik.

Në programet e ciklit të dytë, mësimdhënia dhe cilësia e saj nuk favorizohen/mbështeten nga orari mësimor. Kjo shprehet në frekuentimin e ulët të studentëve të veprimtarive mësimore, veçanërisht në orët e vona të pasdites (orarit mësimor).

Në funksion të mbështetjes së mësimdhënies, mbetet për t'u përmirësuar baza materialo-didaktike në lëndët/modulet me karakter praktik/sportiv dhe raporti i saj me numrin e studentëve.

TREGUESIT SASIORË E CILËSORË TË ARRITUR NGA STUDENTËT E FSHL-ës GJATË VITIT AKADEMIK 2024 – 2025

FSHL			DSI		DESH		DSK		TOTALI	
PROGRAMI I STUDIMIT	KURSI	NR. STUD.	NOTA MES.	KALUE SHMERIA %	NOTA MES.	KALUE SHMERIA %	NOTA MES.	KALUESHMERIA %	NOTA MES.	KALUESHMERIA %
BACHELOR	I, II, III	646	7	84%	6.6	94%	6.6	86.80%	6.7	88.60%
MASTER I SHKENCAVE "MESUESI"	I, II	469	6.5	89.60%	7.4	97%	7.6	93.40%	7.2	93.30%
PROGRAMI I FORMIMIT TË VAZHDUAR	I	17			8.2	100%	9.8	100%	9	100%

B. Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit – FVFR

TË DHËNA PËR KALUESHMËRINË DHE NOTËN MESATARE TË STUDENTËVE PËR VITIN AKADEMIK 2024 – 2025

FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT				
N r.	Programi i studimit	Numri total i studentëve	Kalueshmëria në total	Nota mesatare për numrin total të studentëve

1	Bachelor në “Fushat e Aktivitetit Fizik, të Shëndetit dhe të Rekreacionit”	524	82%	6.4
2	Master Profesional në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”	20	99%	7.8
3	Master Profesional në “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni -Trajner Fitness”	13	100%	7.9
4	Master i Shkencave në “Aktivitet Fizik dhe Shëndet”	40	100%	8.4

TË DHËNA PËR PUNËSIMIN E STUDENTËVE PËR VITIN AKADEMIK 2024 – 2025

FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT				
Nr.	Programi i studimit	Numri total i të diplomuarve	Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
1	Bachelor në “Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit”	119	30	50
2	Master i Shkencave – Fusha “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”	13	3	8
3	Master Profesional – Fusha “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni – Trajner Fitness”	12	8	4
4	Master Professional në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”	16	8	6

C. Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit – FSHR

Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Humane me përgjegjësi i parapriu fillimit të vitit akademik 2024 – 2025 me programet e lëndëve dhe syllabuseve të moduleve përkatëse të cilat u miratuan nga dekanati.

Bazuar në Udhëzimin Nr.29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë” u planifikuan nevojat për angazhim të personelit akademik në njësitë e tjera të institucionit si dhe u lidhën marrëveshjet për realizimin e veprimtarisë akademike me Përgjegjësin e DSHBH, Dekanin e FSHR-së dhe Rektorin e UST-së.

Ky udhëzim ndryshoi normën e personelit akademik, mënyrën e llogaritjes së realizimit të saj si dhe numrin e lëndëve dhe moduleve që mund t’i planifikoheshin në ngarkesë personelit akademik, u hartua edhe ngarkesa mësimore nga DSHBH për vitin akademik 2024-2025.

Në realizimin e procesit mësimor janë angazhuar staf i brendshëm akademik i DSHBH, personel akademik i njesive të tjera kryesore të UST si dhe nga staf akademik i jashtëm duke respektuar standardin e cilësisë dhe të përzgjedhjes së pedagogëve.

Realizimi i procesit mësimor

Procesi mësimor është realizuar në zbatim të rregullores së UST-së dhe Udhëzimit Nr.29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arimit të lartë” si dhe orarit mësimor të miratuar nga Dekani i FSHR-së për të dy semestrat e vitit akademik. Sezonet e provimeve të dimrit, verës dhe vjeshtës janë realizuar në përputhje me rregulloren e Universitetit të Sporteve të Tiranës. Stafi akademik ka organizuar zhvillimin e provimeve përkatëse sipas komisioneve të miratuara paraprakisht nga DSHBH dhe ka zbatuar orarin e paracaktuar për zhvillimin e tyre. Studentët janë njohur me vlerësimin e pedagogëve përkatës nga vetë ata, sistemit informatik të UST-së PITAGORA dhe sekretarisë mësimore.

Stafi ndihmës akademik dhe administrativ ka plotësuar në kohë e me cilësi detyrimet për mbështetjen e procesit mësimor dhe detyrat e tjera të ngarkuara.

Statistikat e kalueshmërisë dhe mesatares për studentët e ciklit të parë të studimeve “Bachelor”

Përpara fillimit të vitit akademik 2024-2025, ashtu si në vitet e tjera, kandidatët e interesuar për të vazhduar studimet në Universitet zgjedhin institucionin dhe programin e preferuar. UST, FSHR, si dhe njësitë e tjera kryesore, morën pjesë në aktivitetin "Work&Study", i cili u organizua nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë më 3-4 prill 2024. Ky eveniment kishte për qëllim tërheqjen e një numri të madh studentësh, të cilët do të përzgjidhnin UST dhe fakultetet e saj për vitin akademik 2024-2025. Përveç kësaj, u bënë promovime dhe informacione edhe në rrjetet sociale, si Facebook dhe Instagram, për të arritur tek një audiencë më e gjerë.

Viti akademik 2024-2025, ishte një vit i suksesshëm dhe u zhvillua në kushte pozitive dhe normale.

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar Kuotat e Pranimit në FSHR për vitin akademik 2024-2025.

Nr	Programi i studimit	KAPACITETET PRITËSE	SHUMA E KUOTAVE	Kuotat sipas programit të studimit për kandidatët:2024-2025												
				Shqiptarë brenda vendit	Që aplikojnë për program të	Që aplikojnë për Transferim	Të huaj	Me statusin e jetimit	Persona me aftësi ndryshe	Romë + balkano egjiptian	Trojet					
											Kosovë	Maqedoni	Mal i Zi	Preshevë	Bujanovc	Medvegjë
1	(Bachelor) Shkencat të Rehabilitimit	150	130	107	5	3	-	1	1	1	3	3	3	1	1	1
2	M.Profesion al Rehabilitim Fizioterapeu tik në Sport.	75	72	50	5	1	1	1	1	1	3	3	3	1	1	1

Në programin e studimit të ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në Shkencat e Rehabilitimit plotësonin kriteret për tu pranuar të gjithë kandidatët që kishin përfunduar arsimin e mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe që kanë përfunduar jo më pak se 12 vite shkollë në ciklet

parauniversitare. Gjithashtu pranoreshin edhe kandidatët që kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme jashtë vendit. Për këtë grup kategori është e nevojshme dhe kërkohet kryerja e njehsimit/ekuivalentimi të diplomës në vendin përkatës.

❖ Kriteret e pranimit

Në këtë vit akademik, në programin e ciklit të parë të studimeve “**Bachelor**” në “**Shkencat e Rehabilitimit mund të pranohej** për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm si më sipër, si dhe që plotëson:

Kriterin e meritës (nota mesatare e shkollës së mesme) e përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave. Kriter i cili për vitin akademik 2022-2023 me propozim të FSHR dhe **Vendim nr 12; dt 10.02.2022 , të Senatit të UST-së**, u përcaktua të ishte me mesatare mbi 6.5.

Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në vitin akademik 2024-2025 ishte 53 studentë.

FSHR Emërtimi i Programit të Studimit	Studentë të regjistruar <i>/studentë përsëritës</i>				Studentë kalues	Studentë të diplomuar	Studentë të çregjistruar	Studentë të transferuar	Studentë të shkëlqyer
	Total	Viti I	Viti II	Viti III					
1. Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit”	162	53 <i>(33 st.përs)</i>	52 <i>(17 st.përs)</i>	57 <i>(17st.për)</i>	92	37	5	-	1
2. Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”	33				23	23	-	-	0 <i>(3 me mesatar e mbi 8)</i>

Programi i studimit	Viti	Nota mesatare	Kalueshmëria në %
BACHELOR	I	6.3	88%
	II	6	80.7%
	III	6.2	91%
MASTER I Profesional	I	7.1	100%

REALIZIMI I PRAKTIKAVE / Bachelor (1,2,3)

Realizimi i praktikave edhe këtë vit u realizua sipas strukture vjetore ku përgjegjës i programit të studimit Bachelor është Departamenti i Rehabilitimit i cili bëri të mundur në bashkëpunim me Dekanatin, realizimin e marrëveshjeve për vitin akademik 2024-2025.

Praktika e vitit të I-rë u bë pranë laboratorëve të rehabilitimit dhe sallave që disponon UST-ja.

Viti i II-të dhe i III-të sipas programit mësimor i realizoi orët e praktikës në disa struktura publike edhe private, me të cilat UST-ja ka ***marrëveshje bashkëpunimi***.

Këto struktura janë si më poshtë vijon:

Nr	Institucioni	Lloji i kontratës	Data e nënshkrimit	Forma e zyrtarizmit të bashkëpunimit	Rezultatet apo përfitimet që priten
1	Spitali Universitar i Traumës	Memorandum Bashkëpunimi për ofrimin e shërbimeve të ndërmjetme me interes të përbashkët dhe lehtësimin e mardhënieve ndërinstytucionale	13.11.2024	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Realizimi i praktikave
2	Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”	Memorandum Bashkëpunimi për praktikat profesionale të studentëve	13.11.2024	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Realizimi i praktikave
3	Klinika Medal Physiotherapy	Memorandum Bashkëpunimi për praktikat profesionale të studentëve	25.09.2024	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Realizimi i praktikave
4	Klinika Orthomed Sport	Memorandum Bashkëpunimi për praktikat profesionale të studentëve	25.09.2024	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Realizimi i praktikave
5	Poliklinika e Specialiteteve Nr. 3	Memorandum Bashkëpunimi për praktikat profesionale të studentëve	25.09.2024	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Realizimi i praktikave
6	Qendra e Mjekësisë së Punës	Memorandum Bashkëpunimi për praktikat profesionale të studentëve	25.09.2024	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Realizimi i praktikave

Marrëveshjet dhe bashkëpunimi me këto struktura bënë të mundur realizimin e praktikave ku studentët kishin mundësinë të krijojnë eksperiencat e tyre dhe të njiheshin me paisjet rehabilituese që këto klinika ofrojnë, bashkë me stafin e tyre me eksperiencë.

- Master Profesional 1

Orët e praktikës profesionale u realizuan në sajë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit që UST-ja ka me FSHF-në. Pedagogoet, Prof Asc.Dr. Genta Nallbani dhe Dr. Aisel Oseku kanë qenë përgjegjës për realizimin e orëve të praktikës sipas programit. Këto orë praktike u zhvilluan pranë ekipeve sportive me një shtrirje në disiplinat sportive si, futboll, basketboll dhe volejbolll dhe u bë e mundur që studentët të vëzhgojnë nga afër çdo problem apo dëmtim sportiv gjatë çdo ndeshje zyrtare dhe seance stërvitore.

VI. SIGURIMI I CILËSISË

Raportim për veprimtaritë e ushtruara nga NJSBC e UST^{-së} për përmbushjen e objektivave mbështetur në Planin Strategjik të UST 2021-2026 për periudhën Tetor 2024- Shator 2025.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e riorganizuar referuar vendimit nr. 749, dt 19.05.2021, ka kryer funksionin e saj bazuar në detyrat që u ngarkon ligji i Arsimit të Lartë 80/2015, udhëzimet, rregulloren, planin strategjik të zhvillimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës 2021-2026 si dhe aktet e tjera nënligjore të lidhura me punën e NJSBC.

- ❖ Sipas planit të veprimtarisë për periudhën akademike 2024- 2025, të hartuar nga anëtarët e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, janë realizuar veprimtaritë mbi identifikimin dhe analizimin e pikave të forta dhe të dobta të veprimtarisë së përgjithshme të institucionit të njësive kryesore dhe njësive bazë që veprojnë brenda institucionit. Gjithashtu janë kryer veprimtari në funksion të rritjes së cilësisë mbi praktikën e mësimdhënies dhe të nxënës.
- ❖ Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga Ligji Nr. 80/2015, Neni 103, Pika 1; 2; 3 dhe sipas përcaktimeve të Planit të Veprimit, NJSBC ka realizuar veprimtaritë e saj për të përmbushur standartet për cilësinë e mësimdhënies në përfundim të vitit akademik 2024-2025.

Raporti ka analizuar të dhënat e përftuara nga veprimtaritë e kryera për periudhën tetor 2024 – shtator 2025 në:

- a) FAKULTETIN E SHKENCAVE TE LËVIZJES
- b) FAKULTETIN E VEPRIMTARISE FIZIKE DHE REKREACIONIT
- c) FAKULTETIN E SHKENCAVE TË REHABILITIMIT
- d) INSTITUTIN E KËRKIMIT SHKENCOR TË SPORTIT

FAKULTETI I SHKENCAVE TE LËVIZJES

1. Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes ofron këto programe studimi:

- Program studimi të ciklit të parë **Bachelor** në fushën e “Shkencave të lëvizjes” përgjegjes për këtë program është Departamenti i Sporteve Kolektive dhe koordinator i programit të studimit është Prof. Asc. Dr. Aida Shehu.
Numri i studenteve në këtë cikël studimi ishte 646. Në vitin e parë ishin 244 studente, në vitin e dytë 189 studente dhe në vitin e tretë 213 studente. Studentë të diplomuar janë 161 studentë.
- ❖ Program studimi të ciklit të dytë të Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim fizik e Shëndetësor” me përgjegjës të programit të studimit Departamentin e Edukimit dhe Shëndetit dhe koordinator Prof. Asc. Dr. Najada Quka. Ky departament ka akredituar kështu programin studimi me 5 (pesë) vite. Programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Shëndetësor” (469 studentë në total) Viti I “Mësuesi” 259 Student të regjistruar, Viti II “Mësuesi 210 Student të regjistruar. Student që e kanë përfunduar vitin janë 175 të diplomuar
- Program studimi të ciklit të dytë të Master profesional në “Trajner i Përgatitjes Fizike”, për

vitin akademik 2024-2025, nuk është aktivizuar pasi nuk ka pasur aplikantë.

- Programi i formimit të vazhduar psiko-pedagogjik i cili ofrohet nga Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit për vitin akademik 2024-2025, certifikoi 15 studentë.
- Programi i ciklit të tretë të studimeve “Doktoratë” në “Shkenca Sportive”, për vitin akademik 2024-2025 ka pasur në 3 kuota të plotësuara dhe në total janë 30 doktorantë.
- Kualifikimi i stafit akademik si dhe raporti i stafit akademik efektiv dhe stafit akademik punësuar me kohë të pjesshme është gjithashtu një pikë e fortë e fakultetit. Cilësia e rekrutimit të pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm, me tituj akademik dhe grada shkencore si dhe me përvojë akademike kanë mundësuar realizimin me sukses të të gjitha programeve të studimit që ofron FSHL. Stafi akademik është i specializuar në fushat e studimit në të cilat jep mësim.

Kapacitetet akademike të Fakultetit për vitin 2024 – 2025 ishin në total 34 pedagogë efektiv nga të cilët: 4 (katër) mbajnë titullin Profesor; 12 (dymbëdhjetë) mbajnë titullin Profesor i Asociuar; 9 (nëntë) mbajnë gradën Doktor; 9 (nëntë) janë Master i shkencave. Gjithashtu pranë FSHL janë punësuar 7 (shtatë) pedagog me kohë të pjesshme.

2. Nisja e vitit akademik 2024 – 2025 :

Viti akademik 2024-2025 ka nisur me një fokus të veçantë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe programeve të studimit. NJSBC e UST-së, në bashkëpunim të ngushtë me koordinatorët e programeve të studimit, ka kryer një proces të detajuar të analizës dhe vlerësimit të planeve dhe programeve mësimore për të gjitha ciklet e studimit që ofron Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes (FSHL).

Analiza e Ndryshimeve të Planeve Mësimore

- **Evidentimi i kërkesave për ndryshime:** Gjatë fillimit të vitit akademik, janë mbledhur informacione nga koordinatorët dhe njësitë bazë për rishikimin e planeve mësimore. Procesi tregoi se për vitin akademik 2024 – 2025 nuk ka ndryshime në asnjë program studimi të ofruar nga departamentet e FSHL.
- Për programin e studimit të ciklit të tretë të studimeve “Doktoratë” është në proces në pritje të vendimit të bordit të akreditimit, pasi si procedurë në fakultet është mbyllur.

Përmirësimi i Programeve lëndore

Përfshirja e stafit akademik: Të gjithë pedagogët titullarë të lëndëve kanë kryer një rishikim të detajuar të programeve të lëndëve. Ky proces ka rezultuar në ndryshime konkrete që synojnë: përafrimin e përmbajtjeve me standardet bashkëkohore; rritjen e cilësisë së mësimdhënies përmes qartësimit të objektivave dhe rezultateve të pritshme të të nxënit; harmonizimin e përmbajtjeve mes moduleve për të siguruar një koherencë më të mirë në procesin akademik të gjitha këto brenda normave të përcaktuara në aktet rregullatore.

Rezultatet dhe Ndikimi i Ndryshimeve

- **Cilësia e mësimdhënies:** Ndryshimet e bëra në programet lëndore dhe rishikimi i moduleve pritet të reflektohen pozitivisht në cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe të mësimnxënies.
- **Përgatitja profesionale e studentëve:** Përmirësimet e programit të ciklit të parë të studimeve Bachelor dhe avancimet në Master ofrojnë një platformë më të fortë për përgatitjen e studentëve, duke siguruar aftësi më konkurruese në tregun e punës dhe në fushën akademike.
- **Standardizimi i përmbajtjeve:** Rishikimi i detajuar i programeve dhe harmonizimi i moduleve ndihmon në ngritjen e standardeve akademike në UST.

Rekomandime për në vijimësi:

- **Vazhdimi i monitorimit dhe përmirësimit:** NJSBC duhet të vazhdojë procesin e monitorimit të ndikimit të këtyre ndryshimeve dhe të evidentojë nevojat për përmirësime të tjera në semestrat e ardhshëm.
- **Rritja e bashkëpunimit me studentët:** Përfshirja më aktive e studentëve në proceset e vlerësimit të cilësisë përmes feedback-ut të strukturuar do të ndihmojë në identifikimin e mëtejshëm të nevojave.
- **Zhvillimi i trajnimeve për stafin akademik:** Trajnimet mbi praktikatat më të mira të mësimdhënies dhe zhvillimin e moduleve do të kontribuojnë në rritjen e mëtejshme të standardeve.

Nisja e vitit akademik 2024-2025 në UST është shënuar nga një angazhim i dukshëm për përmirësimin e cilësisë akademike përmes bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet NJSBC, stafit akademik dhe koordinatorëve të programeve të studimit. Ndryshimet e bëra dhe ato që do të pasojnë janë një hap i rëndësishëm drejt ngritjes së standardeve akademike dhe përgatitjes më të mirë të studentëve.

Viti akademik 2024-2025 ka nisur me organizimin e konkursit të pranimit, për këtë organizim është raportuar nga njësia bazë përgjegjëse mbi mbarëvajtjen e konkursit praktik dhe kriterëve të pranimit të studentëve sipas karakteristikave të programit të studimit:

Departamenti i Sporteve Kolektive, përgjegjës për programin e ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Shkencat e Lëvizjes” në përgatitje të vitit akademik 2024 – 2025, sa i përket pranimeve në këtë program studimi ka marrë të gjitha masat për organizimin dhe zhvillimin e konkursit të pranimit duke zbatuar me rigorozitet hapat dhe procedurat e përcaktuara për përzgjedhjen dhe pranimin e kandidatëve (konkursi/testi praktik, nxjerrja e rezultateve në afatet e përcaktuara etj.). Këto informacion janë marrë nga drejtuesja e departamentit njëkohësisht dhe Kryetare e Komisionit, Prof. Asc. Dr. Aida Shehu.

Në përfundimit të Konkursit të Pranimit **NUK** pati asnjë ankimim lidhur me organizimin, zhvillimin dhe rezultatet e publikuara.

3. Intervista me fokus grupet për procesin e mësimdhënies për javën e 8-të vitit akademik 2024 – 2025

INTERVISTA ME FOKUS GRUPE PËR JAVËN E 8^{-të} TË VITIT AKADEMIK

Grupi i punës i NJSBC në bashkëpunim me studentët realizuan intervistën me fokus grupe për procesin e mësimdhënies. Organizimi i intervistës u realizua mbi keto pika kyçe:

- Organizimi i fokus grupit për vlerësimin e e aspekteve të mesimdhënies, është e rëndësishme të krijohet një mjedis ku studentet mund të shprehin lirshëm mendimet e tyre në lidhje me procesin e mesimdhënies.
- Përdorimi i teknikave të ndryshme përfshirë pyetje të hapura dhe diskutime të strukturuar, me anë të të cilave mund të analizojmë qëllimet e tyre individuale, si dhe shohim pikëpamjet e përbashkëta që mund të jenë të rëndësishme për të përmirësuar përvojën e tyre të përgjithshme në universitet.
- **Formati i intervistës**

Diskutim i përqëndruar në tematikat si vijojnë:

Kurrikula dhe rezultatet e të nxënës
1. Jeni në dijeni për rezultatet e të nxënës, çfarë do jeni në gjendje të bëni në fund të lëndës
2. A korrespondojnë pritshmëritë tuaja me rezultatet e të nxënës dhe përmbajtjen e lëndëve?
3. A zhvillohen një shumëllojshmëri aftësish në programin tuaj të studimit?
4. A përshkruan programi i studimit me programet e studimit në vijim apo me kërkesat e punësimit?
5. Mendime të tjera lidhur me këtë aspekt (vlerësime pozitive ose kritika):
Vlerësimi dhe arritjet
1. A ka qenë i drejtë vlerësimi për arritjet tuaja në lëndet që studioni?
2. A e keni mundësinë që rezultatet e vlerësimit të reflektohen për të përmirësuar të nxënës tuaj?
3. A merrni feedback apo komente të detajuara për punën, detyrat apo provimet tuaja?
4. A ju janë sqaruar me përpara kriteret e vlerësimit?
5. A diskutoni me stafin akademik për arritjet në lëndet përkatëse?
6. Mendime që mund të jepni lidhur me këtë aspekt (vlerësime pozitive ose kritika lidhur me çështjet e mesipërme):
Mësimdhënia dhe Mësimnxënja
1. A ju duken të përshkueshme metodat e mesimdhënies?
2. Si e aksesoni literaturën bazë? (aksesi në bibliotekë etj.)
3. A përdorni tekste mësimore të lektoreve tuaja? Nëse po, a ju vendosin në dispozicion konform rregulloreve?
4. A është çështje mesimdhënie në programin tuaj?
5. Mendime që mund të jepni lidhur me këtë aspekt (vlerësime pozitive ose kritika lidhur me çështjet e mesipërme):
Organizimi dhe menaxhimi
1. A është efektiv dhe i mirë-organizuar orari mesimor dhe i aktiviteteve?
2. A ju komunikohen ndryshimet në orarin mesimor apo aktiviteteve që zhvillohen?
3. Mendime që mund të jepni lidhur me këtë aspekt (vlerësime pozitive ose kritika lidhur me çështjet e mesipërme):
Infrastruktura e mesimdhënies
1. A është shërbimi i bibliotekës i kënaqshëm lidhur me orarin/aksesin/ndihmen/literaturë që përmban?
2. A është shërbimi i TIK i kënaqshëm lidhur me orarin/aksesin/ndihmen/programet-software që ofron /wifi?
3. A është infrastruktura konform pritshmërive tuaja për një proces mesimdhënie të rregullt?
4. A keni në dispozicion dhe përdorim materiale specifike për procesin mesimor?
5. Mendime që mund të jepni lidhur me këtë aspekt (vlerësime pozitive ose kritika lidhur me çështjet e mesipërme):

Nga analiza dhe përpunimi i informacionit të grumbulluar, janë evidentuar pikat e forta dhe të dobta të procesit të mësimdhënies dhe menaxhimit akademik, si më poshtë:

Pikat e Forta

1. Kurrikula dhe Rezultatet e të Nxënës

- Studentët janë të informuar qartë për rezultatet e të nxënit, falë sqarimeve të detajuara nga pedagogët.
- Objektivat dhe pritshmëritë për përmbajtjen e lëndëve janë në përputhje me rezultatet e të nxënit, duke garantuar transparencë në procesin mësimor.
- Programet e studimit janë të orientuara drejt nevojave të tregut të punës dhe kontribuojnë në zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve.
- Vërehet një perceptim pozitiv lidhur me përputhshmërinë e përmbajtjes së lëndëve me mundësitë e punësimit.

2. Vlerësimi dhe Arritjet

- Studentët e konsiderojnë procesin e vlerësimit si të drejtë dhe të sqaruar paraprakisht në disa module.
- Feedback-u për detyrat, punët dhe provimet jepet në kohë dhe në mënyrë të detajuar, duke ndihmuar në përmirësimin e performancës akademike.
- Kriteret e vlerësimit janë përgjithësisht të qarta, megjithëse vërehen variacione në praktikat individuale të pedagogëve.

3. Mësimdhënia dhe Mësimnxënia

- Studentët shprehen të kënaqur me metodat e përdorura në mësimdhënie, duke i vlerësuar ato si cilësore dhe efikase.
- Literatura bazë u vihet në dispozicion studentëve në format elektronik nga pedagogët, si dhe përmes materialeve mbështetëse të lektorëve.

4. Infrastruktura dhe Teknologjia e Informacionit (TIK)

- Shërbimet TIK dhe rrjeti Wi-Fi vlerësohen si të kënaqshme, duke ofruar akses të lehtë në platformat mësimore dhe informacionin akademik.
- Stafi akademik siguron materialet e nevojshme për zhvillimin e rregullt të procesit mësimor, duke krijuar kushte të favorshme për mësimdhënie.

Pikat e Dobta

1. Kurrikula dhe Rezultatet e të Nxënit

- Evidentohet nevoja për një balancim më të mirë ndërmjet orëve teorike dhe atyre praktike, pasi studentët kërkojnë më shumë orë praktike për zhvillimin e aftësive profesionale.

2. Vlerësimi dhe Arritjet

- Studentët nuk paraqesin raste konkrete për përmirësimin e vlerësimit, duke u shprehur në mënyrë të përgjithshme pa shembuj specifikë për modulet problematike.
- Praktikrat e ndryshme të vlerësimit nga pedagogë të ndryshëm krijojnë herë pas here paqartësi në mënyrën e vlerësimit.

3. Infrastruktura dhe Kushtet e Mësimdhënies

- Disa ambiente nuk përmbushin plotësisht kërkesat e programeve dhe moduleve përkatëse.
- Studentët kanë sugjeruar nevojën për rikonstrukcion të disa ambienteve, si dhe përmirësimin

e kushteve të ngrohjes dhe të terreneve të hapura.

Përfundim

Raporti paraqet një pasqyrë të përgjithshme pozitive të procesit mësimor për vitin akademik 2024–2025, ku studentët shprehin kënaqësi në lidhje me kurrikulën, vlerësimin dhe shërbimet TIK. Megjithatë, mbeten fusha për përmirësim, veçanërisht në drejtim të rritjes së orëve praktike, unifikimit të praktikave të vlerësimit dhe përmirësimit të infrastrukturës. Këto gjetje përbëjnë një bazë të rëndësishme për forcimin e pikave të forta dhe adresimin e dobësive të evidentuara.

FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT

Fakulteti ofron 5 programe studimi, të cilat përfshijnë: Bachelor në “Fushat e Aktivitetit Fizik, të Shëndetit dhe të Rekreacionit”:

- Numri i studenteve në këtë cikël studimi ishte 649. Në vitin e parë ishin 249 studente, në vitin e dytë 221 studente dhe në vitin e tretë 179 studente. Studentë të diplomuar janë 131 studentë.
- Master Shkencor në “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”:
- Numri i studenteve në këtë cikël studimi ishte 43. Në vitin e parë ishin 22 studente, në vitin e dytë 21 studente. Studentë të diplomuar janë 15 studentë.
- Master Profesional në “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni – Trajner Fitnesi”;
- Numri i studenteve në këtë cikël studimi ishte 12 . Në vitin e parë ishin 12 studente, Studentë të diplomuar janë 10 studentë.
- Master Profesional në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”;
- Numri i studenteve në këtë cikël studimi ishte 27. Në vitin e parë ishin 27 studente, Studentë të diplomuar janë 14 studentë.
- Programi i ciklit të tretë në “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”. Numri i studenteve në këtë cikël studimi ishte 33.

Të dhënat statistikore për studentët tregojnë një përmbledhje të numrit të studentëve të regjistruar, kalueshmërinë dhe notën mesatare.

Gjatë vitit akademik, u realizuan fokus grupe në javën e 8-të, javën e 13-të dhe javën e 23-të, ku studentët e nivelit bachelor dhe master ndanë eksperiencat e tyre dhe ofruan sugjerime për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të procesit akademik. Nga këto fokus grupe u evidentuan disa aspekte pozitive dhe sfida të cilat mund të adresohen për të përmirësuar ofertën akademike.

Nisja e vitit akademik 2024-2025 është shënuar nga realizimi i detyrave administrative dhe përgatitjeve për fillimin e vitit të ri akademik. Një prej hapave ka qenë bashkëpunimi me koordinatoret e programeve të studimit për të siguruar që të gjitha aktivitetet të jenë në përputhje me kërkesat akademike dhe të realizohen pa vonesa. Ky bashkëpunim ka përfshirë:

- Rishikimin dhe përditësimin e syllabuseve për lëndët dhe programet e studimit, duke siguruar që ato të jenë në përputhje me standardet aktuale dhe të ofrojnë një bazë për përgatitjen akademike të studentëve.
- Përcaktimin dhe përmbushjen e kuotave të studentëve për programet e studimit të ciklit Bachelor, duke siguruar një ekuilibër mes numrit të studentëve dhe mundësive mësimore që mund të ofrohen. Ky proces ka përfshirë planifikimin dhe shpërndarjen e resurseve për të siguruar që çdo student të ketë mundësinë për të marrë një arsim të kualifikuar.
- Përcaktimin e aktiviteteve të tjera administrative, si regjistrimi i studentëve, sigurimi i burimeve të nevojshme për mësimdhënie dhe organizimi i mjediseve të mësimi për vitin akademik.

1. Anketimet për procesin e mesimdhënie për javën e 8 -të vitit akademik 2024-2025

Gjatë javës së 8të janë zhvilluar në Universitetin e Sporteve të Tiranës, në FVFR 6 fokus grupe me studentët e ciklit të studimit bachelor dhe master të FVFR, të cilët kanë ndarë eksperiencën e tyre përgjatë viteve të studimit në UST, si dhe kanë dhënë sugjerime lidhur me mënyrat se si institucioni mund ta përmirësojë më tej ofertën e tij akademike dhe si të ofrojë më shumë mundësi për studentët.

2. Anketimet për procesin e mesimdhënie për javën e 13 -të vitit akademik 2024-2025

Gjatë javës së 13të janë zhvilluar në Universitetin e Sporteve të Tiranës, në FVFR 6 fokus grupe me studentët e ciklit të studimit bachelor dhe master të FVFR, të cilët kanë ndarë eksperiencën e tyre përgjatë viteve të studimit në UST, si dhe kanë dhënë sugjerime lidhur me mënyrat se si institucioni mund ta përmirësojë më tej ofertën e tij akademike dhe si të ofrojë më shumë mundësi për studentët.

3. Menaxhimi i sezonit të provimeve të dimrit

Mbështetur në informacionet e marra nga njësit bazë të FVFR dhe sekretaria mesimore, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Lidhur me procedurat para dhe gjatë provimeve, departamentet kanë marrë masa në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi për:

- përcaktimin e komisioneve të provimeve për çdo lëndë/modul brenda afateve të parashikuara;
- përcaktimin e sallave ku do të zhvilloheshin provimeve që të garantohej distanca nga studenti; në student, me qëllim shmangien e mundësisë për kopje a sjellje të tjera të palejueshme gjatë provimit;
- sekretimin e tezave të provimeve;
- zhvillimin e provimeve në përputhje me rregulloren e UST-së;
- përdorimin e sistemit Clean Score për korrigjimin e tezave të provimit.

Lidhur me procedurat pas provimeve, ju bëjmë me dije se:

- Pasqyrimi i rezultateve të vlerësimit të studentëve në platformën Pitagora është kryer konform rregulloreve në fuqi;
- Në asnjë departament nuk pasur raste të ankimimit të rezultatit të provimit nga ana e studentëve.

4. Menaxhimi i sezonit të provimeve të verës

Mbështetur në informacionet e marra nga njësit bazë të FVFR dhe sekretaria mesimore, ju bëjmë me dije si më poshtë.

Lidhur me procedurat para dhe gjatë provimeve, departamentet kanë marrë masa në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi për:

- përcaktimin e komisioneve të provimeve për çdo lëndë/modul brenda afateve të parashikuara
- përcaktimin e sallave ku do të zhvilloheshin provimeve që të garantohej distanca nga studenti në student, me qëllim shmangien e mundësisë për kopje a sjellje të tjera të palejueshme gjatë provimit
- sekretimin e tezave të provimeve
- zhvillimin e provimeve në përputhje me rregulloren e UST-së;
- përdorimin e sistemit Clean Score për korrigjimin e tezave të provimit;

Lidhur me procedurat pas provimeve, ju bëjmë me dije se:

- Pasqyrimi i rezultateve të vlerësimit të studentëve në platformën Pitagora është kryer konform rregulloreve në fuqi
- Në asnjë departament nuk pasur raste të ankimimit të rezultatit të provimit nga ana e studentëve.

5. Analiza e “feedback” për procesin e mesimdhënies gjatë vitit akademik 2024-2025

Një sintezë e fokus grupeve të realizuara gjatë vitit 2024 – 2025 është paraqitur si vijon.

Kampioni dhe strategjia e kampionimit

Studentët u zgjodhën në mënyrë rastësore, duke ndjekur kriterin që të jenë të përfshirë studentë e të gjithë niveleve, por edhe të ketë një numër të përafert për sa i përket kriterit gjinor.. Për përzgjedhjen e kampionimit për realizimin e fokus grupeve, iu dha prioritet përzgjedhjes dhe përfshirjes të studentëve sipas parimit një fokus grup për çdo vit studimi.

Instrumentet

Për marrjen e informacionit në përmjet fokus grupeve u hartuan intervista gjysmë të strukturuar për studentët. Intervistat më shumë u fokusuan në faktin se si e perceptojnë ata procesin e mesimdhënies në UST. Gjithashtu intervista synoi të kuptonte cilat ishin vështirësi të tyre në UST. Synimi ishte që në këtë bisedë ata të ndiheshin të lirshëm të komunikojnë si dhe të tregojnë atë që ata do dëshironin që të ndryshonte vërtet në UST por edhe se sa të gatshëm ndiheshin ata për të realizuar mësimet teorike, ushtrimet e praktikat profesionale. Për ne si NJSBC ishte e rëndësishme që gjatë intervistës të kuptonin sa më qartë, se cilat ishin pritshmëritë e tyre, për t’i përafruar sa më shumë me nevojat e tyre reale.

Çështje etike

Për realizimin e fokus grupeve u siguruar ruajtja e anonimatit të emrave të pjesëmarrësve në fokus grupe.

Pas një diskutimi të detajuar mbi tematikat e ndryshme të përfshira në fokus grup, disa pika kyçe që rezultuan janë:

Kurrikula dhe Rezultatet e të Nxënit

- Studentët janë të kënaqur me aftësitë që ofrohen nga kurrikula.
- Shumëllojshmëria e aftësive vlerësohet si përgatitje e mirë për tregun e punës.
- Evidentohet nevoja për shtimin e moduleve profesionale me aftësi praktike , për të rritur punësueshmërinë e studentëve.

Vlerësimi dhe Arritjet

- Procesi i vlerësimit konsiderohet i drejtë dhe transparent.
- Feedback-u nga pedagogët ndihmon në përmirësimin e performancës akademike.

Mësimdhënia dhe Mësimnxënia

- Metodat e mësimdhënies janë të përshtatshme për arritjen e objektivave.
- Kombinimi teori–praktikë dhe përdorimi i metodave bashkëkohore vlerësohen pozitivisht.

Organizimi dhe Menaxhimi

- Organizimi i orarit dhe aktiviteteve është faktor kyç për suksesin akademik.
- Komunikimi i qartë dhe në kohë për ndryshimet rrit efikasitetin e procesit mësimor.

Infrastruktura e Mësimdhënies & Ambientet Sportive

- Biblioteka dhe TIK-u konsiderohen mbështetës për procesin e të nxënit.
- Evidentohet nevoja për nxitjen e përdorimit më aktiv të këtyre burimeve dhe përmirësimi i ambienteve sportive.

6. Procesi i vlerësimit dhe vetëvlerësimit të stafit

Procesi i vlerësimit dhe vetëvlerësimit të stafit akademik dhe administrativ është realizuar në mënyrë të strukturuar dhe transparente, në përputhje me aktet ligjore dhe rregulloret në fuqi.

Rezultatet e këtij procesi janë të kënaqshme, duke reflektuar angazhim dhe performancë të mirë në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe kontribut institucional.

Megjithatë, procesi ka evidentuar edhe disa pika për përmirësim, veçanërisht në drejtim të zhvillimit teknologjik, rritjes së përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies, si dhe nevojës për trajnime të vazhdueshme profesionale. Adresimi i këtyre aspekteve pritet të kontribuojë në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë akademike dhe në përshtatjen e stafit me kërkesat bashkëkohore të arsimit të lartë.

7. Përmbledhje e Realizimit të Objektivave të Mësimdhënies dhe Kërkimit Shkencor FVFR (Viti Akademik 2024 – 2025)

Gjatë vitit akademik 2024 – 2025, fakulteti ka shënuar përparim të dukshëm në realizimin e objektivave strategjikë, duke u fokusuar në zhvillimin institucional, rritjen e standardeve akademike, forcimin e kërkimit shkencor, zgjerimin e partneriteteve dhe ndërkombëtarizimin, si dhe garantimin e cilësisë (sipas planit strategjik të UST-së).

Në aspektin e zhvillimit institucional, janë ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e përfshirjes aktive të studentëve në vendimmarrje, zhvillimin profesional të stafit akademik dhe planifikimin buxhetor afatmesëm, si dhe përmirësimin e infrastrukturës.

Sa i përket standardeve akademike, është avancuar procesi i akreditimit të programeve të studimit (Master Shkencor, Master Profesional MST dhe Doktoratë), janë përmirësuar programet e lendeve dhe materialet mësimore, si dhe janë ofruar mundësi praktike dhe aktivitete ndërkombëtare për studentët.

Marrja e feedback-ut nga studentët dhe stafi për ciklin e trete (Doktorate në “Aktivitet Fizik dhe Shëndet” ka treguar se procesi është i suksesshëm dhe ka kontribuar në diplomimin e studentëve të parë të programit të doktoraturës, duke dëshmuar efektivitetin e metodave të përdorura dhe mbështetjes akademike.

Në fushën e kërkimit shkencor, janë planifikuar burime financiare, janë miratuar temat e masterit shkencor dhe është vijuar mbështetja për pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete kërkimore (duke evidentuar rritje të ndjeshme nga viti kaluar, nga 10 publikime të indeksuar në scopus (2023 – 2024) në 28 artikuj të indeksuar në scopus (2024 – 2025).

8. Rekomandime të NJSBC për FVFR:

Në bazë të analizës së pikave të forta/të dobëta dhe mundësive për zhvillim, rekomandohet që Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit të ndërmarrë masa të fokusuara në forcimin e përgatitjes praktike, rritjen e efikasitetit institucional dhe përmirësimin e infrastrukturës. Rekomandimet kryesore janë:

Përmirësimi i praktikës profesionale dhe aktiviteteve praktike në programet e studimit, përmes shtimit të moduleve profesionale me theks praktik dhe zhvillimit të mëtejshëm të aktiviteteve rekreative me studentët, në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Rritja e përdorimit të infrastrukturës ekzistuese dhe përfshirjes në kërkimin shkencor, duke organizuar trajnime dhe orientime për shfrytëzimin efektiv të laboratorëve, bibliotekës dhe teknologjisë së informacionit.

Forcimi i bashkëpunimit me studentët dhe aftësimi soft-skills i tyre (gjuha e huyaj, aftësi komunikimi, puna në grup etj), përmes përfshirjes më aktive të tyre në proceset akademike dhe vendimmarrëse të universitetit.

Zhvillimi i programeve të përbashkëta dhe forcimi i partneriteteve si dhe mbështetje për ciklin e trete, duke zgjeruar bashkëpunimet me universitete dhe institucione kombëtare e ndërkombëtare,

veçanërisht për realizimin e programeve të përbashkëta (në gjuhën angleze), programe shkëmbimi për studentët dhe stafin akademik.

Promovimi i programeve të studimit dhe zhvillimi i platformes ALUMNI, përmes hartimit dhe zbatimit të një strategjie të strukturuar marketingu që thekson pikat e forta të fakultetit dhe perspektivat e karrierës për studentët.

Përmirësimi i infrastrukturës dhe digjitalizimi i shërbimeve, duke investuar në ambiente mësimore dhe sportive (palestra, stadium, pishinë) si dhe në digjitalizimin e plotë të shërbimeve akademike dhe administrative.

Hartimi dhe zbatimi i një plani të strukturuar për zhvillimin profesional të stafit, përmes trajnimeve periodike në teknologji, metoda inovative të mësimdhënies, kërkim shkencor dhe ndërkombëtarizim, me qëllim rritjen e cilësisë akademike dhe përditësimin e vazhdueshëm të kompetencave profesionale të stafit.

Zbatimi i këtyre rekomandimeve do të kontribuojë në rritjen e cilësisë së programeve të studimit, në përmirësimin e përvojës studentore dhe në forcimin e rolit të fakultetit si një qendër konkurruese dhe bashkëkohore në fushën e veprimtarisë fizike dhe rekreacionit.

ANALIZA E NJSBC, FSHR PËR VITIN AKADEMIK 2024 – 2025

PROGRAMET E STUDIMIT QË OFROHEN NGA FAKULTETI I SHKENCAVE TË REHABILITIMIT:

Gjatë vitit akademik 2024-2025, FSHR ka ofruar programin e ciklit të parë të studimit “Bachelor” në “Shkenca të Rehabilitimit”, program përgjegjës për të cilin është Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Humane, drejtuese departamenti, Prof. Asc. Dr. Oltiana Petri.

Gjithashtu FSHR ofron edhe programin e studimit në ciklin e dytë, “Master Profesional” në “Rehabilitim Fizioterapetik në Sport”, program i cili ofrohet nga Departamenti i Kineziologjisë, drejtuese departamenti, Prof. Asc. Dr. Genta Nallbani.

NJSBC e FSHR në bashkëpunim edhe me anëtarë të NJSBC të njësive të tjera, si edhe çdo vit tjetër ka realizuar fokus grupe të rastësishme me studentët dhe në këtë vit akademik janë realizuar disa të tilla se në javën e 8-të, 13-të dhe 23-të, ku janë përfshirë studentë të bachelorit dhe masterit. Në këto takimi studentët kanë ndarë problematikat e tyre në lidhje me të gjitha proceset dhe kanë shprehur mendimet e tyre në lidhje me mundësitë për përmirësimin e mësimdhënies etj.

Vlen për tu theksuar fakti se gjatë këtyre takimeve me fokus grupeve studentët kanë shprehur qartë dhe me shqetësim faktin që lidhet me licensimin e programit të studimit “Bachelor” në Shkenca të Rehabilitimit, dhe përfshirjen e këtij programi studimi në listën e profesioneve të rregulluara me ligj.

Gjithashtu nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur prej tyre, studentët janë shprehur se si pasojë e mbartjes dhe mos zgjidhjes së këtij problemi nga institucionet përkatëse ata kanë menduar edhe kanë vendosur dhe e konsiderojnë me vend bojkotimin e mësimi dhe se ky fakt nuk lidhet me stafin e FSHR apo cilësinë e mësimdhënies. Kjo problematikë është marrë në konsideratë nga drejtuesit e FSHR dhe UST dhe është bërë gjithçka e mundur që ky problem të zgjidhet sa më shpejt dhe se UST si institucion i ka kryer të gjitha detyrimet zyrtare që lidhen me këtë proces dhe që varen prej saj.

Gjithashtu, vlen për theksuar fakti si mbas një takimi që dekani i FSHR, Prof. Dr. Robert Çina dhe Rektori i UST, Prof. Dr. Robert Çina, kanë kryer në MAS me përfaqësues të institucione të ndryshme që janë pjesë e kësaj zgjidhjeje, kanë marrë një konfirmim që kjo problematikë do të zgjidhet sa më shpejt, brënda fillimit të vitit 2026. Ky informacion iu është përcjellë edhe studentëve nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.

Nisja e vitit akademik 2024 – 2025

Në lidhje me nisjen e vitit akademik 2024-2025, si edhe në vitet t tjera FSHR ka proceduar me vendosjen edhe përcaktimin e objektivave që lidhen me mësimdhënies në të dyja programet e studimit. Gjithashtu si edhe në vitet e tjera edhe përgjatë vitit akademik 2024-2025, NJSBC e UST-së, ka vazhduar normalisht me kontrollimin dhe mbikqyrjen e proceseve të ndryshme të punës në bashkëpunim edhe me departamentet përgjegjëse për programet e studimit por gjithashtu edhe me koordinatorët e tyre, duke patur si qëllim një vlerësim të ktyre programeve mësimore.

Anketimet në lidhje me procesin e mësimdhënies të kryera në javën e 8-të, viti akademik 2024 – 2025

Nga ana e NJSBC-së së UST dhe e FSHR janë organizuar 2 fokus grupe me studentët e bachelorit dhe 1 fokus grup me studentët e masterit profesional. Ata kanë shprehur mendimet e tyre në lidhje me të gjitha proceset si dhe kanë shprehur edhe sugjerimet e tyre me qëllim përmirësimin e procesit

Anketimet në lidhje me procesin e mësimdhënies të kryera në javën e 13-të, vitit akademik 2024 – 2025

Përgjatë javës së 13-të gjithashtu janë realizuar janë zhvilluar po 2 fokus grupe me studentët e bachelorit dhe 1 fokus grup me studentët e masterit profesional.

Sezonit i provimeve të dimrit

Bazuar tek të dhënat e sjella nga departamentet e FSHR dhe sekretaria mesimore procesi që lidhej me organizimin e të gjitha sezoneve të provimeve (dimrit, verës dhe vjeshtës) janë organizuar edhe kryer sipas rregulloreve. Janë përcaktuar dhe publikuar në kohën e duhur datat e provimeve dhe komisionet për secilën nga lëndët dhe modulet përkatëse. Gjithashtu janë përcaktuar dhe publikuar sallat ku do të zhvilloheshin provimet dhe janë marrë masat e nevojshme në lidhje me përdorimin e sistemit Clean Score për korrigjimin e tezave të provimit;

Analiza e Ndryshimeve në Programet Mësimore

Evidentimi i kërkesave për ndryshime:

Gjatë fillimit të vitit akademik, në bazë të kërkesa të diskutuara edhe në vitet më përpara edhe pas diskutimeve të ndryshme për të gjitha lëndët dhe moduleve përkatëse, pas marrjes së akreditimit të programit të studimit “Bachelor” në “Shkenca të Rehabilitimit” është proceduar me ndryshimet sipas ligjit deri në masën 20% të planit mësimor të programit të studimit të ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Shkencat e Rehabilitimit”. Në proces janë përfshirë të gjitha anëtarët e stafit akademik kërkimor shkencor ku janë diskutuar me detaje të gjitha mendimet edhe janë argumentuar të gjitha ndryshimet (Bazuar edhe në propozimet e DSHBH të vitit akademik të kaluar ku është propozuar për ndryshime deri në masën 17.2% të planit mësimor të ciklit të parë të studimit Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit" ne FSHR, me nr. 1198/4 Prot).

Përmirësimi i Syllabuseve dhe Moduleve

Përfshirja e stafit akademik

Në lidhje me procesin e përmirësimit të programeve/syllabuseve si edhe në çdo vit tjetër, i gjithë stafi i FSHR, përgjegjësit e lëndëve dhe module, janë angazhuar në përmirësimin dhe rishikimin e lëndëve dhe syllabuseve për të cilin/ata janë përgjegjës. Ky proces shërben për rritjen e nivelit dhe cilësisë së mësimdhënies.

Rekomandime për Vijim:

- **Vazhdimi i monitorimit dhe përmirësimit:** NJSBC ka në fokusin e saj të vazhdueshë, procesin e monitorimit të gjitha elementëve të procesit mësimor dhe gjithashtu evidentimin e nevojave për përmirësime të mundshme.
- **Rritja e bashkëpunimit me studentët:** NJSBC/FSHR, ka prioritet përfshirjen sa më shumë dhe në mënyrë sa më aktive të studentëve të të gjitha planeve të studimit në të gjitha fazat dhe proceset e vlerësimit të cilësisë me qëllim që të ketë sa më shumë informacion në kohë reale për të bërë të mundur dhe për të ndihmuar identifikimin e problemeve dhe aspekteve të ndryshme që kanë nevojë të rregullohen.
- **Zhvillimi i trajnimeve për stafin akademik:** Zhvillimi sipas mundësive i trajnimeve të ndryshme në lidhje me praktikën më të mirë të mësimdhënies janë një mënyrë e mirë e cila mund të kontribuojnë në rritjen e mëtejshme të standardeve.

Procesi i vlerësimit dhe vetë-vlerësimit të stafit

Përsa i përket procesit të vlerësimit dhe vetë-vlerësimit të stafit nga drejtuesit e njësive bazë për vitin akademik 2024-2024, bazuar tek përpunimi i të dhënave rezulton se ky proces ka qënë i mirë, dhe ka nxjerrë edhe anagzhimin e stafit për realizimin sa më të mirë të mësim-dhënies edhe mësim-nxënies por edhe specializimin dhe përmirësimin e dijeve nga stafi. Gjithashtu drejtuesit e njësive kanë vlerësuar edhe rezultatet e kërkimit shkencor për secilin anëtar të njësive përkatëse.

Vlerësimi i treguesve të cilësisë së mësimdhënies nga stafi akademik për vitin akademik 2024-2025.

Në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe vlerësimit të treguesve të cilësisë nga ana e stafit akademik për vitin akademik 2024-2025, rezulton se ky vlerësim është pozitiv. Stafi rezulton se në mënyrë të vazhdueshme përgatitet për mësimdhënie, është i përditësuar me përdorimin e teknologjive të reja dhe të metodave të reja të mësimdhënies duke përmirësuar dhe përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të studentëve.

Analiza e pikave të forta dhe pikave të dobta

Në FSHR dhe më konkretisht tek programet që ky fakultet ofron një nga problematikat më kryesore vazhdon të jetë ajo që lidhet me bashkëpunimet me klinika profesionale që kanë investuar në pajisje moderne dhe kanë staf të kualifikuar duke evidentuar sërish faktin e vështirësive në zgjidhje e problemit që lidhet me pagesat ndaj palëve të treta të cilat mund ta ofrojnë këtë shërbim. Gjithashtu një tjetër pikë e dobët vazhdon të jetë marketimi i duhur dhe në kohën e duhur i programeve të studimit që FSHR ka në ofertën e saj, përsëri kjo problematikë lidhet me financimin edhe me një koordinim më të mirë të strukturave përgjegjëse. Një tjetër dobësi për të cilën për shumë kohë janë bërë përpjeket nga drejtuesit e FSHR dhe UST është ajo që lidhet me faktin që FSHR të finalizojë mundësitë për të krjuar bashkëpunime me universitete të tjera të ngashme për të ofruar programe të përbashkëta studimie por edhe mobilitete për studentët dhe stafin akademik.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME TË SJELLA NGA NJËSITË BAZË TË EVIDENTUARA EDHE NË RAPORTIN VJETOR TË FSHR

Nesia bazë	Konkluzione Kryesore	Objektivat për Vitin në Vijim
Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Humane	✓ Pjesëmarrje aktive në kërkim shkencor dhe konferenca ndërkombëtare ✓ Implementim i politikave të vlerësimit të studentëve (Clean-Score) ✓ Mbështetje për studentët në projekte shkencore dhe orientim karriere ✓ - Bashkëpunim me institucionet për licensimin e studentëve	✓ Përfundimi i procedurave për licensimin e ciklit Bachelor ✓ Përditësimi i programeve dhe literaturës ✓ Zgjerimi i projekteve kërkimore, përfshirë projekte ndërkombëtare ✓ Mbështetje e vazhdueshme e studentëve ✓ Përmirësimi i kualifikimit të stafit ✓ Pjesëmarrje aktive në Programin Erasmus 2025
Departamenti i Kineziologjisë	✓ Procesi mësimor i zhvilluar sipas rregullores së UST dhe orarit mësimor ✓ Realizimi i provimeve sipas komisioneve të miratuara ✓ Stafi akademik i angazhuar në edukim të vazhdueshëm dhe aktivitete kërkimore	✓ Përmirësimi i procesit të mësimdhënies në programin Master ✓ Aplikimi për hapjen e Programit Master Shkencor Dual Diploma- Përmirësimi i syllabuseve dhe pasurimi i leksioneve ✓ Pjesëmarrje aktive në projekte dhe publikime shkencore ✓ Aktivizimi i stafit në aktivitete fakulteti dhe Universiteti

Nesia bazë	Konkluzione Kryesore	Objektivat për Vitin në Vijim
Departamenti i Rehabilitimit	✓ Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe integrimi i praktikës profesionale ✓ Përdorimi i teknologjive moderne dhe laboratorëve të specializuar ✓ Bashkëpunim ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për projekte dhe mobilitet ✓ Promovimi i kërkimit shkencor dhe përfshirja e studentëve	✓ Sigurimi i mësimdhënies standarde dhe bashkëkohore ✓ Përditësimi i kurrikulave sipas standardeve ndërkombëtare ✓ Hapja e programit të ri Master Shkencor në Fizioterapi ✓ Mbështetje për staf në konferenca dhe aktivitete kërkimore ✓ Modernizimi i laboratorëve dhe burimeve didaktike ✓ Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i procesit mësimor

INSTITUTI I KËRKIMIT SHKENCOR TË SPORTIT

1. Analiza e vitit akademik 2024-2025

- *Informacion nga Njësitë Bazë mbi të anëve të forta dhe problematikave nga të dhënat e pyetësorëve të realizuar si për stafin akademik ashtu edhe për studentet:*

Referuar kërkesës së NJSBC-së për të analizuar problematikat të cilat ndikojnë në uljen e cilësisë së mësimdhënies janë paraqitur si më poshtë sipas departamenteve.

Departamentit i Performances Sportive ka paraqitur këto problematika:

- Mungesa e përgatitjes lëvizore të nxënësve të ardhur si kandidat për student në shkollën tonë lë shumë për të dëshiruar.
- Niveli intelektual i tyre dhe nota mesatare shumë e ulët
- Mungesa e theksuar e sportistëve nëpër klubet sportive.
- Mungesa në njohuri bazë matematikore- background bazë i studenteve
- Leksionet fakultative
- Kompleksiteti i Kërkimit Shkencor
- Baza materiale
- Mungesa e kulturës së të lexuarit nga ana e studentëve të vitit të parë dhe vështirësitë e përshtatjes me kërkesat e universitetit.
- Mungesa e motivimit të studenteve për t'u përfshirë në diskutime të lira, kryesisht në Seminaret Teorike, edhe pse lektori i modulit jua vë në dispozicion në të gjitha format dhe menyrat e ndryshme, si në email, print dhe padiskutim prezencën e tij në orët e leksioneve dhe seminareve.
- Nuk kanë interesin në mesim, edhe pse leksionet, u janë dhënë, shpjeguar, literatura u është treguar dhe rendesia e lëndës
- Përplasia e grupeve me fakultetet e tjera. Temperaturat e ulta në ambjentet ku ushtrohen studentet.
- Puna e studenteve mbasditë i pengon por përqindja është e ulët e mos ardhjes në mesim
- Nuk kanë interes për mësimdhënie, as pjesëmarrjen në mesim

- Ngrohja në klasat e seminareve.
- Terrenet sportive
- Orët e vona mësimore shpesh janë problem për tu ndjekur nga kategoria e studenteve që janë të angazhuar në ekipe sportive apo punë.
- Numri i lartë i studenteve në grupe (volejboll)
- Niveli i përgatitjes së studenteve.

Departamenti I Projekteve dhe Teknologjise ka paraqitur keto problematika:

- Mos prezenca e të gjithë grupit në orën e mësimit.
- Mungesa e kulturës së të lexuarit nga ana e studenteve të vitit të parë dhe vështirësitë e përshtatjes me kërkesat e universitetit.
- Orët e vona mësimore shpesh janë problem për tu ndjekur nga kategoria e studenteve që janë të angazhuar në ekipe sportive apo punë.
- Koordinimi I sallave për të pasur fonin muzikore në çdo orë mesimore
- Kohëzgjatja e shtrirjes së modulit në semester.

Departamenti i Aktivitetit Fizik dhe Shëndetit ka paraqitur këto problematika:

- Mungesa në njohuri bazë matematikore- background bazë i studenteve
- Komplexiteti i Kërkimit Shkencor
- Mos prezenca e të gjithë grupit në orën e mësimit.
- Mos përgatitja dhe mos impenjimi i studenteve
- Mungesa e kulturës së të lexuarit nga ana e studenteve të vitit të parë dhe vështirësitë e përshtatjes me kërkesat e universitetit.
- Mos pjesmarrja e rregullt e studenteve në leksione ashtu edhe në seminare
- Mos paraqitja e studenteve të përgatitur në mesim
- Mungesa e motivimit të studenteve për t'u përfshirë në diskutime të lira, kryesisht në Seminaret Teorike, edhe pse lektori i modulit jua vë në dispozicion në të gjitha format dhe menyrat e ndryshme, si në email, print dhe padiskutim prezencën e tij në orët e leksioneve dhe seminareve.
- Mungesa e prezencës së studenteve, për shkak të orareve të vona, seminareve dhe leksioneve, përcaktuar në orarin mësimor, të cilat më është dashur në shumicën e rasteve t'i bëj më herët.
- Nuk kanë interesin në mësim, edhe pse leksionet, u janë dhënë, shpjeguar, literatura u është treguar dhe rëndësia e lëndës.
- Ngrohja në klasat e seminareve.
- Niveli i përgatitjes të studenteve.
- Ambjentet në dispozicion të procesit mësimor janë të pamjaftueshme.
- Mos interesim i studentëve në momentin që leksionet janë fakultative. Numri i konsiderueshem i studentëve të cilët kanë mangësi të njohurive bazë të marra në arsimin 9 vjeçar dhe gjimnaz. Asnjë student nuk është i interesuar për literaturë shtesë. Ndarja e modulit me disa pedagoge ndryshon mënyrën e përcjelljes së Informacionit pamvarësisht se koncepti nuk ndryshon, pasi çdo pedagog ka stilin e vet të dhënies së informacionit.

- Frekuentimi leksionit në auditor nga studentët. Mos përgatitja e studentëve në nivelin e duhur. Mendoj mesatarja e ulët e studentëve sjell nje feedback negativ në gjithë performancën e tyre.

Raporti nga pyetsorët në Njësitë Bazë për vleresimet e brendshme të stafit akademik.

Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga Ligj Nr. 80/2015, Neni 103, Pika 1;2;3 dhe sipas përcaktimeve të Planit të Veprimit, NJSBC organizon Formulare të vlerësimit nga drejtuesi i departamentit për të përmbushur standartet për cilësinë e mësimdhënies në përfundim të vitit akademik 2022-2023.

Çdo departamenti ju është shpërndarë formulari i vlerësimit nga drejtuesi i departamentit sipas shkallës së vlerësimit 5 = shumë i kënaqur; 4 = i kënaqur; 3 = nuk e di; 2 = i pa kënaqur; 1 = shumë i pa kënaqur.

- **DEPARTAMENTI PERFORMANCËS SPORTIVE**, ka raportuar në lidhje me njohuritë dhe aftësitë për:

Zotërim i njohurive të fushë/lëndës	5
Shtrimi i problemit dhe aftësitë për zgjidhjen e tij	4
Aftësitë kërkimore shkencore	5
Aftësi për të lidhur teorinë më praktikën	5
Aftësi për të ndërtuar një program lëndor	4
Aftësi të sipërmarrjes	4
Aftësi digjitale	4
Aftësi krijuese	4
Aftësi të komunikimit	5
Aftësi për të punuar në grup	5
Aftësi drejtuese	4
Të menduarit në mënyrë të pavarur	4
Motivimi	5
Aftësi për të marrë vendime	4
Aftësi të menaxhimit të kohës	5
Etika profesionale	5

- **DEPARTAMENTI I PROJEKTEVE DHE I TEKNOLOGJISE**, ka raportuar në lidhje me njohuritë dhe aftësitë për:

Zotërim i njohurive të fushë/lëndës	5
Universiteti i Sporteve zbaton një politikë strategjike permanente e progresivisht në rritje në mbështetje të studentëve duke u bazuar në rritjen e kapaciteteve buxhetore, infrastrukturore, akademike e ndërkombëtare në vijim të zhvillimit të planit strategjik të tij.

Më poshtë po japim me pika veprimtaritë që UST kontribon në mbështetje të studentëve *(për të gjitha pikat e cituara më poshtë gjeni referenca në tabelat e analizës mësimore, kërkimore shkencore të paraqitura më lart, si dhe ato financiare të paraqitura më poshtë)*:


- Mbështetje e plotë financiare për 6 kurse “outdoor” në bachelor, si dhe pjesërisht në 2 kurse master;
- Mbështetje e plotë financiare në të gjitha praktikat profesionale, bachelor dhe master;
- Përfshirje dhe mbështetje e studentëve në projektet kërkimore, botimet dhe konferenca që zhvillon stafi akademik i të gjitha njësive kryesore të UST-së;
- Akses dhe shërbime të plata në Bibliotekën e UST, fizike dhe elektronike, si dhe akses online në bibliotekak e universiteteve partnere EU;
- Mbështetje e plotë financiare për realizimin e testimeve laboratorike në fuksion të realizimit të tezave për studentët e masterit shkencor, si dhe 25% të vlerës të testimeve laboratorike për studentët e programit të doktoraurës;
- Përfshirja e studentëve në të gjitha mobiletet ndërkombëtare që UST ka në kuadër të Erasmus+ K171, studentët e bachelor, master dhe të doktoraurës;
- Universitetit të Sporteve të Tiranës ka vënë në dispozicion të Qeverisë Studentore dhe të Shoqatës Sportive të tyre dy zyra dhe një sallë mbledhjesh paranë Sallës të Lojerave me dorë të UST;
- Përfshirja e studentëve në projekte të detikura nga Bashkia e Tiranës, Fedratate Spotive si dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar;
- Mbështetje financiare për Shoqatën Sportive të studentëve të UST, për relizimin e pjesëmarrjeve në turne kombëtarë e ndërkombëtarë;
- Mbështetje financiare për Qeverinë Studentore për organizimin e eventeve social-kulturore e sportive.

XI. ANALIZA FINANCIARE 2024 – 2025

A. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR STRUKTURËN

Struktura dhe numri i personelit akademik, ndihmës-akademik, ndihmës akademik me karakter administrativ dhe administrativ është miratuar në Senat dhe në Bordin Administrimit.

ORGANIGRAMA E UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS



Struktura e UST-së është ndërtuar në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në VKM nr. 123 datë 17.02.2010 “Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës”, në Urdhrin e MASR me Nr.495, datë 11.10.2019 “Për hapjen e njësisë kryesore ”Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit”, në Universitetin e Sporteve të Tiranës”. Stafi është paguar në zbatim të VKM nr.243 datë 20.04.2023 për një ndryshim në vendimin nr.748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë, të VKM nr. 325, date 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve,

zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabinetëve në disa institucione të administratës publike” të ndryshuar, të VKM nr. 326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të specialiteteve të tjera në institucione të administratës publike” të ndryshuar, të Vendimit nr. 113, datë 1.3.2023 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, të Vendimit nr. 77, datë 28.1.2015 të Këshillit të Ministrave “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” i ndryshuar, të Udhëzimit të MAS nr. 29 datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”, të Udhëzimit nr. 16, datë 16.06.2023, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për mënyrën e zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325 datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabinetëve në disa institucione të administratës publike”.

Struktura e punonjësve efektivë, si dhe numri i punonjësve me kontratë në Universitetin e Sporteve të Tiranës është miratuar me vendim të Senatit Akademik dhe Vendime të Bordit të Administrimit.

Universiteti i Sporteve të Tiranës përbëhet nga Rektorati, Administrata dhe nga 4 njësi kryesore të cilët janë:

- Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes;
- Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit;
- Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit;
- Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit.

Aktualisht ajo përbëhet nga 198 punonjës, prej të cilëve: 115 janë personel akademik, 4 janë personel ndihmës akademik me karakter administrativ në njësitë kryesore, 18 janë personel ndihmës akademik me karakter mësimor në njësitë kryesore, 32 janë personel ndihmës akademik me karakter administrativ dhe 29 janë personel administrativ.

Gjatë vitit akademik ka patur ndryshime në strukturë me qëllim të plotësimit të kërkesave të njëjësive kryesore dhe për arsye objektive, gjithashtu ka patur dhe ndryshime në strukturën e administratës por këto ndryshime janë brenda numrit të miratuar në fillim të vitit buxhetor sipas legjislacionit në fuqi të miratuar nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit

Stafi akademik e administrativ i Universitetit të Sporteve të Tiranës është i detajuar sipas organigramës së UST-së dhe tabelave si më poshtë:

Tabela 1. Mbi numrin e personelit të UST-së.

Nr.	Universiteti i Sporteve të Tiranës	Pedagog me kohë të plotë e staf ndihmës administrativ					
		Profesor	Prof. Asc.	Lektor	As/Lektor	Personel akademik gjithsej	Nd/akademik me karakter mësimor
1	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	6	13	9	12	40	6
1.1	Dekanati ndihmës akademik e administrativ						1
1.2	Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit	3	6	6	3	18	1
1.3	Departamenti i Sporteve Kolektive	0	2	2	6	10	2

1.4	Departamenti i Sportive Individuale	3	5	1	3	12	2
2	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	2	4	11	13	30	6
2.1	Dekanati ndihmës akademik e administrativ						1
2.2	Departamenti i Aktivitetit Fizik, Rekreacionit dhe Turizmit	1	2	3	5	11	2
2.3	Departamenti i Menaxhimit të Sportit dhe Turizmit	1	0	5	3	9	1
2.4	Departamenti i Lëvizjes dhe Shëndetit	0	2	3	5	10	2
3.	Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit	4	3	4	12	23	6
3.1	Dekanati ndihmës akademik e administrativ						1
3.2	Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Humane	0	2	2	4	8	1
3.3	Departamenti i Kineziologjisë	2	1	1	3	7	2
3.4	Departamenti i Rehabilitimit	2	0	1	5	8	2
4.	Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit	5	2	3	12	22	4
4.1	Drejtori ndihmës akademik e administrativ						1
4.2	Departamenti Performancës Sportive	1	1	1	5	8	1
4.3	Departamenti i Aktivitetit Fizik dhe Shëndeti	3	0	1	3	7	1
4.4	Departamenti i Projekteve dhe Teknologjisë	1	1	1	4	7	1
5.	Staf ndihmës akademik karakter Administrativ						32
6.	Staf administrative						29
7.	Gjithsej FSHL+ FVFR+ FSHR+IKSHS+ Nd/Akademik dhe Administrata						198

Tabela 1.1. Stafi akademik i jashtëm i Universitetit të Sporteve të Tiranës, viti akademik 2024-2025

Nr.	Universiteti i Sporteve të Tiranës	Pedagog me kohë të pjesshme				
		Profesor	Prof. Asc.	Lektor	As/Lektor.	Gjithsej
1.	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	0	1	3	3	7

1.1	Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit	0	1	3	1	5
1.2	Departamenti i Sporteve Kolektive	0	0	0	0	0
1.3	Departamenti i Sportive Individuale	0	0	0	2	2
2.	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	0	2	0	0	2
2.1	Departamenti i Aktivitetit Fizik, Rekreacionit dhe Turizmit	0	2	0	0	2
2.2	Departamenti i Menaxhimit të Sportit dhe Turizmit	0	0	0	0	0
2.3	Departamenti i Lëvizjes dhe Shëndetit	0	0	0	0	0
3.	Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit	0	1	1	12	14
3.1	Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Humane	0	0	1	2	3
3.2	Departamenti i Kineziologjisë	0	1	0	0	1
3.3	Departamenti i Rehabilitimit	0	0	0	10	10

Tabela 1.2. Stafi akademik i jashtëm i Universitetit të Sporteve të Tiranës 2025-2026, deri në muajin dhjetor 2025.

Nr.	Universiteti i Sporteve të Tiranës	Pedagog me kohë të pjesshme				
		Profesor	Prof. Asc.	Lektor	As/Lektor.	Gjithsej
1.	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	0	2	1	6	9
1.1	Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit	0	2	1	2	5
1.2	Departamenti i Sporteve Kolektive	0	0	0	0	0
1.3	Departamenti i Sportive Individuale	0	0	0	4	4
2.	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	0	0	0	4	4
2.1	Departamenti i Aktivitetit Fizik, Rekreacionit dhe Turizmit	0	0	0	2	2
2.2	Departamenti i Menaxhimit të Sportit dhe Turizmit	0	0	0	1	1
2.3	Departamenti i Lëvizjes dhe Shëndetit	0	0	0	1	1
3	Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit	0	1	1	8	10
3.1	Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Humane	0	0	1	2	3
3.2	Departamenti i Kineziologjisë	0	1	0	1	2
3.3	Departamenti i Rehabilitimit	0	0	0	5	5

- Struktura ndihmës akademike në administratë **32**
- Struktura administrative **29**
- Struktura ndihmës akademike në njësitë kryesore **22**

B. TË DHËNA PËR PLANIN BUXHETOR AFATMESËM, PLANIN BUXHETOR NJËVJEÇAR DHE PLANIN STRATEGJIK TË ZHVILLIMIT TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS.

Mbështetur në Ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Ligjin nr. 9936, datë 26. 06. 2008 ”Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në Ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, në Ligjin nr. 115/ 2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, në Vendimin nr. 870, datë 14.12.2011 e Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” i ndryshuar, në Vendimin nr. 75, datë 12.2.2018 ” Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” i ndryshuar me Vendimin nr. 784, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave, si dhe me Vendimin nr. 39, datë 23.1.2019 të KM, në Vendimin nr. 780, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”, në VKM nr.243 datë 20.04.2023 për një ndryshim në vendimin nr.748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë, në VKM nr. 325, date 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike” të ndryshuar, në VKM nr. 326, date 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të specialiteteve të tjera në institucione të administratës publike” të ndryshuar, në Vendimin nr. 113, datë 1.3.2023 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, në Vendimin nr. 77, datë 28.1.2015 të Këshillit të Ministrave “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” i ndryshuar, Vendimi nr. 887, datë 27.12.2022 i Këshillit të Ministrave “Për Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike”, në Udhëzimin e MAS nr. 29 datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”, i ndryshuar, në Udhëzimin nr. 16, date 16.06.2023, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për mënyrën e zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325 datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, në Udhëzimi nr. 7, datë 28.02.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, i ndryshuar, mbështetur në objektivat e përcaktuara në strategjinë e zhvillimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, në shkresën e FSHL me nr. 763/6 datë 20.05.2025 “Dërgim i propozimeve për programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 për FSHL”, në shkresën e FVFR me nr. 763/10., datë 23.05.2025 ”Përcjellje e propozimit për programi buxhetor afatmesëm 2026-2028”, në shkresën e FSHR me nr.763/8., datë 22.05.2025 ”Përcjellje e propozimit për programi buxhetor afatmesëm 2026-2028”, të kërkesave buxhetore të Institutit të Kërkimit Shkencor të Sporteve përcjellë me e-mail, si dhe shkresave të drejtorive përkatëse, është përgatitur programi afatmesëm për vitet 2026-2028 për Universitetin e Sporteve të Tiranës.

Hartimi i projekt buxhetit për vitin 2026 dhe PBA 2026-2028 është bërë duke mbajtur për bazë metodologjinë e planifikimit, ecurinë e realizimit të pritshëm për vitin 2025, strukturën e institucionit, numrin e studentëve, programet e studimit, kërkesat për investime, të gjitha këto në përmbushje të objektivave duke patur parasysh Planin Strategjik 2026-2031, të miratuar me Vendim Senati me Nr. 67, datë 03.06.2025 dhe Vendim të Bordit të Administrimit me Nr. 42, datë 01.08.2025.

Më poshtë paraqiten të dhënat e parashikuara për planin buxhetor afatmesëm, planin njëvjeçar.

Tabela. 2 Të dhëna për planin Buxhetor Afatmesëm në 000/lekë.

Të dhëna për planin buxhetor afatmesëm			
Emërtimi i projektit	Viti 2024	Viti i pritshëm 2025	Parashikimi për vitin 2026
Financimi i Buxhetit të shtetit	374,098,319	370,000,377	604,234,000
Grandi Kërkimor shkencor	3,899,250	30,535,186	6,749,000
Fond Grandi për Zhvillimin e Institucional	54,394,700	86,934,992	57,800,000
Totali	432,392,269	487,470,555	668,783,000
Disbursime projekte të huaja			
Emërtimi i projektit	Viti paraardhës	Viti aktual	Viti pasardhës
Disbursime projekte të huaja	12,142,693	6,954,826	2,838,000
Totali	12,142,693	6,954,826	2,838,000
Të ardhurat e institucionit			
Emërtimi i projektit	Viti paraardhës	Viti aktual deri më 30.11.2025	Viti parashikim
<i>Të ardhura nga Tarifat e shkollimit</i>	20,928,000	22,882,000	22,459,000
<i>Të ardhura nga Master profesional</i>	3,323,000	3,611,000	9,109,000
<i>Të ardhura nga Master Shkencor</i>	37,031,000	40,146,000	39,503,000
<i>Të ardhura nga Doktoraturë</i>	5,333,000	7,600,000	9,867,000
<i>Të ardhura nga Tarifat e kohës pjesshme</i>	-	-	-
<i>Të ardhura nga Libreza Diploma etj.</i>	1,937,000	1,593,000	700,000
<i>Të ardhura nga Fotokopje, vërtetime ,etj.</i>	199,000	184,000	50,000
<i>Të ardhura nga Taksë regjistrimi në Universitet</i>	1,541,000	2,054,000	1,954,000
<i>Të ardhura nga (FSHL) Konkurse Bachelor</i>	3,402,000	3,454,000	3,100,000
<i>Të tjera (shërbime)</i>	7,727,000	8,206,000	10,000,000
<i>Dokumente tenderi</i>	-	-	-
<i>Sponsorizime</i>	-	-	-
<i>TJERA- parkimi</i>	1,051,000	1,174,000	500,000
<i>Pjesëmarrja në konference</i>	-	-	-
<i>Te tjera (kthime)</i>	839,000	70,000	-
<i>(FSHL) Te tjera (trajnimet)</i>	-	-	-
<i>Te tjera (trajnimet)</i>	-	1,000	-
<i>Te tjera (trajnimet)</i>	-	350,000	-
<i>Te ardhura sekondare (Testi Fizik Specifik)</i>	1,074,000	10,000	-
<i>Qendra e Projekteve</i>	-	-	-
<i>Te tjera (Programi Psiko-Pedagogjik)</i>	385,000	525,000	22,000
Totali	84,770,000	91,860,000	97,264,000

- **NUMRI I STUDENTËVE QË KANË PËRFITUAR BURSË DHE PËRJASHTIM/REDUKTIM TARIFE.**

Mbështetur në nenin 49, të Ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të:

- VKM nr.903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi mbështetës studentorë, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar me VKM nr.39 datë 23.01.2019, të

-VKM nr.780 datë 26.12.2018 “ Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimeve në programet e ciklit të dytë të studimeve në IAL Publike”,

-VKM nr. 778 datë 26.12.2018 “Për një ndryshim dhe shtesë në VKM nr.288 datë 21.05.2018 “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në IPAL, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, të ndryshuar.

Gjatë vitit akademik 2024 – 2025 në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat e studentëve të cilët kanë përfituar bursë dhe përjashtim/ reduktim tarife për vitin akademik 2024-2025 sipas kriterëve të përcaktuara me VKM përkatëse.

Tabela 3. Efektet financiare nga zbatimi Vendimeve të Këshillit të Ministrave për studentë që përfitojnë bursa financiare, përjashtim apo reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2024 – 2025:

Universiteti i Sporteve te Tiranes							
NR	Efektet e Vendimeve te Keshillit te Ministrave "Per studente qe perfitojne bursa financiare , perjashtim apo reduktim nag tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, sipas VKM si me poshte	Total Nr studente	Total efekti fiannciar (viti akademik 2024-2025)	Numri I studenteve me noten mesatare 9-10, qe perfitojne bursa financiare+perjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit. Viti akademik 2024-2025	Efkti finannciar per studentet me note mesatare 9-10,bursa+ tarifa vjetore e shkollimit.	Numri I studenteve nga kategorite sociale ne nevojë qe perfitojne burse+ tarifa vjetore e shkollimit.	Efkti fiannciar ga kategorite sociale ne nevojë qe perfitojne burse+ tarifa vjetore e shkollimit. (Viti akademik 2024-2025)
		A=C+E	B=D+F	C	D	E	F
a.1 bursat	me VKM nr. 39, datë 23.1.2019. Me VB nr 52 date 24.12.2024, VB nr 53 date 24.12.2024, VB nr 2 date 29.01.2025, VB nr 3 date 29.01.2025, VB nr 10 date 19.02.2025, VB nr 11 date 19.02.2025,VB nr 15 date 07.03.2025, VB nr 20 dt 23.04.2025, VB nr 36 dt 30.05.2025	108	9,390,001	5	450,000	103	8,940,001
a.2 bursat	Studentë që përfitojnë bursa financiare sipas VKM nr. 903, datë 21.12.2016, i ndryshuar me VKM nr. 39, datë 23.1.2019., që kanë paraqitur kërkesë në plotësim të kriterëve, në pritje të konfirmimeve nga institucionet përkatëse për të përfituar bursë financiare						
	Total Bursat 2024-2025 a1+ a2	108	9,390,001	5	450,000	103	8,940,001
b.1 tarifat	Numri i studenteve që përfitojnë nga ulja/reduktimi me 50% i tarifës vjetore të shkollimit për vitin akademik 2024-2025 sipas VKM nr. 288 datë 21.05.2018, i ndryshuar (Cikli i pare i studimeve)_viti i parë, i regjistruar 2024 Me VB nr 52 date 24.12.2024	384	6,720,000			384	6,720,000
b.2 tarifat	Numri i studenteve që përfitojnë nga ulja/reduktimi me 50% i tarifës vjetore të shkollimit për vitin akademik 2024-2025 sipas VKM nr. 288 datë 21.05.2018, i ndryshuar (Cikli I pare I studimeve)_viti i dytë e viti tretë me mesatare mbi 6 Me VB nr 52 date 24.12.2024	525	9,187,500			525	9,187,500
	Total b1+b2	909	15,907,500	0	0	909	15,907,500
b.3 tarifat	Numri i studenteve që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit (për vitin akademik 2024-2025) sipas VKM nr. 269, datë 29.03.2017, i ndryshuar me VKM nr 40 date 23.01.2019 Me VB 52 date 24.12.2024, VB nr 53 date 24.12.2024, VB nr 2 date 29.01.2025, VB nr 10 date 19.02.2025, VB nr 11 date 19.02.2025, VB nr 15 date 07.03.2025, VB nr 20 dt 23.04.2025, VB nr 36 dt 30.05.2025	141	3,027,500	5	175,000	136	2,852,500
b.4 tarifat	Numri i studenteve që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit (për vitin akademik 2024-2025) sipas VKM nr. 269, datë 29.03.2017, i ndryshuar me VKM nr 40 date 23.01.2019 që kanë paraqitur kërkesë në plotësim të kriterëve, në pritje të konfirmimeve nga institucionet përkatëse në pritje për të përfituar përjashtim nga tarifa e shkollimit.	-	-				
	Total b3+b4	141	3,027,500	5	175,000	136	2,852,500
b.5 T arifat	Numri i studentëve që përfitojnë reduktim me 50%, të tarifës vjetore të studimit, sipas Vendimit nr. 780, datë 26.12.2018 (Cikli i dytë i studimeve) Vendim Bordi Me VB nr 52 date 24.12.2024, VB nr 54 date 24.12.2024, VB nr 3 date 29.01.2025, VB nr 9 date 19.02.2025, VB nr 12 date 19.02.2025, VB nr 16 date 07.03.2025, VB nr 21 dt 23.04.2025	56	2,937,300	8	442,500	48	2,494,800
	Total b.5	56	2,937,300	8	442,500	48	2,494,800
	Total b1+b2+b3+b4+b5	1,106	21,872,300	13	617,500	1,093	21,254,800
	Shuma (a _bursat +b _Tarifat)	1,214	31,262,301	18	1,067,500	1,196	30,194,801

Tabela nr. 4 Tabela e studentëve të ciklit të parë të studimeve që përfitojnë përjashtim tarife për vitin akademik 2024-2025.

NR	Emer timi i progr amit	Stud ente me aftes i te	Studente/ff emije te personave me aftesi te kufizuar,	Studente ku familjare perfitojne ndihme ekonomike (kr.1)	Student me prind bashkejetues pensionist dhe prindi tjeter eshte ndare nga jeta (kr.5)	Student te shkelqyer nga viti paraardhes	Student ekselent	Statusi jetimit (kr.8)	Student i cili i ka te dy prinderit pensionist (kr.6)	Student e qe rezultojne femije te punonjesesve te Policise se shtetit,te rene ne detyre kr.(11)	Student qe vijne nga nje familje me tre femije e egjip	Stud ente rom dhe egjip	Studente femije te ish te denuarve dhe te perdjekurve politike (kr.13)	Student qe kane te paktën njerin prind me aftesi te kufizuar (kr.14)	Totali	Efkti Financiar
1	Fakulteti i Shkenca te	2		38	3	1	3		1		1	4	1	12	66	2,345,000
2	Fakulteti i Veprimtarise		1	37	1			1			2			13	55	1,925,000
3	Fakulteti i shkencave	2	1	12		1	1				1			2	20	700,000
Totali		4	2	87	4	2	4	1	1	0	4	4	1	27	141	4,970,000




Tabela nr. 5 Tabela e studentëve të ciklit të dytë të studimeve që përfitojnë reduktim tarife 50% për vitin akademik 2024-2025.

Nr	Emertimi i Programit	Studente ku familjarët përfitojnë ndihmë ekonomike (kr.3)	Studente Ekselente (kr.5)	Statusi (kr.5)	Student, fëmijë të personave aftësi të kufizuara, me ndihmë ekonomike të plote ose të	Me një prind të ndare nga jeta dhe të ardhura të pamjaftueshme (kr.4)	Studente femije të ish të denuarve dhe të perandje kurve politike (kr.10)	Studente romë/ballkanike-egjiptiane (kr.9)	Totali	Efektet Financiare
1	Fakulteti i Shkencave të Levizjes	23	6		21			1	51	2,688,750
2	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit		2		3				5	248,550
3	Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit								0	
	Totali	23	8	0	24	0	0	1	56	2,937,300





Tabela Nr. 7 Të dhënat e studentëve të ciklit të parë dhe të dytë që përfitojnë përjashtim apo reduktim tarife shkollimi për vitin akademik 2024-2025.

Nr.	Kriteri	2024 – 2025	
		Nr. studentëve	Efekti financiar në lekë
A	Studentë ekselentë		
1	Cikli I i studimeve	6	210,000
2	Cikli II i studimeve	8	442,500
	Totali për studentët ekselentë	14	652,500
B	Studentë në nevojë		
1	Cikli I i studimeve	135	4,725,000
2	Cikli II i studimeve	48	2,494,800
	Totali për studentët ne nevojë	183	7,219,800
	Totali A+B	197	7,872,300

Tabela nr. 8 : Studentëve të ciklit të parë që përfitojnë bursë për vitet 2024-2025.

Emertimi i programit	Studente me aftësi të kufizuar	Studente/femije të personave me aftësi të kufizuar me të dy prindërit	Studente ku familjarët përfitojnë ndihme ekonomike	Student, me prind bashkëjetues pensionist dhe prind tjetër është ndarë nga jeta.	Student i cili ka 2 prindërit pensionistë	Studente të shkëlqyer nga viti paraardhës	Studente të shkëlqyer nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë	Statusi jetimit	Studentët që rezultojnë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit , të rene në detyrë	Studentët të tretët në rradhën e fëmijëve të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më shumë nga të cilët 2 të parët janë studentë në IAL publike	Totali	Efekti Financiar i planifikuar	Efekti Financiar Faktik
Fakulteti i Shkencave të Levizjes	2		38	4	1	3	0			1	49	4,217,728	4,113,621
Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit		1	37					1		2	41	3,625,000	3,571,805
Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit	2	1	12			1	1			1	18	1,547,273	1,476,359
Totali	4	2	87	4	1	4	1	1	0	4	108	9,390,001	9,161,785



Për vitin 2024 - 2025 kemi një numër afërsisht të barabartë me vitin 2023 - 2024, që trajtohen me bursë nga UST-të e cila shkon në 108 gjithsej nga ku 5 studentë ekselentë dhe 103 studentë në bazë të kriterëve bazuar në VKM përkatëse dhe efekti financiarë është 9,161,785 lekë.

➤ **SHPENZIMET**

Tabela nr. 9 Shpenzimet për vitin paraardhës, vitin aktual dhe vitin pasardhës nga buxheti sipas llogarive buxhetore paraqitet si tabela e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i Projektit	Viti paraardhës 2024	Viti aktual 2025	Viti pasardhës 2026
I	Fondet nga buxheti për shpenzime korrente	383,688	385,567	610,983
1	Paga e shpërblime	260,976	269,464	392,572
1.1	Pagat	238,702	246,118	371,952
1.2	Honorare - orët	22,274	23,346	20,620
2	Kontributet e Sigurimeve Shoqërore	40,584	41,844	58,990
3	Mallra dhe Shërbime	67,955	62,655	148,056
4	Transferta Korrente te Huaja	52	51	450
5	Transferta per Buxhetet Familjare dhe Individët	839	591	
6	Bursa	10,584	9,162	10,915
7	Kërkimi shkencorë	2,698	1,800	
8	Investime	43,518	95,995	57,800
8.1	Kërkim shkencor (investime)	24,499	9,060	
8.2	Shpenzime Kapitale të Patrupëzuara			
8.3	Shpenzime Kapitale të Trupëzuara	19,019	86,935	57,800
8.3.1	Ndërtime të reja			
8.3.2	Rikonstruksione	19,019	86,935	57,800
	Totali	427,206	481,562	668,783

Tabela nr. 10 Parashikimi i shpenzimeve të pritshme nga të ardhurat e UST sipas llogarive buxhetore paraqitet si tabela e mëposhtme:

Nr.	Emertimi i Projektit	Viti paraardhës 2024	Viti aktual 2025	Viti pasardhës 2026
1	Pagat	26,897	29,123	35,425
2	Kontributet e Sigurimeve Shoqërore	3,741	3,956	4,879
3	Mallra dhe Shërbime	3,949	4,125	16,820
4	Transferta Korrente te Huaja		0	
5	Transferta per Buxhetet Familjare dhe Individët	221	303	0
6	Shpenzime Kapitale të Patrupëzuara	0	2,336	18,812
7	Shpenzime Kapitale të Trupëzuara	15,098	73,825	21,328
	Totali	49,906	111,332	97,264

Parashikimi i shpenzimeve për materiale, shërbime dhe investime në Universitetin e Sporteve të Tiranës, është patur për bazë të gjithë kërkesat e departamenteve të njësive kryesore dhe drejtorive përkatëse.

Në këtë program buxhetor afatmesëm shpenzimet për investime janë parashikuar të kryhen kryesisht nga të ardhurat dytësore të UST, si dhe nga buxheti i shtetit.

Ministria e Arsimit realizoi financimin nga buxheti i shtetit me 70 % të shumës në vlerën 113 005.6 në 000/ lek për “Rikonstruksionin e Fushës së Futbollit, Pistës së Atletikës dhe rrethimi në UST” dhe pjesën tjetër të investimit është financuar me të ardhurat dytësore të UST-së.

Gjithashtu për vitin 2025 është parashikuar kërkesa për fonde nga buxheti i shtetit për “Rikonstruksion Palestra e Gjymnastikës”, “Pajisje inventar ekonomik” (mobilitet i mjediseve ndihmëse të fushës së futbollit), “Blerje pajisje për palestrën e gjymnastikës” në shumën gjithsej 57,800 mijë lekë.

PLANI BUXHETOR NJËVJEÇAR PËR VITIN 2025.

- Plani buxhetor njëvjeçar për të ardhurat**

Në parashikimin e shpenzimeve është mbajtur parasysh nevojat për paga sigurime shoqërore dhe shëndetësorë për punonjësit e UST bazuar në strukturën organizative të miratuar nga organet kolegjiale, plotësimin më bazë materiale për sigurimin e zhvillimit normal të aktivitetit të UST-së.

Tabela nr. 11 *Plani buxhetor njëvjeçar për të ardhurat paraqitet në tabelën e mëposhtëme:*

Nr	Emërtimi i Projektit	Mbartur nga viti i kaluar	Financimi i vitit aktual	Buxheti i Vitit	Pesha specifike në %
1	Financimi nga Buxheti i shtetit	212,227	488,171	700,398	72.73
1.1	Granti i mësimdhënies	193,610	359,000	552,610	78.90
1.2	Granti i bursa te studentëve	15,106	11,700	26,806	3.83
1.3	Grante per projekte program Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit	3,511	6,700	10,212	1.46
1.4	Grante për projekte të kërkimit shkencor për shpenzime kapitale	-	23,835	23,835	3.40
1.5	Fond Granti për Zhvillimin Institucional	-	86,935	86,935	12.41
2	Disbursime nga projektet me financim te huaj	5,355	6,955	12,310	1.28
2.1	Disbursime nga projektet me financim të huaj për shpenzime korrente	5,355	6,955	12,310	100.00
2.2	Disbursime nga projektet me financim të huaj për investime		-	-	0.00
3	Të ardhura të institucionit	247,571	2,670	250,241	25.99
3.1	Të ardhura të institucionit për shpenzime korrente	69,449	35	69,484	27.77
3.2	Të ardhura të institucionit për investime	154,122	2,635	156,757	62.64
3.3	Të ardhura të institucionit për kërkimin shkencor	24,000		24,000	9.59
	Totali 1+2+3	465,154	497,796	962,949	100.00

Financimi nga Buxheti i shtetit zë 72.73 % të të ardhurave institucionale. Në këtë financim Grandi i mësimdhënies zë 78.9%, Grandi i bursave zë 3.83%, Grandi për kërkimin shkencor zë 1.46%, Grandi për projekte të kërkimit shkencor për shpenzime kapitale zë 3.4% dhe Fond Grand për Zhvillimin institucional zë 12.41% të totalit të të ardhurave, disbursime nga projekte të huaja zënë 1.28% ndaj totalit të të ardhurave. Të ardhurat dytësore të institucionit zënë 25.99% ndaj totalit të të ardhurave gjithsej.

Tabela nr. 12 Plani buxhetor njëvjeçar i shpenzimeve

Nr.	Emërtimi i shpenzimit	Plani njëvjeçar i shpenzimeve ne 000/lek				Pesha specifike e çdo zëri kundrejt totalit%	Pesha grand ndaj totalit %
		Grand (I mbartur + financimi i vitit)	Projekte te /huaja	Te ardhura	Total Buxhet		
1	Paga e shperblime	348,287	-	41,195	389,482	40.81	36.49
1.1	PAGA	324,941		41,195	366,136		
1.2	Honorare	23,346			23,346		
2	Kontributet e Sigurimeve Shoqërore	57,531		5,896	63,427	6.65	6.03
3	Mallra dhe Shërbime	130,827		18,575	149,402	15.65	13.71
4	Transferta te tjera	591		113	704	0.07	0.06
5	Transferta tek individët Ndihma per fatkeqësi, sëmundje	689		674	1,363	0.14	0.07
6	Bursa	26,806			26,806	2.81	2.81
7	Kërkimi shkencor	48,733	-	18,208	66,941	7.01	5.11
7.1	Projekt shkencor AKKSHI	10,212			10,212		
7.2	Projekt shkencor AKKSHI (Pajisje laborator)	17,561			17,561		
7.3	Projekt shkencor AKKSHI(Pajisje inventarë ekonomik)	6,274			6,274		
7.4	Ndërtimi i nje platforme digjitale te kërkimit dhe botimit shkencor pranë ISKSH+ ter-it-in Vlerësim i plagjiaturës (libra elektronike, Pupmed, Humankinetics etj.			15,176	15,176		
7.5	Kërkim shkencor (Projekte shkencore ne UST)	14,686		3,032	17,718		
8	Investime	86,935	-	165,578	252,513	26.46	9.11
8.1	Studim projektim			4,148	4,148		
8.2	Investime te trupëzuara	86,935	-	161,430	248,365		
8.2.1	Ndërtime te reja				-		
8.2.2	Rikonstruksioni i fushës së Futbollit Pistës së Atletikës dhe rrethimi ne UST	86,935		67,879	154,814		
8.2.3	Supervizimi i "Rikonstruksioni i fushës së Futbollit Pistës së Atletikës dhe rrethimi ne UST"			2,368	2,368		
8.2.4	Rikonstruksione te tjera			51,996	51,996		
8.2.5	Blerje librash shqiptar dhe te huaj per Bibliotekën			4,387	4,387		
8.2.6	Inventarë ekonomik (Pajisje kompjuterike, orendi e pajisje zyre etj.)			16,800	16,800		
8.2.7	Pajisje laboratorike			14,000	14,000		
8.2.8	Mjete transporti			2,800	2,800		

8.2.9	Instalim kondicionerësh			1,200	1,200		
9	Projekte te huaja		3,829		3,829	0.40	0.00
	Totali	700,399	3,829	250,239	954,467	100.00	73.38

Tabela nr. 13 Detajimi i të ardhurave për vitin 2025.

Nr.	KODI	PROG	KAP	PROJEKT	Emërtimi i projektit	ART	PLAN VJETOR
1	1011048	9450	6	91105AA	Paga	600	41,194,762
2	1011048	9450	6	91105AA	Sigurime shoqërore dhe shëndetësorë	601	5,896,310
3	1011048	9450	6	91105AA	Shpenzime funksionimi	602	21,606,827
4	1011048	9450	6	91105AA	Të tjera transferime korrente jashtë shtetit	605	112,546
5	1011048	9450	6	91105AA	Të tjera transferta tek individët	606	673,847
6	1011048	9450	6		Investime	231	176,608,203
7	1011048	9450	6		Studime e projekte	230	4,148,040
	Totali						250,240,535

Të ardhurat dytësore të krijuara në UST janë të detajuara me vendime të organeve kolegjiale dhe destinacioni i tyre ka qenë kryesisht për rritjen e pagave të stafit akademik kufiri minimal dhe atij maksimal, sipas vendimeve përkatëse, si dhe për investime për përmirësimin e infrastrukturës, laboratorëve etj.

PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS.

Prioritetet dhe rezultatet kryesore të parashikuara të Planit Strategjik të Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe që synohet të arrihen janë si më poshtë vijon:

- Projekte për rikonstrukcion apo shtesa në objektet ekzistuese dhe ndërtime të reja;
- Rikonstrukcion i godinave ambienteve (projekti + rikonstrukcion) dhe palestrave sportive dhe godina shtesë apo të reja, për përmirësimin e kushteve dhe standardeve përkatëse, në shërbim të stafit dhe të studentëve;
- Fuqizimi i laboratorëve, plane konkrete më pajisje të standardizuara në shërbim të procesit kërkimor, shkencor;
- Ndërtimi i një platformë digjitale të kërkimit dhe botimit shkencor pranë IKSHS;
- Përmirësimi i standardeve infrastrukturore, nëpërmjet investimeve të reja përmirësimi i atyre ekzistuese, si dhe pajisjen me bazë materiale në funksion të realizimit të procesit mësimorë;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i auditorëve me pajisje, mjete kompjuterike, orendi e pajisje të tjera dhe ndihmëse audio – vizive;
- Pasurimi i fondit të bibliotekave;
- Rritjen e cilësisë së mësimdhënies në arsimin e lartë, nëpërmjet kualifikimit shkencor të stafit akademik, brenda dhe jashtë vendit, si dhe duke i mbështetur ato nga institucioni, në procesin e marrjes së doktoraturës;
- Mbështetja me bursë financiare studentët nga kategoritë sociale në nevojë, si dhe studentët ekselentë;
- Financimi i punës kërkimore në UST;
- Ndërkombëtarizimin e UST ku në këtë kuadër janë parashikuar fonde, për programe studimi të përbashkëta për ngritjen e infrastrukturës akademike kërkimore-shkencore;
- Zgjerimi i bashkëpunimit me universitete homologe brenda dhe jashtë vendit duke organizuar seminare, konferenca dhe takime informuese duke i mbështetur nga ana financiare;
- Mbështetja e qeverisë studentore për aktivitete dhe për pjesëmarrje në konferenca brenda dhe jashtë vendit;
- Mbështetja e pedagogëve për të arritur potencialin e tyre të plotë përmes zhvillimit profesional të vazhdueshëm.
- Përmirësimin e kapaciteteve për shërbimin me të tretë, të cilat krijojnë të ardhura për institucionin etj.

bela Nr 14 Realizimi faktik i planit buxhetor për vitin 2024 (buxhet dhe të ardhura) sipas muajve dhe në total.

Rr. Muhamet Gjollësja, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

Tabela. Nr. 15 Realizimi faktik i planit buxhetor nga buxheti(buxhet i mbartur dhe financimi i vitit 2024) në lekë.

Nr.	KAP	KODI PROJEKT	ART	EMËRTIMI	PLANI VJETOR (FINANCIM NGA GRANDI PER MESIMDHENIE N) PER VITIN 2024	REALIZIMI PER VITIN 2024	Në %
1	8	91105AA	600	PAGA	345,832,942	260,975,732	75.46
2	8	91105AA	601	Kontributet e Sigurimeve Shoqërore	72,114,948	40,584,423	56.28
3	8	91105AA	602	Mallra dhe Shërbime	144,468,467	67,955,683	47.04
4	8	91106AC	602	Projekt shkencor AKKSHI	1,276,864	1,128,864	88.41
5	8	91106AB	602	Projekte shkencore AKKSHI	4,932,250	1,569,175	31.81
6	8	91105AA	605	Transferta te tjera	740,750	52,030	7.02
7	8	91105AA	606	Transferta tek individët Ndihma per fatkeqësi , sëmundje	859,693	839,098	97.60
8	8	91105AB	606	Bursa	25,690,455	10,584,087	41.20
				Totali	595,916,369	383,689,092	64.39

Tabela. 16 Realizimi faktik i buxhetit nga Grandi i punës kërkimore shkencore për vitin 2024.

Nr	KAP	KODI PROJEKT	ART	EMËRTIMI	PLANI VJETOR PER VITIN 2024	REALIZIMI PER VITIN 2024	Në %
2	1	18BD913	231 0000	Pajisje laborator me titull Projekti shkencor: "Ngritja e laboratorit të vlerësimit e rehabilitimit të posturës, ecjes dhe deambulacionit, në funksion të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe vlerësimit funksional"	24,553,000	24,499,420	99.8
				Totali	24,553,000	24,499,420	99.8

Tab. Nr. 17 Realizimi faktik i buxhetit nga Grandi i Politikave të Zhvillimit për vitin 2024.

Nr	KAP	KODI PROJEKT	ART	Emërtimi	PLANI VJETOR PER VITIN 2024	REALIZIMI PER VITIN 2024	Në %
2	1	18BD913	231 0000	“Rikonstruksion i fushës futbollit dhe pistës atletikës dhe rrethimi në Universitetin e Sporteve të Tiranës”	29,841,700	19,019,397	64.4
Totali					29,841,700	19,019,397	64.4

Në detajimin e grandit për vitin 2024 ka patur dhe fonde të mbartura nga viti 2023.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar:

- Të gjithë kërkesat e paraqitura për zhvillimin normal të procesit mësimor, veprimtarive outdoor të dy njësive kryesore, kërkimit shkencor në mbështetje të studentëve dhe të stafit akademik;
- Është investuar në pajisje kompjuterike, pajisje laboratorit si për stafin, sallat e leksioneve e auditorëve duke çuar në përmirësimin e kushteve dhe ndikimin e rritjes së cilësisë së mësimdhënies;
- Ka patur një rritje të rëndësishme për financimin e veprimtarive në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit, zbatimit të marrëveshjeve dypalëshe dhe procedurat në aplikimet në projektet ndërkombëtare si dhe për kërkimin shkencor;
- Krijimin e një rrjeti ballkanik e të universiteteve të shkencave sportive;
- Krijimin e një programi të përbashkët (në ciklin e dytë të studimeve – Master) me universitete europiane dhe ato të rajonit;
- Në vitin 2024 UST realizoi financimin e kontratës për blerjen e pajisjeve laboratorike, për projektin e fituar nga AKKSH në vitin 2023;
- Përmirësimi dhe përditësimi i kapaciteteve të laboratorëve të UST me qëllim vënien në funksion për realizimin e kërkimit shkencor të aplikuar në shërbim të programit të doktoraturës;
- Është vazhduar në ndërtimin e faqes së re të UST me qëllim rritjen e shikueshmërisë dhe rritjen e kapacitetit të informimit të publikut dhe janë blerë pajisje për përmirësimin e rrjetit.
- Është investuar vazhdimisht në laboratorët e FSHR, në salla leksionesh, auditorë me qëllim përmirësimin e krijimit të kushteve optimale për zhvillimin e procesit mësimor në UST etje.

Tabela nr. 18 Realizimi faktik (të ardhurat e mbartura nga viti 2023 dhe financimi i të ardhurave për vitin 2024) në UST-së.

Nr	KAP	KODI PROJEKT	ART	Emërtimi	PLANI VJETOR PER VITIN 2024	REALIZIMI PER VITIN 2024	Në %
1	6	91105AA	600	PAGA	68,091,830	26,897,068	39.50
2	6	91105AA	601	Kontributet e Sigurimeve Shogërore	9,637,050	3,740,740	38.82
3	6	91105AA	602	Mallra dhe Shërbime	25,521,129	3,949,469	15.48
4	6	91105AA	605	Transferta te tjera	112,546	0	0.00
5	6	91105AA	606	Transferta tek individët Ndhma per fatkeqësi , sëmundje	894,881	221,034	24.70
6	6		231	Investime AQT	189,071,227	15,097,724	7.99
7	6		230	Investime AQPT	4,148,040	0	0.00
				Totali	297,476,703	49,906,035	16.78

Të ardhurat e krijuara në Universitetin e Sporteve të Tiranës janë të detajuara me Vendime të Bordit të Administrimit. Për vitin akademik 2024 janë financuar kryesisht për zërat si më poshtë vijon:

- Blerje pajisje kompjuterike në shumën 8,332,620 lekë;
- Shpenzime pajisje dhe instalimi i kondicionerëve 1,062,588 lekë;
- Rikonstruksione në shumën 1,872,311 lekë;

- Orendi zyre në shumën 745,260 lek;
- Pajisje të tjera zyre në shumën 401,533 lek;
- Instalim kamera sigurie në shumën 99,336 lek;
- Honorare , dieta për stafin akademik etj. në shumën 2,720,298 lekë;
- Dieta staf akademik në shumën 787,500 lek;
- Paga për stafin akademik me kohë të plotë dhe staf akademik me kohë të pjesshme në shumën 26,897,068 lekë dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore në shumën 3,740,740 lekë.

Mbështetur në Ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ardhurat e mbartura dhe ato të krijuara përdoren kryesisht, për të financuar projektet prioritare infrastrukturore të UST, efektin financiar të kufirit maksimal me atë minimal të pagave të stafit akademik, projekte shkencore etje.

Universiteti i Sporteve të Tiranës ka hartuar dhe miratuar buxhetin në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Institucioni ndjek një politikë transparente në shpërndarjen e burimeve financiare duke respektuar rregullat e kontabilitetit.

➤ Burimet e të ardhurave të UST-së janë:

- Grandi i akorduar nga MAS;
- Të ardhurat nga tarifat e studimit të studentëve;
- Te ardhura nga veprimtaritë dytësore;
- Financime nga projektet , Erasmus + etj.

Tabela Nr. 19 Të ardhurat e krijuara në Universitetin e Sporteve të Tiranës për vitin 2022, 2023, 2024 dhe për periudhën 01 Janar – 30 nëntor 2025 janë si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i llogarisë	Të ardhurat e krijuara për vitin 2022	Të ardhurat e krijuara për vitin 2023	Të ardhurat e krijuara për vitin 2024	Të ardhurat e krijuara për periudhën 01 janar-30.11.2025
1	Tarifa Regjistrimi	1,447,605	2,029,565	1,540,660	2,054,075
2	Tarifa Shkollimi	46,885,242	56,605,939	67,839,364	75,114,902
3	Tarifa Konkursi	3,153,520	3,198,645	3,402,240	3,454,310
4	Vërtetime	57,500	261,915	199,040	184,420
5	Parkimi	722,515	686,800	1,051,150	1,174,200
6	Shtypshkrime	2,560,416	2,125,715	1,936,741	1,593,100
7	Shërbim me te 3-te	5,008,990	8,504,392	7,726,519	8,206,075
8	Të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh	0	505,085	1,074,015	10,000
9	Korrigjime nga vitet e kaluara	543,673.94	0	0	1
10	<i>Sekuestrim page</i>	0	0	0	69,600
	Totali	60,379,462	73,918,056	84,769,729	91,860,683

Siç shihet dhe në tabelat e mësipërme pjesën më të madhe të të ardhurave e zënë tarifat e shkollimit dhe të ardhurat nga shërbimet me të tretë. Të ardhurat për vitin 2024, 2025 kanë një rritje të

konsiderueshme në krahasim me të ardhurat e vitit 2023 dhe 2022, si rezultat i politikave të institucionit në hapjen e programeve të reja të studimit.

Tabela nr. 20 Plani buxhetor i vitit 2025

Nr.	Emërtimi i shpenzimit	Plani njëvjeçar i shpenzimeve ne 000/lek				Pesha specifike e çdo zëri kundrejt totalit %	Pesha grand ndaj totalit %
		Grand (i mbartur + financimi i vitit	Projekte te /huaja	Te ardhura	Total Buxhet		
1	Paga e shpërblime	348,287	-	41,195	389,482	40.67	36.37
1.1	PAGA	324,941		41,195	366,136		
1.2	Honorare	23,346			23,346		
2	Kontributet e Sigurimeve Shoqërore	57,531		5,896	63,427	6.62	6.01
3	Mallra dhe Shërbime	130,827		18,575	149,402	15.60	13.66
4	Transferta te tjera	591		113	704	0.07	0.06
5	Trasferta tek individët Ndhimja per fatkeqsi , sëmundje	689		674	1,363	0.14	0.07
6	Bursa	26,806			26,806	2.80	2.80
7	Kerkimi shkencor	48,733	-	18,208	66,941	6.99	5.09
7.1	Projekt shkencor AKKSHI	10,212			10,212		
7.2	Projekt shkencor AKKSHI (Pajisje laborator)	17,561			17,561		
7.3	Projekt shkencor AKKSHI(Pajisje inventarë ekonomik)	6,274			6,274		
7.4	Ndërtimi i nje platforme digjitale te kërkimit dhe botimit shkencor pranë ISKSH+ ter-it-in Vlerësim i plagjiaturës (libra elektronike, Pupmed, Humankinetics etj.			15,176	15,176		
7.5	Kërkim shkencor (Projekte shkencore ne UST)	14,686		3,032	17,718		
8	Investime	86,935	-	165,578	252,513	26.37	9.08
8.1	Studim projektim			4,148	4,148		
8.2	Investime te trupëzuara	86,935	-	161,430	248,365		
8.2.1	Ndërtime te reja				-		
8.2.2	Rikonstruksioni i fushës së Futbollit Pistës së Atletikës dhe rrethimi ne UST	86,935		67,879	154,814		
8.2.3	Supervizimi i "Rikonstruksioni i fushës së Futbollit Pistës së Atletikës dhe rrethimi ne UST"			2,368	2,368		
8.2.4	Rikonstruksione te tjera			51,996	51,996		
8.2.5	Blerje librash shqiptar dhe te huaj per Bibliotekën			4,387	4,387		
8.2.6	Inventarë ekonomik (Pajisje kompjuterike, orendi e pajisje zyre etj.)			16,800	16,800		
8.2.7	Pajisje laboratorike			14,000	14,000		
8.2.8	Mjete transporti			2,800	2,800		
8.2.9	Instalim kondicionerësh			1,200	1,200		
9	Projekte te huaja		6,955		6,955	0.73	0.00
	Totali	700,399	6,955	250,239	957,593	100.00	73.14

Nisur nga tabela e mësipërme shpenzimet nga buxheti i shtetit zënë pjesën më të madhe të të ardhurave në masën 73.14 % të totalit të shpenzimeve. Peshën më të madhe të shpenzimeve (buxhet + të ardhura) e zënë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore në masën 47.29 %, ndërsa shpenzimet e tjera

mallra e shërbime, honorare zënë 15.81 %, shpenzimet për bursa zënë 2.80 % , shpenzimet për kërkimin shkencor zënë 6.99%, shpenzimet për projektet e huaja 0.73% dhe pjesën tjetër të shpenzimeve e zënë investimet në masën 26.37%.

Tabela 21 Realizimi faktik i planit buxhetor për janar-nëntor viti 2025 nga buxhet në lekë.

Nr	KAP	KODI PROJEKT	ART	Emërtimi	PLANI VJETOR (FINANCIM NGA GRANDI PËR MËSIMDHËNIEN) PËR VITIN 2025	REALIZIMI JANAR-NËNTOR VITI 2025	Në %
1	8	91105AA	600	PAGA	348,367,190	248,954,742	71.46
2	8	91105AA	601	Kontributet e Sigurimeve Shoqërore	57,530,525	38,356,669	66.67
3	8	91105AA	602	Mallra dhe Shërbime	145,513,162	57,438,299	39.47
4	8	91106AC	602	Projekt shkencor AKKSHI	148,000	0	0.00
5	8	91106AB	602	Projekte shkencore AKKSHI	7,737,752	1,751,381	22.63
6			602	Projekte shkencore AKKSHI	2,325,756	0	0.00
7	8	91105AA	605	Transferta te tjera	688,720	50,610	7.35
8	8	91105AA	606	Transferta tek individët Ndhima per fatkeqësi, sëmundje	510,615	510,020	99.88
9	8	91105AB	606	Bursa	26,806,368	9,161,782	34.18
				Totali	589,628,088	356,223,503	60.41

Tabela nr. 22 Realizimi faktik i të ardhurave për periudhën janar-nëntor viti 2025 në lekë.

Nr.	KAP	KODI PROJEKT	ART	Emërtimi	PLANI VJETOR PËR VITIN 2025	REALIZIMI PËR VITIN 2025	Në %
1	6	91105AA	600	PAGA	41,194,762	26,696,215	64.80
2	6	91105AA	601	Kontributet e Sigurimeve Shoqërore	5,896,310	3,626,102	61.50
3	6	91105AA	602	Mallra dhe Shërbime	21,606,827	3,045,689	14.10
4	6	91105AA	605	Transferta te tjera	112,546	0	0.00
5	6	91105AA	606	Transferta tek individët Ndhima per fatkeqësi, sëmundje	673,847	303,412	45.03
6	6		231	Investime AQT	176,608,203	3,318,792	1.88
7	6		230	Investime AQPT	4,148,040		0.00
				Totali	250,240,535	36,990,210	14.78

TARIFAT E SHKOLLIMIT

Tarifat e shkollimit janë të miratuara me vendime të Senatit Akademik dhe vendime të Bordit të Administrimit dhe janë të paraqitura më poshtë:

Tabela 1

FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES

Tarifa e regjistrimit në konkurset e pranimit praktik (në Ciklin e parë të studimeve, Program i parë i studimeve Program i dytë i studimeve)	5,000 lekë
Tarifa e regjistrimit të fituesve (në Ciklin e parë të studimeve, Program i parë i studimeve / Program i dytë i studimeve)	2,000 lekë
Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në programet e ciklit të dytë të studimeve program i parë i studimeve)	2,500 lekë
Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve dhe transferimet e studimeve dhe të tjerë)	3,000 lekë
Tarifa e regjistrimit të fituesve (në Programet e Ciklit të dytë të studimeve program i parë i studimeve/ program i dytë i studimeve)	2,000 leke
